

LIBROTEKA

854.09

9.79

ODHISE
R. GRILLO

PANORAMË LETRARE

2

Nepër
faqet
e letërsisë
sonë
për fëmijë




85H.09

§ 79

ODHISE K. GRILLO

PANORAMË LETRARE - 2

*Nëpër faqet e letërsisë
sonë për fëmijë*



BOTIMET TOENA

Redaktor: Adelina Mamaqi
Recensues: Dionis Bubani
Kopertina: Safo Marko
Arti grafik: Ana Hyso

Botues: Fatmir Toçi

© Copyright 1998: Autori

SHTËPIA BOTUESE TOENA
Rr. "Muhamet Gjollështa", K.Postare 1420
TIRANE
Tel.: (042) 401 16; 401 17
Tel-Fax: (042) 272 32

Në vitin 1986 kam botuar librin "Panoramë letrare -1" (Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë). Tani, pas dhjetë vjetësh, po botoj "Panoramë letrare-2" (Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë) dhe kam lëndë të gatëshme për të botuar edhe librin e tretë po me këtë titull...

Shkrimet e këtyre librave janë mendime të një shkrimtari për letërsinë tonë për fëmijë, të nxjera nga përvoja pesëdhjetëvjeçare në këtë fushë, dhe jo studime e kritika të mirëfillta.

Ndofta sot u vlejné studentëve që studjojnë për mësuës dhe shpresoj se në të ardhmen do t'u vlejné edhe studjuesve e kritikëve që do të merren me letërsinë tonë për fëmijë.

ODHISE GRILLO

Tiranë, shtator 1997

NË VEND TË PARATHËNIES

NJË POET ME SHUMË MBIEMRA

(Së pari i kërkojmë falje poetit N.T. nga Këlcyra, pasi nuk kemi asgjë me të. Ai është i nderuar si njeri e si mësues. Po na duhet të merremi me mbiemrin e tij, i cili hoqi një kalvar ndryshimesh e gjymtimesh...)

Në vitin 1975 më thirrën dhe më thanë se poetit N.T. i duhej ndrruar mbiemri në librin që po i botonin, pasi e kishte Tifo. Duhet t'ia bënin *Tyta*.

Është e tepërt të them se mbiemri i tij s'ka të bëjë fare me Marshallin Tito. Me sa thonë gjuhëtarët emri Tito vjen nga shkurtimi i emrit Margarit, shprehur në mënyrë përkëdhelëse. Mirëpo ku pyetnin çensorët e regjimit. Ata thoshin me vete:

“Po sikur vjershat për fëmijë të këtij Titos t'i lexojë shoku Enver, ç'do të thotë vallë? Me siguri do t'i kujtojnë Titon e Jugosllavisë dhe do të tërbohët. Të mbarojë me kaq hajde-de:.. Po sikur të lëshojë rrufe mbi autorin (aq na bën!) e sidomos mbi ne?”

Të tilla pandehma me sa duket i bënin të dridheshin si kallami nga valët e lumit, prandaj urdhëruan t'i ndrruhej mbiemri. Dhe nisën ndrrimet, se mjafton të kalojë një herë miu nëpër mustaqe... Në revistën “Yllkat” autori u prezantua me mbiemrin Tita, në revistën “Fatosi” me mbiemrin “Tite”...

Po puthadorët nuk u kënaqën me kaq. Gjeneral frika i bënte të urdhëronin: “Ta ndrroni prapë mbiemrin!”

Mirëpo hajde të gjeje zanore të tjera, se vetëm shtatë ka alfabeti ynë... Megjithatë nëpër libra e nëpër revista ia ndrruan përsëri dhe ia bënë *Tyte*. Mirë që nuk ia bënë Tuto, Teto, Teta!

Me mbiemrin Tyte me sa duket puthadorët u kënaqën se nuk e kërkuan më ndrrimin e mbiemrit. Tani shoku Enver s’kishte ku t’i kapte se Tito dhe Tyte janë “Hane Shan, hane Bagdat!”.

Autori, që nuk u pyet fare për këto ndryshime, u ankua por i thanë të mbyllte gojën se ata mund t’i ndrronin jo vetëm mbiemrin por edhe emrin, emrin e nënës e të babës, madje edhe të katragjyshëve!

NJË MIK I MADH I FËMIJËVE TË VEGJËL

1.

Për herë të parë u takuam në Tiranë në ditët e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës sonë, ku, si një shkrimtar i shquar i letërsisë për fëmijë në Kosovë, kishte ardhur për të marrë pjesë në punimet e këtij kuvendi të rëndësishëm, në emër të vet dhe të të vegjëlve kosovarë, që e duan aq shumë gjuhën e nënës. Emrin e tij do ta gjeni ndërmjet sa e sa të tjerëve në dokumentet e kongresit: quhej Vehbi Kikaj.

Sa e njihje, Vehbiu të hynte në zemër me thjeshtësinë, çiltërsinë, fjalën e ëmbël dhe buzëqeshjen e tij të përherëshme. Shëtitëm së bashku, biseduam për letërsinë tonë për fëmijë në Shqipëri e në Kosovë. I thamë shumë fjalë zemre njëri-tjetrit. Ai ishte entuziast dhe me shpirt të ndjeshëm poetik. Fliste dhe e shikonte me optimizëm zhvillimin e gjuhës, të shkollës e të letërsisë shqipe në vendlindjen e vet. Fliste dhe gëzohej për fëmijët që po merrnin në duar libra në të gjitha gjinitë, që nga vjersha e poema, që nga skica e tregimi, te novela e romani. Dhe të gjitha në gjuhën

amtare. Që po merrnin në duar vepra me vlera edukative e artistike. Dhe të gjitha këto arritje në disa dhjetëvjeçarë. Po pas njëqind apo dyqind vjetësh? Entuziasti i tij nuk tregohet dot me fjalë!

E takova përsëri Vehbi Kikajn pas një viti, në pragdimrin e vitit 1973, kur së bashku me shkrimtarë të tjerë të shquar të letërsisë për fëmijë në Kosovë erdhën të ftuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve për të njohur më mirë Shqipërinë dhe sukseset e kufizimet e saj në të gjitha fushat, për të njohur njëri-tjetrin edhe më mirë, për të forcuar edhe më tej miqësinë e vëllazërinë. Shëtitëm nëpër Shqipëri, bëmë biseda e takime me letrarë të vegjël, shkrimtarë e artistë, folëm për letërsinë tonë për fëmijë me shqetësimin për ta çuar edhe më përpara. E njohëm më thellë e më mirë krijimtarinë e shoku-shokut dhe letërsinë në përgjithësi e biseduam për rrugët e botimit të veprave tona në Kosovë e të shkrimtarëve nga Kosova në Shqipëri. Dhe lidhëm shoqëri e miqësi të ngushtë.

Nga udhëtimi, bisedat, takimet e qëndrimi prej dy-tri javësh së bashku ruaj sa e sa kujtime, ndërmjet të cilave katër librat që kishte botuar Vehbiu, me autografin e tij dhe me shënimet entuziaste e vëllazërore që dinte të shkruante veç ai. Edhe me urimin që të shkruaja libra edhe më të bukur se novela “Njeriu i natës”, edhe “*mbi fëmijët e tanishëm të ditës në Shqipëri*”¹⁾, siç ka shkruar me dorën e vet.

Ruaj edhe një kujtim tjetër, i cili tregon ç’dashuri të madhe për atdheun dhe ç’shpirt të ndjeshëm poetik kishte Vehbi Kikaj.

Kur erdhi në Shqipëri, në gazetën “Drita” të datës 18 nëntor 1973, në faqen 16, u botua lajmi “Shkrimtarë kosovarë në vendin tonë”, ku, ndërmjet të tjerave, shkruhej: “Në këtë grup bëjnë pjesë Vehbi *Kika*, Maksut Shehu, Rifat *Kuka*, Qamil Batalli dhe Agim Deva”.

1) Nga autografi në librin: “*Shtëpia ime ka sy*”

Sa e lexoi lajmin, më falënderoi dhe pastaj me shqetësim më tha afërsisht këto fjalë:

“Na është bërë një padrejtësi e madhe mua dhe Rifatit. Ne kemi luftuar shumë që ta fitojmë atë “j”, që të tregojmë se edhe në mbiemër jemi shqiptarë.”

I kërkova të falur dhe i premtova se kjo gjë do të rregullohet së shpejti. Kështu, më datën 25 nëntor 1973, po në faqen 16, gazeta “Drita” botoi lajmin “Diskutim krijues”, për takimin që patën shkrimtarët nga Kosova me shkrimtarë dhe letrarë të vegjël të Kryeqytetit në Pallatin e Pionierëve në Tiranë. Në lajm shkruhej: “...merre pjesë dhe grupi i shkrimtarëve kosovarë që po viziton vendin tonë, i përbërë nga Vehbi *Kikaj*” etj. Mbiemrat e shkrimtarëve të shquar nga Kosova, Vehbi *Kikaj* e Rifat *Kukaj* ishin shkruar ashtu siç e meritonin dhe siç e dëshironin. Sa e lexuan lajmin, erdhën, më falenderuan dhe më thanë:

- Tani jemi shumë të qetë. Jemi të lumtur dhe të gëzuar!

2.

Shkrimtari Vehbi *Kikaj* lindi në Llap (Lupç, siç thoshte vetë), të Podujevës, më 24 shkurt 1942 dhe shkollën fillore e kreu në vendlindje më 1953, ndërsa të mesmen në Normalen e Prishtinës (shkollën pedagogjike) në vitin 1957. Më tej ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, për gjuhë e letërsi shqipe, në vitin 1961.

Pas mbarimit të studimeve punoi disa muaj mësues në vendlindjen e vet dhe më pas shkoi redaktor i faqes së fëmijëve në gazetën “Rilindja”. Për gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë pastaj ishte redaktor dhe kryeredaktor i revistës për fëmijë “Pionieri” dhe vjetët e fundit (1983-1986) kryeredaktor i së për dyjavëshmes kulturore-letrare e artistike “Fjala”.

Vjershën e parë e botoi në “Rilindja” në vitin 1957, kur ishte ende nxënës në Normalen e Prishtinës, dhe qysh atëherë tërhoqi vëmendjen e lexuesve të vegjël e të mëdhenj, të kritikës e të studjuesve. Qysh atëherë ai nisi bashkëpunimin e ngushtë me organet letrare të fëmijëve e të të rriturve, në gazetatat e revistat që dalin në gjuhën shqipe në Prishtinë e në Shkup, si në “Gëzimi”, “Pionieri”, “Shkëndija”, “Fjala”, “Rilindja” etj, duke lënë gjurmë për tri dekada rresht në krijimtarinë letrare për fëmijë.

Veçanërisht emër e sukses i dhanë Vehbi Kikajt përmbledhjet poetike “*Gurra!*” (1963), “*Zogu i argjendtë*” (1964), “*Shtëpia ime ka sy*” (1973) dhe romani-përrallë “*Sarajet e bardha*” (1968). Në vitin 1986 dorëzoi përmbledhjen e katërt poetike, “*Lumit i kthehet lejleku*” (shumica vjersha të reja dhe një pjesë vjersha të zgjedhura nga përmbledhjet e mëparshme), po nuk arriti ta shihte të botuar, pasi vdekja e ndau nga fëmijët e kopshteve e të shkollave fillore, nga të rinjtë e shkollave të mesme e studentët, nga miqtë, shokët, farefisi e familja, dhe nga lexuesit e shumtë, me të cilët kishte lidhur miqësi, duke u dhuruar vjersha të bukura e duke i takuar në fshat e në qytet, në fushë e në mal, ku shkonte shpesh për të njohur vendlindjen, për t’u çmallur dhe për të gjetur frymëzime të reja.

Veprat që krijoi Vehbi Kikaj u lexuan e lexohen me interes nga lexues të shumtë, të vegjël e të mëdhenj. Këtë e tregon edhe fakti se të katër librat që botoi u ribotuan nga dy, tri, katër e më shumë herë secili. Kështu, “*Sarajet e bardha*” është ribotuar shtatë herë. Shumë krijime të tij kanë hyrë në leximet letrare të fëmijëve (lektura shkollore) në Kosovë e në dheun amë.

Krijimtaria e poetit Vehbi Kikaj është prezantuar në të gjithë përmbledhjet poetike për fëmijë që janë botuar në Kosovë, me vjersha e proza poetike, si në “Tri gëzime”, “Letër pranverës”, “Dëshira fluturake” e “Antologji e poezisë shqipe për fëmijë”, botuar nga “Rilindja e Prishtinës”, dhe në “Një tufë lule”, botuar nga “Flaka e vëllazërimit” në Shkup. Po kështu ai u është

prezantuar lexuesve në përmbledhjet e botuara në gjuhë të huaj, si në “Poezia jugosllave për fëmijë” e “Vëllazërimi” (serbisht), “Një tufë lule” (turqisht), “Libri i fëmijëve jugosllavë” (frëngjisht dhe anglisht). Krijime të tij janë përkthyer edhe në hungarisht, sllovenisht, kroatisht, sllovakisht, rusisht etj.

Shkrimtari Vehbi Kikaj u ka dhuruar të vegjëlve kosovarë edhe disa përkthime në shqip nga krijimtaria botërore për fëmijë. Si “Çipolinoja” e Xhani Rodarit, “Pranë vatrës” e Angel Karaliçevit, “Sikur hëna të ishte balonë” e Ivan Cekoviçit, veç krijimeve të veçanta të botuara në revista e gazeta.

Shkrimtarin Vehbi Kikaj e njohin shumë mirë edhe lexuesit tanë, pasi vjersha e proza të tij poetike janë botuar në “Yllkat”, “Fatosi” e “Pionieri” qysh dhjetë-pesëmbëdhjetë vjet më parë. Në vitin 1977 Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” i botoi përmbledhjen “Gurrat”, me vjersha të zgjedhura nga të tre librat e tij poetikë. Më pas, në përmbledhjet “Gishti ngjyrë vjollcë” (1981), “Me xhaketen kuqezi” (1982), (Reja e zezë mbi kullën e bardhë” (1983); “Kur buzëqesh nëna ime” (1984) etj., të botuara po nga shtëpia botuese “Naim Frashëri”, shkrimtari Vehbi Kikaj është përfaqësuar me tufa vjershash e prozash poetike në mes të shumë autorëve të tjerë nga Kosova.

I përmendëm të gjithë këto për të treguar se poeti e prozatori Vehbi Kikaj ka qenë një krijues me diapazon të gjerë, me krijimtari të mbarë e të frytëshme dhe i lidhur ngushtë me lexuesit që në hapat e parë, gjersa u nda nga ne, nga një sëmundje e shkurtër dhe e rëndë, më 16 mars 1986, në moshën dyzetekatërveçare, duke lënë një vend të zbrazët në sofrën e përbashkët të letërsisë shqipe për fëmijë që krijohet në Kosovë e kudo ku jetojnë shqiptarët.

Sipas dëshirës së tij të fundit u varros në vendlindje, në Llapin e dashur e të zemrës, për të cilin krijoi vjersha të bukura e të frymëzuara.

Krijimtaria e tij u ndërpre në mes kur lexuesit e shumë që

kishte pritnin të gurgullonte edhe më bukur me “Gurrat” e tij, që “Zogu i argjendtë” të fluturonte më lart në hapësirë për të gjetur shtigje të reja poetike, që “Sarajet e bardha” t’i hapnin dyert në të dy kanatet për njerëzit e ndershëm, që shtëpia e tij që kishte sy e të priste mysafirë të rinj e të shumtë, dhe që lumit t’i kthehej lejleku nga mërgimi i gjatë...

Se çfarë peshe kishte ky poet, tregimtar, romancier, publicist e përkthyes i talentuar në letërsinë shqipe për fëmijë në Kosovë e tregojnë edhe vlerësimet që i kanë bërë disa nga shkrimtarët më në zë të vendlindjes së vet:

Enver Gjergjeku:.... "Mund të thuhet se Vehbi Kukaj ishte ndër shkrimtarët më të talentuar të letërsisë sonë për fëmijë, poet që në këtë letërsi solli lirizëm të thellë e të ri, solli një botë të panjohur më parë. Vendi i tij në këtë poezi do të mbetet bosh për një kohë të gjatë. Vehbi Kikaj edhe “gjërave të vdekura” u jepte shpirt në poezinë e tij, i bënte të flisnin me gjuhën dhe mendimin e thellë”.

Rrahman Dedaj: “ Si poet, që në vargjet e para dëshmoi se do të bëhej një yll në qiellin poetik të letërsisë për fëmijë në Kosovë... Një varg veprash që botoi si libra më vete dhe ato që botoi në organet letrare të fëmijëve, sollën në këtë letërsi një imagjinatë të re, të cilën e pranonin të gjithë, se i besonin asaj. Janë fjalë të dashura dhe të kuptueshme, fjalë të tashme dhe të ardhme, të krijuara për t’u mbetur brezave.”

Rifat Kukaj: “Ai thithi në Llap dritën dhe dashurinë e thellë për vendlindjen për të na e dhuruar me penën e tij në vargje të bukura e të frymëzuara, në vargje që u flasin fëmijëve me gjuhën e tyre, se Vehbiu e kishte gjetur çelësin për të hapur mendjet dhe zemrat e të vegjëlve.”

3.

Vehbi Kikaj në radhë të parë ishte poet, pastaj edhe prozator. Ishte poet jo se në këtë fushë krijoi më shumë, porse këtu pena e tij shkëlqeu si për tematikën e gjerë e interesante që solli e trajtoi në poezinë për fëmijë, ashtu edhe për artin e tij poetik, si mjeshtër i fjalës dhe i vargut, ashtu edhe për artin e tij poetik, si mjeshtër i fjalës dhe i vargut, i mendimit dhe i ndjenjës, i figurës dhe i detajit, i bots fëmijërore dhe i fantazizë së tyre. Të shkruash për Vehbi Kikajn dhe të nxjerrësh në pah vlerat e poezisë së tij është vështirë, ashtu siç është vështirë për çdo mjeshtër të fjalës poetike.

Në krijimet e veta, të cilat i ka përfshirë në të katër përmbledhjet, Vehbi Kikaj i kushton kujdes të madh spektrit tematik të vjershave, në mënyrë që të jetë sa më i larmishëm dhe sa më i freskët, duke sjellë gjithmonë prurje të reja. Udhëtimi i tij tematik nis qysh dy -tre mijë vjet më parë më ilirët dhe vjen gjer në ditët tona, kur vogëlushi nga Opoja¹⁾ i bën thirrje borës që të mos bjerë e të mos i zërë rrugët, në mënyrë që t'i kthehet i ati nga mërgimi. Brënda këtij udhëtimi tremijëvjeçar autori ka futur vjersha që e marrin temën nga e kaluara e largët ("*Romakët sulmojnë me shpata / ilirëve iu prin Teuta*", nga e kaluara e afërt ("*Më shikon pak Migjeni! - Duhet kthyer e mira, / Unë ia dhuroj "Gurrat" / ai "Vargjet e lira"*"), nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare që bëri edhe populli i Kosovës bashkë me popujt e tjerë të Jugosllavisë ("*Ti trëndafilin s'e pave kurrë të çelur, / lirinë s'e prite, o Ferid Grezda*²⁾ i djegur", gjer në ditët tona ("*Pse s'bie si fluturat në luadhe/ luadhit i kthehet ylberi/ vjen edhe im atë nga kurbeti/ e bëjnë një dasmë të madhe!*")

1) fshat në Kosovë

2) pionier dëshmor

Te përmbledhja “Gurrat” më tepër zotëron motivi i fshatit e motivi baritor dhe peizazhet e bukura të natyrës së Kosovës, të cilat autori i ka ruajtur në kujtesë e në zemër nga Llapi. Me këto lirika, që shpesh ngjasin si akuarele, ai mbjell te fëmijët farën e dashurisë për natyrën, për të bukurën e të madhërishmen, duke selitur ndjenja të pastra njerëzore. Nëpërmjet tyre autori rrënjos dashurinë për atdheun dhe veti nga më të mirat, si *trimëria e burrëria*: “*Sa gëzim ka lumi,/ askush s’mund ta dijë!/ Ai vjen prej malesh/ për ju, o fëmijë!*” ose “*Ndalu, dre i bukur/ ndalu të rrimë pak./ Pse vrapon si lepur,/ mos je frikacak?*” Këtë rrugë ai e ndjek edhe në përmbledhjet e tjera, diku më pak e diku më shumë. Se edhe në to nuk mungojnë vjershat lirike për pyllin, lumin e drerin, për zogjtë, hënën e retë, për bukurezën, lejlekun e pranverën, që poeti i kishte shumë për zemër.

Në përmbledhjen “Zogu i argjendtë” dhe sidomos te “Shtëpia ime ka sy”, poeti Vehbi Kikaj bën një hap përpara në tematikë dhe nga motivet e qeta e soditëse përgjithësisht, kalon në ato me peshë më të madhe shoqërore, historike e etike. Kjo bën që të ngrihet edhe më lart vlerat e krijimeve të tij. Përpjekjen për të trajtuar motive të tilla e gjen qysh te “Gurrat”, sidomos në vjershat “Lokja” (“*I ëmbël është sheqeri/ dhe mjalta që bën bleta/ më ëmbël më vjen kur Lokja/ më tregon përralla të vjetra*”), “Urimi i nënës” (“*Ti, bija ime e dashur/ zemrën gëzim ma mbush,/ u rritsh, syzeza e nënës/ siç rritet lulja në fushë*”) ose “Kënga e një nëne zezake” (“*Na shkuan trimat, vdiqën të urtuar,/ në luftë barbare,/ pash më pash ky dhe i bekuar/ u mbush me varrë*”).

Në përmbledhjen “Zogu i argjendtë”, veç poezive peisazh, Vehbi Kikaj priret drejt problemeve të mprehta shoqërore. Këtë e sheh kur lexon vjersha si “Kur piqen gështenjat” (*O xha Sylë i vjetër,/ sot ç’u gëzua fëmija,/ të gjithë për ty bajnë lum! Prapë dhe vjeshtës tjetër,/ ty t’u gëzofte shtëpia,/ paç tri herë më shumë!*) “Këngët për nipin e vogël” (“*Të pasurit ar,/ të varfërit helm,/ kjo*

jetë për njerëz a vlen?") etj.

Motivet historike e shoqërore zënë vend kryesor në përmbledhjen "Shtëpia ime ka sy". Këtu gërshetohen motive të shkollës e të mësimimit ("*Erdhi shtatori me erë molle,/ shtatori mbi qerre me rrush./ n'agim dëgjoj zile shkolle/ e rrugës vrapon një vogëlush*"), me ato të njerëzve të varfër e punëtorë ("*Dy shitëse te fontana presin, pranverën në qytet na e shesin*", me motivet shoqërorë ("*Kollitet Migjeni/ nga mushkria e sëmurë/ dhe mua gëzimin/ ç' ma godet një gur!*"), për ata që punojnë e që prodhojnë të gjitha të mirat materiale ("*Punëtorët sot në Obiliq / fëmijët i patën miq!*") dhe me motivet atdhetare që poeti, si mjeshtër i fjalës që ishte, i gjen edhe te një insekt i vogël, siç është moliëkuqja ose nusepashka ("*Në gëzimet tona / fluturo ti, / me xhaketën / kuqez!*").

Në vjershën "Nënat", të ndërtuar sipas një legjende të vjetër, poeti i ngre himn atdheut dhe trimat që bien për të i bën të madhërisëm para syve të lexuesve të vegjël, duke u ngjallur krenarinë kombëtare e duke u bërë thirrje që, po të jetë nevoja të vazhdojnë rrugën e tyre. Këtë e sheh edhe te vjersha që i kushtohet Emin Durakut, me titull "Ecjen e mësoi prej lumit", e cila ka një fund të bukur e domethënës: "*Lirinë e ka ngjallur me vdekje të vet!*"

Këto tema autori i ka përforcuar me prozat poetike që ka botuar mes vjershave, në kapituj të veçantë, te përmbledhjet "Zogu i argjendtë" dhe "Shtëpia ime ka sy". Dy përmbledhjet autori i ka ndërtuar në një mënyrë origjinale: në fillim ka vendosur nga një tufë të madhe me poezi, pastaj ka vazhduar me kapitullin që e quan "Pjesa e larme". Këtu çdo vjershe i paraprin një prozë poetike. Kështu, proza poetike "Djaloshi i gurtë" ndiqet nga vjersha për Ferid Grezdën, proza poetike "Në lundrën *Teuta*," e cila bën thirrje për bashkim ("*Ruani zemrat, të mos na e vjedhë armiku dashurinë!*" - thërret poeti) ndiqet nga vjersha "Në qershor...". Këtë nuk e bën thjesht për të thyer monotoninë vjershë, vjershë, vjershë, po edhe


me një qëllim tjetër më të madh, duke vendosur një lidhje të brendshme midis prozës e poezisë. Te "Djaloshi i gurtë" flitet për një shtatore që ndërton mjeshtri popullor për të nderuar trimat në lashtësi, ndërsa te vjersha për Ferid Grezden flitet për një pionier dëshmor që u kthye në përmendore; në prozën poetike "Në lundrën "Teuta", "flitet për dashurinë që ushqenin ilirët *ndaj* njëri-tjetrit, së bashku nuk i thyente dot armiku, ndërsa në vjershën "Në qershor..." fëmijët së toku thurin ëndrra të bukura për të ardhmen, që ta çojnë vendlindjen më përpara: "*Ky bën projektin e urës / a të uzinës, sipas dëshirës. / Ai në ledhe të qytetit të zhdukur / lexon mbishkrimet ilire!*"

Siç shihet, Vehbi Kikaj është një poet sa lirik, aq edhe epik e dramatik. Ai i këndon historisë në funksion të së tashmes, ashtu siç i këndon edhe së tashmes e së ardhmes. Në histori u këndoi ilirëve, rilindësve e dëshmorëve, në të sotmen u këndon fëmijëve kosovarë, nxënësve, shkollës e gjuhës sonë, në të ardhmen i këndon Kosovës: "*Kushedi ç'ëndërronte / mësuesi në dritare të vet./ po rruga që ai më tregonte / sa bukur, sa bukur më pret!*", se fëmijët janë ata që do t'ia ngrehë edhe më lart emrin Kosovës së tyre të dashur.

Format e ligjërimit poetik që përdor poeti Vehbi Kikaj janë të shumta, të ndryshme e të larmishme. Duke e njohur natyrën e botën e fëmijës, që kërkon larmi ndërtimesh e jo monotoni edhe në vjersha, poeri disa poezi i ka thurur si përshkrime "E nisëm një shtator", "Dy shitëse të luleve", "Ti, dëborë, ke mbuluar Opojën"; disa peisazhe si: ("Pranvera hyri në kopsht", "Pemët në verë" "Kafazet e verës") etj., disa si monologë e dialogë të heronjve lirikë ("Luante si qengj", "Kah shkon lumi", "Cili ka faj?" etj.); disa si tregime të vogla, ku i ka dhënë përparësi edhe fabulës ("Anijet e vogla", "U gëzua bishtkuqja", "Urimi i nënës" etj.); disa i ka ndërtuar në formë lodrash, që u pëlqejnë shumë të vegjëlve ("Lum drieri", "Cili ka zemër të artë" etj.); disa në formë meditimesh

("Shtëpia ime ka sy", "Stina e re" etj.) dhe disa në formë baladash e poemthash ("E pastaj në Shalë/ qershia na jep një djalë" - kushtuar Migjenit -, "Këngë për nipin e vogël" etj.). Për të mos i rënduar lexuesit e vegjël, disa herë poezitë e veta i ka ndërtuar si mozaikë, duke vendosur edhe nëntituj ("Këngë për nipin e vogël"), ose personazhe që flasin ose tregojnë, me emra të huajtur nga gurra popullore, si Sygështenja, Flokëverdhi, Sypëllumbi, Fytyrëbora etj., te "Stina e re". Në disa raste poeti i ndërton poezitë e veta si enigma, të cilat vijnë e shfaqen dhe qartësohen para fëmijës, duke ngjallur dëshirën e tij për zbulime të reja: "Në qershor", "Kojrrillit të humbur", "Mrika e peshku". Nga shembujt e mësipërm shihet qartë se poeti përdor me mjeshtëri të madhe mjete e forma të ndryshme të komunikimit artistik, gjë që u shkon shumë për shtat lexuesve të vegjël.

Vehbi Kikaj ka qenë njohës i thellë dhe i pasionur i folklorit. Ai i ka shfrytëzuar me zotësi krijimet burimore të gurrës popullore si një pjesë shumë e rëndësishme e përvojës njerëzore, që jo vetëm duhet lexuar, përvetësuar e respektuar, por duhet përpunuar e ngritur edhe më shumë në art. Në poezinë e vet ai nuk merr fjalë, figura ose vargje nga poezia që ka krijuar populli në shekuj, për t'i futur në vjershat e veta, siç ndodh disa herë me poetë të tjerë; ai merr frymën e tyre, disa herë mënyrën e ndërtimit, mjeshtërinë dhe teknikën e vargëzimit. Vehbi Kikaj përvetëson shpirtin e këngës popullore. Kështu, në poezinë "Pemët në verë" vë re se autori ka shfrytëzuar tërë këtë begati mjetesh e mënyrash ligjërimit të folklorit, prandaj vjersha ka vlera të spikatura ideoartistike dhe të kujton krijimet më të bukura popullore: "*Mollës-së hollës / iu ka tharë fyti, / për një gotëz uji / dielli e mbyti*". Dhe pastaj në krye të çdo strofe, ashtu siç ndodh në këngët popullore të motmotit e në përgjithësi në ato që u drejtohen fëmijëve, vjen refreni: "*Dardhës-së bardhës...*", "*Kumbullës - sumbullës...*", "*I pari kopshtari...*", ose "*Ç'nuk bën vaki / A s'është çudi? / "Hajni", "Kur të shkosh,*



lum dreri...”, “*Kur fluturon, lum zogu...*”, “*Kur fillon era*”, “*Këngë e lehtë*”. Këtë dukuri e ndesh edhe në shumë vjersha, si te “*Kah shkon lumi?*”, “*Pyetje të pakuptimta*” etj.

Vehbi Kikaj flet dhe komunikon me fëmijët në mënyrë të natyrëshme aty ku i ndesh, ashtu siç ndodh në jetë, por shpesh i vendos edhe në mjedise të krijuara artistikisht. Kështu, heronjtë e vjershave të tij do t’i gjesh duke lexuar një libër ose një vjershë “*E nisëm një shtator*” duke luajtur “*Luante si qengj*”; duke punuar “*Pranvera hyri në kopsht*”; duke ëndërruar brenda në dhomë “*Ne të rriturit*”; duke pritur babanë që të vijë nga kurbeti “*Ti, dëborë, ke mbuluar Opojën*” duke shitur lule “*Dy shitëse të luleve*”, por edhe duke shëtitur si në ëndërr me Migjenin “*E pastaj në Shalë, - qershia na jep një djalë*”; duke përgjuar drerin në thellësi të pyllit “*Këngë e lehtë*”, ose duke i vënë shtëpisë gojë, veshë e sy “*Shtëpia ime ka sy*”. Gërshetimi i tyre i ka dhënë bukuri të veçantë poezisë së tij.

Duke qenë kërkues në krijimtarinë e vet për të sjellë në të fjalë të pathëna gjer më sot dhe duke qenë vëzhgues i thellë për të gjetur gjëra të reja kudo, edhe aty ku të tjerëve nuk u tërheq aspak vëmendjen, Vehbi Kikaj bën zbulime interesante, që lënë mbresa te lexuesi. Mollëkuqja, një insekt i vogël fluturak, është shumë i dashur për fëmijët tanë anëmbanë atdheut. Për të populli ka krijuar disa këngë të bukura. Aq i dashur është ky insekt, sa që populli i ka vënë edhe disa emra: mollëkuqe, nuse, nusepashka, bubë (emër zvogëlues e përkëdhelës i fjalës buburrec), pikalore etj, për ta bërë më të dashur e më të afërt për të vegjëlit. Fëmijët e kapin në pranverë, e vënë në pëllëmbë të dorës dhe bëjnë një rit të vogël, duke thirrur: “*Bubë, bubë, ku i ke dajët / hapi krahët fluturo !*” në Veri, dhe “*Nusepashke, nusepashke, / ti e sjell te ne pranverën !*” në Jug. Pastaj e lëshojnë në hapësirë. Këtij insekti poeti i vesh një xhaketë (ç’detaj intrigues pr lexuesin e vogël!) “*Në xhaketën e kuqe / ke shtatë pikë...*”. Më tej poeti operon me mjete të poezisë dhe në strofën e dytë mollëkuqen e nis nuse: “*Lule më lule/ ti*

merr erë,/ bëhesh nuse/ në pranverë!”. Jo vetëm fjala nuse dhe riti i nusërisë në pranverë, po krejt strofa dhe poezia të kujtojnë këngët lirike popullore.

Kulmin e vet vjersha e arrin në strofën e tretë, ku poeti, me një mprehtësi të habitshme, ka kapur një detaj aq konkret, po dhe aq fantastik, siç është gërshetimi xhaketë e kuqe me pika të zeza, e cila i kujton flamurin tonë: “*Në gëzimet tona / fluturo ti,/ me xhaketën / kuqezi!*” Edhe në një vjershë të thjeshtë për një insekt poeti di të bëjë përgjithësime të mëdha dhe fut me mjeshtëri motivin atdhetar, motiv ky aq i dashur e aq për zemër në poezinë kosovare për të rriturit për fëmijët. Dhe jo vetëm kaq. Autori e thërret mollëkuqen të fluturojë në gëzimet e fëmijëve dhe të popullit, se flamuri veç gëzime e krenari të sjell kudo që e shikon, edhe në xhaketën fantastike të një insekti!

Tema e mërgimit dhe e plagëve të tjera shoqërore është shumë e trajtuar në poezinë bashkëkohore kosovare e më gjë gjerë. Këtë temë e rrahin poetë të njohur që shkruajnë për fëmijët, si Rexhep Hoxha, Rifat Kukaj, Agim Deva, Mehmedali Hoxha, Abdylaziz Islami, Ali Huruglica, Fejzi Bojku, Gani Xhafolli, Zejmullah Halili e plot të tjerë. Edhe pse vetëm në dy vjersha, temën e mërgimit e ka kapur e trajtuar edhe Vehbi Kikaj, me një këndvështrim tepër origjinal e të papërsëritshëm.

Dy vjersha, po që vlejné aq shumë e janë shkruar aq bukur!

Në qendër të poezisë “Ti, dëborë, ke mbuluar Opojën” autori ka vënë në qendër një fëmijë që e ka babanë në mërgim. Kurbeti është i ftohtë si dëbora, që i ndan dhe i largon njerëzit, se zë shtigjet e ndërpret rrugët. Ç’paralelizëm i bukur, i fuqishëm e i qëlluar! Fëmija që pret të atin nuk e do dëborën, edhe pse është e bukur dhe e bardhë. Së pari, se nuk e lë të dalë te kroi për të luajtur me shokët, prandaj i thotë: “*Je e bardhë, po s’më dhimbesh!*” (në kuptimin: nuk më pëlqen, nuk të dua). Me fantazinë e vet fëmija do që ta shndërrojë dëborën në bar, që “*Të kullotin qengjat!*” Më

tej, po me fantazinë e vet, vogëlushi i vesh dëborës ngjyrën e kuqe të luleve, se kështu do të vinte pranvera dhe fëmija do të mblidhte tufa me burbuqe. Dhe prapë refreni pikëllimtar “Je e bardhë, po s’më dhimesh!” Dëborë i ka mbyllur brenda fëmijët, se Opoja është e rrethuar me male të larta dhe të ngirin thëllimi. Ajo “*fëmijëve ua ka vjedhur lojën*” dhe e ka çuar diku larg. Nuk ua ka marrë, po si e keqe dhe e egër që është për të varfrit, ua ka vjedhur lojën, se autori nuk e sheh dëborën nga dukja, por nga thelbi.

Dhe prapë vogëlushi ëndërron e bën thirrje që dëborë të derdhet si shi në lumë, që “*lumit t’i kthehet lejleku!*” Ëndërron që ajo të bjerë si fluturat në livadhe, në mënyrë që “*luadhit t’i kthehet ylberi!*” Në këtë shkallëzim ngjyrash, elementësh të dashur, si lulet, livadhet, lejlekët, ylberët, qengjat, shiu, gjelbërimi, fluturat etj dhe mori detajesh interesante, i vogli kërkon që të vijë pranvera. Pse e bën autori këtë shkallëzim? Për të dalë tek ideja e madhe se mërgimi, ashtu si dimri e dëborë, i ndan njerëzit për së gjalli. Fëmija do pranverën, që bashkë me lejlekët t’i kthehet edhe babai nga mërgimi dhe “*të bëjmë një dasmë të madhe!*” Jo gëzim, thotë autori, po dasmë të madhe!

Në këtë vjershë bota shpirtërore e heroit është e vrarë, se i mungon i dashuri i zemrës, i mungon edhe *loja, gëzimi i fëmijërisë*. Kështu, *qysh i vogël ai hyn në vallen e jetës së rëndë*, në të cilën ëndrrat e bukura shkatërrohen nga realiteti. Po shpirti i heroit vritet edhe më keq kur shkon edhe vetë në mërgim, siç ndodh në vjershën e gjatë “*Këngët për nipin e vogël*”. Temën e mprehtë të mëgimit krijimi e shpreh nga bota shpirtërore e të voglit, botë kjo që tjetërsohet nga realiteti i hidhur i mërgimtarëve.

Kjo vjershë e gjatë, a, si mund ta quajmë ndryshe, poemth, ka katër këngë me nga dy strofa katërvargëshe (katrena). Kënga e parë i fut tërthorazi te kjo temë e madhe dhe e trishtuar nëpërmjet fjalës së poetit: “*Edhe zogu i vogël lumin s’e do / kur e hedh në zallin pa ujë!*”

Nga kjo hyrje poeti kalon te jeta konkrete dhe na shpalos Stambollin, një nga qendrat ku kanë emigruar sa e sa kosovarë. Stambolli jepet me shkëlqim të jashtëm përrallor, që në kontrast me të të dalë edhe më bukur bota e trazuar dhe e vvarë shpirtërore e kosovarit të vogël, i cili ka marrë rrugët e mërgimit. Megjithëse qyteti është shumë i bukur e fantastik dhe aty ka banuar Naimi ynë i madh, heroit nuk i pëlqen dhe thotë: "*I bukur është, dajë, me ty!*"

Pra, bukurinë e çdo gjëje poeti e lidh me praninë e njerëzve të afërt në këtë qytet të madh e të huaj. Kështu arrihet në përfundimin se, sado madhështor të jetë Stambolli, ai nuk është i bukur për kosovarin që ka humbur vendlindjen.

Më tej daja i vet i bën thirrje të shkojë e të marrë disa vjollca te vajzat e varfëra që i shesin rrugëve, pasi e di që i pëlqejnë shumë vogëlushit, se i kujtojnë vendlindjen. Mirëpo ai i përgjigjet se: "*Lule nuk lyp.../ gëzim kush në zemër s'ka!*"

Në pjesën e katërt poeti e zbërthen edhe më thellë portretin shpirtëror, moral e tragjik të kosovarit të mërguar. Fjalët e fëmijës nuk janë lutje e ankim, por akuza ndaj atyre që duan t'u humbasin identitetin kombëtar. Atij gjithmonë i kujtohet vendlindja, edhe kur sheh hënën ose diçka tjetër: "*Që hëna në mbrëmje vonë / edhe këtu vjen si në Prishtinë*", mirëpo ky vegim shuhet menjëherë, se "*babi në punë gjithmonë / veç për gjumë e ka shtëpinë!*" Një realitet i trishtuar e shkatërrimtar ky! Babai e merr me të mirë fëmijën që të mos rrijë i vetmuar e i mërzitur, dhe i thotë se "*...do të bëhemi të pasur*". Po kosovarin e vogël nuk e josh e nuk e qetëson një gjë e tillë, për arsye se atë e bren diçka tjetër shumë më e madhe e njerëzore, prandaj e pyet të atin, kur të pasurohemi: "*A mundem vendlindjen ta blej?*" Po në vend të përgjigjes sheh lot në sytë e tij.

Kështu është shkatërruar krejt ëndrra e fëmijës dhe vjersha s'ka pse të vazhdojë më tej, se babai s'ka ç'përgjigje t'i japë, prandaj poeti e mbyll krijimin me vargun tronditës e domethënës: "*A mundem vendlindjen ta blej?*"

Ky është një poemth me tension të madh emocional për mërgimin dhe ka një pikënisje nga jeta e rrethi i vetë poetit, pasi dihet se krijimin ia ka frymëzuar i nipi i vet, i cili mori rrugët e mërgimit qysh kërthi. Prandaj poezia ka dalë kaq tronditëse, dramatike dhe jetësore njëkohësisht.

Vetëm një poet i talentuar e me ndjenja të thella mund të sjellë zbulime kaq origjinale e kaq domethënëse si ato që sjell Vehbi Kikaj edhe vetëm në një ose në dy vjersha! Poezi të tilla, që i ndesh jo rrallë në përmbledhjet e tij poetike, tregojnë se me sa për kushtim punonte poeti në poezinë për fëmijë, duke u ngjeshur me ide të mëdha të ditës, me detaje nga më të spikaturat dhe me fantazi të pakrahasueshme.

Poezia për fëmijë e Vehbi Kikajt ka edhe shumë bukuri e veçori të tjera poetike, që i ndesh tek ai e të rrallë të poetë të tjerë. Të tilla janë pasuria e madhe metrike, ritmike e melodike, gjuha e pastër, e punuar dhe me fjalor të zgjedhur, gjetjet interesante, fabulat intriguese, detajet e qëmtuara me kujdes dhe figuracioni i begatë e tepër origjinal. Mjeshtër i vargut e zotërues i metrikës, ai ka ndërtuar vargje që nga katër gjer te dymbëdhjetërokëshi dhe gërshetime të tyre nga më të larmishmet, si dymbëdhjetë e gjashtërokëshi, tetë, shtatë e pesërokëshi etj.: “*Unisën do thnegla pyllit të bleruar/ mbi gjeth si në barkë*” dhe “*Ç’nuk bën vaki kësaj vere/ kumbulla mirë u nxi/ ç’nuk bën vaki!*”

Në veprën e tij përdoret një shumëllojshmëri strofash, që nga distiku (“*Dy shitëse te fontana presin / pranverën në qytet na e shesin*”), te tercina (“*E lëshon. Tre zogj këndojnë:/ dy në degë - mbushur gëzime, / i treti- në zemrën time*”), katrena (“*Lisi është / kafaz pa derë/ në të këndon / bilbili në verë*”) pentastiku (“*Kur të shkosh, lum dreri,/ të pish ujë te gurra - / ujin mos e ndal!! Ujin e duan zogjtë/ që këndojnë mbi mal*”), strofat gjashtëshe (“*Vogëlush, ç’paska ngjarë? / Oh, eja sa më parë / se sot u bë rrëmujë:/ në govatë lundra ime,/ po rri si e ngrime, / sepse nuk ka ujë*”), gjer te

vjershat në kolonë dhe tetë e dhjetëvargëshe, si dhe gërshetime të tyre brenda së njëjtës vjershë, siç ndodh, psh, te poezia “Pranvera hyri në kopsht”, ku gjen strofa me dy, katër e tetë vargje etj.

Në poezi ai i zgjedh fjalët duke e pasuruar fjalorin e të vegjëlve me fjalë pak ose aspak të njohura e të përdorura nga fëmijët, si: *Arkimed, rendit* (klasës) *pullaz, blegë* (blegtoreshë, bareshë), nga fjala blegëron, *lila* (lloj lulesh), *trotinetë* (një lloj biçiklete prej druri, pa zinxhir e pedalina), *tutet* (frikësohet), *rritën* (jetën), *etçuara* (që kanë etje), *cuba* (hajdutë, kaçakë), *nënkrejca* (jastëku), *gogla, shpendia* (shpendët), *ngarendin* (vrapojnë), *hajni* (vjedhësi, hajduti), *pendlat* (pendët e vogla) etj, etj.

Me rimat autori punon gjer në imtësi dhe fjalët i vendos si ai mjeshtri që i skalit e i puthit si rrallëkush gurët dhe me ta bën qoshe e qemere që të befasojnë. Rimat e tij janë të pasura e tingëllojnë në mënyrë që të mbeten në veshin, syrin dhe mendjen e fëmijës dhe t’ia bëjnë më të dashur poezinë:.. “*merr librat e flej mbi to... (kur s’mëson, O.G.), me formulat e veta H2O*”, “*Pylli i fjetur/ me përralla në degë / tufën e humbur / kërkon një blegë*”, dhe çiftet “*fyti-mbyti, dora-gjora, natë-limonadë, rritën-ditën, flini-mini (miu), verën-erën, Opojën-lojën, sylinjarë-udhëtarë, gushën-fushën, verë-frigoriferë, shterë-bjerë (i humbur), degëfaqeshegë etj.*

Fabulës, gjetjes, detajit dhe figuracionit poeti u kushton kujdes të veçantë, pasi këto elementë të formës i sheh si ndihmesë të rëndësishme për të shprehur sa më mirë e sa më qartë idetë, mendimet, ndjenjat e brendinë dhe si mjete për ta bërë poezinë më të kapshme e më të afërt për të vegjlit. Fabulat i ndërton të thjeshta, shpesh intriguese e me humor dhe në mënyrë shumë konçize. Në vjershën “Hajni”, si në shumë të tjera, autori ndërton një fabul që i tërheq shumë fëmijët. Kështu, një i vogël futet natën fshehurazi në kopshtin e huaj, pasi kumbulla është nxirë mirë:.. Lexuesi i vogël pret që heroí i vjershës të zgjatë dorën e të këputë kumbullat e arrira, që aq shumë u shijojnë fëmijëve. Por jo. Autori e ka

tjetërkund fjalën: fëmija ka hipur në kumbull për të kapur hënën. se i dukej sikur fshihej si në kukamshehti në degët e fletët e saj. Madje lexuesi thërret në fund të vjershës: “*A s’është çudi?/ A s’është çudi?*”

Ose të marrim vjershën “Ne të rriturit”, të cilën e përshkon një fije humori që nga fillimi në fund. Ajo është ndërtuar si një monolog i heroit lirik, i cili u tregon shokëve se ai s’luan me trotinetë si ata, pasi nget biçikletën; s’luan me arinj-kukulla, se është gjahtar dhe i ndjek në male e në pyje me çifte në dorë; nëna nuk e detyron të pijë qumësht dhe ai di sa larg është hëna e s’merret me minjtë se ku flenë... Dhe seria e mburrjeve vjen duke u shtuar, pasi heroit thotë se fëmijëve që nuk rrinë urtë, u heq veshin, vajzave që nuk rrinë pastër, u tërheq bishtalecat... sepse është i rritur e s’është më i vogël.

Në fund të vjershës, meqë është mbremje, fëmijët i thonë këtij “të rrituri” “*A shëtitim nën rreze të hënës?*” Dhe ai u përgjigjet : “*Ah jo! U vonova... Nuk guxoj prej nënës!*” Dhe pastaj vjen fundi logjik i fabulës dhe i vjershës: “*Lëvdohej një djalë shtatëvjeçar*”, që hiqej si i rritur. Fabula është ndërtuar mbi shkallëzimin e mburrjeve të heroit dhe mbi të papriturën se ky “i rritur” është një fëmijë. Kështu, poeti Vehbi Kikaj në fund të çdo vjershe bën një përmbyllje të mendimit, të idesë dhe të fabulës dhe kjo e bën atë që të zgjedhë mënyrën e të rrëfyerit, lidhjen e ngushtë të gjymtyrëve që ka vjersha, sado e vogël qoftë. Fabula të tilla s’ka si të mos u mbeten në mendje të vegjëleve. Si këto fabula gjen me dhjetëra në përmbledhjet poetike të këtij autori, si në “Kah shkon lumi?”, “Luante si qengj”, “Cili ka faj?”, “Sa mirë do të ishte” etj., etj.

Vjershat e Vehbi Kikajt janë të mbushura me detaje, gjetje e figura nga më të ndryshmet, më të bukurat e më të spikaturat. Në vjershën “Hajni”, për të cilën folëm më lart, autori thotë: “*Dorën pak e ka zgjatur/ hënën e artë për ta kapur*”, ëndërr kjo e çdo fëmije; “Pemët në verë” autori i ujit me limonadë e jo me ujë: “*I pari-*

kopshtari/ zgjohet që menatë/ pemëve të etçuara/ u jep limonadë”; në vjershën “E nisëm një shtator” rrugën e nxënësve në shkollë e krahason me një urë të gjatë e të vështirë:

“*Një shtator, e nisëm një shtator / urë të gjatë na duhet kaluar / e kjo urë e ka fundin në qershor / kur të kalojmë, përshëndetemi: gëzuar!”;* në vjershën “Kah shkon lumi?” ndërton dy figura, duke u mbështetur në krijimtarinë gojore të popullit: “*Lumi ka lejlekët e vet/ lundrat tona i shpie në det!*” (Në vjershë lejlekët autori i quan postierë dhe ëndërrat e fëmijëve lundra që çajnë dete e oqeanë.) Dhe vazhdon kështu nga vjersha në vjershë, duke ua shtuar vlerat dhe bukurinë: “*Vallë, pse s’habitet qershia/ të bëjë nganjëherë dardha?*” (“Pyetje të pakuptimta”), “*Dielli s’është portokall/ sepse djeg në verë/ por kroi e ftoh ujin/ si në frigoriferë*” (“*E pastaj në Shalë, / qershia na jep një djalë*”). Shembujt janë të shumtë e të larmishëm, sa do të shkonte shumë gjatë sikur të përmendnim edhe një pjesë të vogël të tyre.

Krijimtaria poetike e Vehbi Kikajt zë një vend të veçantë e të nderuar në letërsinë shqipe për fëmijë që krijohet në Kosovë, e më gjerë, dhe ka vlera ideotematike e artistike, duke u dalluar midis poetëve të tjerë për zërin e vet origjinal. Ai shkroi me dashuri të madhe për fëmijët, duke i quajtur ata shokë të vet e duke i trajtuar si të rritur dhe jo si të vegjël, prandaj arriti kulme në poezinë që shkruhet për ta.

Me vdekjen e tij lexuesit dhe veçanërisht lexuesit e vegjël humbën një mik të madh e shumë të dashur.

NDERIM PËR REVISTËN “VATRA E RINISË”

Duhet të ketë qenë data 20 ose 21 nëntor 1944, kur Tirana sapo ishte çliruar. Duke kaluar para Ministrisë së Arsimit (ndërtesa përbri Teatrit të sotëm të Kukullave) pashë një njeri me gjyslykë dhe me çelës në dorë. Ai po hapte portën me hekura të Ministrisë me një çelës të madh. Si fëmijë që isha, më bëri përshtypje ai çelës dhe pyeta vëllaun e madh që më shoqëronte se cili ishte burri me çelës dhe çfarë po bënte. Vëllai më tha se ai ishte Vasil Xhaçka, një nga nëpunësit e parë të Ministrisë së Arsimit në Shqipërinë e re.

Emri i Vasil Xhaçkës nuk ishte i panjohur për mua. Në vitet ‘40 më kishin rënë në dorë disa numra të revistës “Vatra e Rinisë” dhe i kisha lexuar fillim e mbarim. Aty kisha ndeshur në emrin e Vasil Xhaçkës jo vetëm si botues i revistës por edhe si autor i shumë krijimeve letrare e publicistike.

Qysh atë ditë që e pashë Vasil, Xhaçka më mbeti në mëndje me një çelës të madh në dorë: me këtë çelës ai u kishte hapur derën sa e sa krijuesve për të hyrë në botën e bukur të letërsisë, u kishte hapur derën mijëra e mijëra lexuesve të vegjël për të shuar atjen e leximit në faqet e revistës “Vatra e Rinisë”.

Vasil Xhaçka lindi në vitin 1895 në katundin Ziçisht të Korçës në një familje të mesme fshatare me tradita atdhetare. I ati ka qenë qymyrxhi dhe vdiq shumë i ri. Vasilin e la trevjeçar dhe ai u rrit te gjyshja nga nëna. Në fshat mbaroi shkollën fillore dhe pastaj shkoi pas nënës në Greqi, te njerku i vet. Aty punonte për të nxjerë bukën e gojës e vazhdonte edhe shkollën. Mbaroi të mesmen dhe bëri punë të ndryshme si ndihmës farmacist etj. Në vitin 1912, fill pas shpalljes së Pavarësisë, u kthye në atdhe dhe punoi mësues në fshatin e vet e në fshatra të tjerë të rrethit të Korçës, gjer në vitin 1922. Kështu ai u bë një nga mësuesit e parë të gjuhës shqipe në fshatrat e Korçës e tok me intelektuaklë të tjerë përparimtarë luftoi që edhe nëpër kisha të futet ceremoniali në shqip. Pas vitit 1922 erdhi në Tiranë dhe u muar me gazetari, pasi ishte nën ndikimin e lëvizjes demokratike të asaj kohe. Punoi redaktor, drejtor e administrator në disa gazeta e revista dhe, në vitin 1933, filloi të botojë revistën “Vatra e Rinisë”, e cila doli gjer në prag të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Ndërkohë merrej edhe me botimin e “Kalendarit enciklopedik”. Si njeri me mendime përparimtare e me interesa të gjera, duke dashur t’u shërbejë sa më shumë bashkëatdhetarëve botoi edhe disa broshura me karakter kulturor-edukativ si: “Si të flasim e të shkruajmë”, “Si të rritim fëmijët”, “Shoku i familjes”, “Si të sillemi në shoqëri”, “Si të respektojmë të tjerët” etj.

Gjatë regjimit të Zogut Vasil Xhaçka ka qenë njeri me mendime e ndjenja përparimtare. Ai ka qenë pjestar në grupet që përgatitën Lëvizjen e Fierit dhe për këtë u dënua nga rendi në fuqi, por u fal me ndërhyrjen e të njohurve, miqve etj.

Pushtimin fashist e priti me urrejtje dhe Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare me simpati, pasi ishte edhe nën ndikimin e fëmijëve të vet, të cilët u aktivizuan qysh në fillim me lëvizjen e më vonë dolën partizanë dhe luftuan me armë në dorë kundër pushtuesve e tradhëtarëve të vendit. Në verën e vitit 1944, ashtu si

shumë intelektualë të tjerë përparimtarë, la qytetin e Korçës dhe shkoi në zonat e çliruara. Për ca kohë punoi pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Berat. Pas vendosjes së Pushtetit Popullor punoi në Ministrinë e Arsimit, në “Gazetën zyrtare”, në gazetën e minoritetit grek “Llaiko Vima” dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve të Shqipërisë. Ai ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i Bashkimit të Gazetarëve.

Vasil Xhaçka u nda nga ne në vitin 1978.

Kur flasim për Vasil Xhaçkën kemi parasysh në radhë të parë publicistin e botuesin e revistës “Vatra e Rinisë”, e para revistë e posaçme për fëmijët në vendin tonë, por edhe krijuesin, pasi ai, veç artikujve e shkrimeve të ndryshme publicistike shkroi e botoi edhe tregime, skica, përralla etj. Dhe bëri disa përkthime kryesisht nga greqishtja. Këto janë shumë të njohura nga lexuesit e vegjël të viteve ‘30, por nuk janë të panjohura edhe për lexuesit tanë të vegjël. Revista “Fatosi”, qysh në numrat e parë të saj, në vitet ‘60, botoi disa nga krijimet e Vasil Xhaçkës në prozën e shkurtër, disa herë të shoqëruara me shënime të ndryshme për jetën e veprën e tij, edhe me fotografi të autorit. Po kështu botoi edhe “Pionieri”. Mjafton të përmendim tregimin “Kopshtari plak”, në të cilin autori bën paralelizmin ndërmjet “Vatrës së Rinisë” dhe botimeve të shumta për fëmijët që dalin sot për fëmijët tanë. Shkrimtarët e studjuesit tanë Bedri Dedja e Nasho Jorgaqi, në vitin 1958 mblodhën e botuan në një vëllim më vete krijimtarinë më të mirë të Vasil Xhaçkës në fushën e prozës së shkurtër për fëmijët, në librin “Kopshtari plak”. Në këtë libër u përfshinë dymbëdhjetë tregime e përralla me tema edukative e atdhetare si trimëria e guximi “Motra trime”, talentet lindin në gjirin e popullit “Si e gjeti Gjançi punën e tij”, të duam e të mbrojmë pyjet “Hakmarrja e pyllit”, dashuria e fshatarit për kafshët “Kali i fshatarit”, të mësojmë nga natyra “Tre këshilltarët”, ta peshojmë fjalën para se ta nxjerrim nga goja “Shiu dhe Lulja”, të mos prekim gjë pa leje

“Kur trazon dora” etj. Në të gjitha këto krijime spikat karakteri i tyre edukativ, ashtu siç ngjet edhe me shumicën e shkrimeve që u botuan në “Vatrën e Rinisë” nga shumë autorë me përvojë e të rinj të atyre viteve. Këtu bashkëpunëtorët e revistës dhe Vasil Xhaçka ecin në gjurmët e Rilindësve tanë të mëdhenj dhe të letërsisë që krijuan ata për të vegjëlit.

Me revistën “Vatra e Rinisë” dhe me publicistikën e krijimtarinë e Vasil Xhaçkës janë marrë edhe studjuesit tanë, të cilët kanë nxjerë në dritë si arritjet ashtu edhe mangësitë e kësaj reviste e të botuesit të saj, të cilat i kushtëzonte koha në të cilën u botua. Kështu shkrimtari e studjuesi Bedri Dedja, në përmbledhjen e tij me artikuj e kritika¹⁾ ka përfshirë edhe studimin e gjatë “Revista “Vatra e Rinisë” dhe kontributi i saj në zhvillimin e letërsisë shqipe për fëmijë”, ku ndërmjet të tjerave thekson me të drejtë se: “Vasil xhaçka ka meritën sepse themeloi një revistë të posaçme për fëmijët, duke kontribuar në zhvillimin e shtypit për të vegjëlit... Me këtë veprimtari që kreu, Vasil Xhaçka pa dyshim duhet konsideruar si një nga gazetarët e shquar shqiptarë për fëmijë”. Po kështu shkrimtari dhe studiuesi Agim Deva, nga Kosova, në studimin e tij voluminos²⁾ për poezinë shqipe për fëmijë, me “Vatrën e Rinisë” dhe me botuesin e saj Vasil Xhaçka merret disa herë duke vlerësuar ndihmesën e tyre në zhvillimin e publicistikës e të letërsisë për fëmijë në vitet ‘30 dhe duke nënvizuar se “Kjo revistë me kohë u bë tryeza më e denjë ku manifestohej krijimtaria sociale për fëmijë”.

Të ndizje një qiri për të ndriçuar sadopak mendjet dhe rrugën e të vegjëlve në vitet e regjimit të Zogut, ishte vërtet një gjë e bukur e një vepër me vlera në shërbim të edukimit të brezit të ri. Po të ndizje një zjarr të tërë ku të ngroheshin krijuesit e rinj e

1) Bedri Dedja: “Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë”. Botim i Shtëpisë Botuese “N.Frashëri”, 1971.

2) Agim Deva: “Poezia shqipe për fëmijë - 1872-1980”, Botim i “Rilindjes”, Prishtinë 1982.

fëmijët tok, të ndërtoje një vatër të ngrohtë ishte njëherit guxim shumë i madh dhe një shërbim edhe më i madh akoma në dobi të vendit. Një zjarr të tillë u përpoq të ndezë edhe publicisti e shkrimtari për fëmijë Vasil Xhaçka në vitet '30, duke botuar një revistë të posaçme për ta, së cilës i vuri një titull shumë të gjetur e kuptimplotë: "Vatra e Rinisë". Se rreth vatrës shqiptare janë edukuar sa e sa breza në vendin tonë. Vatra ke qenë "shkolla" e parë që kanë bërë fëmijët në Shqipëri ndër shekuj.

"Vatra e Rinisë" doli për herë të parë më 5 shkurt 1933, si e përjavëshme për fëmijët dhe të rinjtë, "nga mosha tetë gjer më tetëmbëdhjetë vjeç" siç e thotë edhe vetë redaksia në shkrimin që çel numrin e parë. U botua me disa ndërprerje nga viti 1933 gjer në vitin 1938, në prag të pushtimit fashist të Shqipërisë. Gjithsej dolën 107 numra. Ndërprerjet qenë të shkurtra e të gjata dhe të gjitha për vështirësi financiare. Mungesa e fondeve për botimin e saj bëri që revista të mos dalë edhe për muaj të tërë, siç ndodhi nga qershor 1937 gjer në 25 janar 1938.

Revista që nxori Vasil Xhaçka ishte një përpjekje e një intelektualit përparimtar e demokrat, e një njeriu që i dhimbsej brezi i ri i Shqipërisë, i cili kërkonte "Pak dritë" siç shprehej Migjeni në një nga poezitë e tij. Megjithë përpjekjet që bëri Vasil Xhaçka dhe njerëzit e tjerë përparimtarë, revistën nuk e ndihmoi qeveria e Zogut edhe pse kishte ndonjë fond të vogël për botime të tilla. Natyrisht regjimi në fuqi nuk mund të përkrahte përpjekjet për të krijuar një letërsi demokratike e përparimtare për fëmijët, nuk mund të përkrahte përparimin e djalërisë shqiptare. Regjimit në fuqi i interesonte që fëmijët dhe të rinjtë të mbeteshin në errësirë. Zogu dhe ata që i shërbenin financonin e përkrahnin me çdo mjet e mundësi letërsinë dekadente, e cila kultivohej nga kalemshinjtë e përkthyesit që kishin shitur penën, talentin dhe shpirtin dhe kërkonin të përpunonin brezin e ri, në përputhje me moralin e klasave në fuqi.

Duke qenë në vështirësi të mëdha financiare për të nxjerë revistën, Vasil Xhaçka më se një herë u bëri thirrje të gjithëve, veçanërisht mësuesve, prindërve e vetë fëmijëve që ta përkrahnin revistën dhe ta përhapnin kudo, edhe te fëmijët e varfër, të cilët, shkruan botuesi: “U dridhet zemra dhe u pikon vrer nga hidhërimi kur shohin shokët e tyre me “Vatrën e Rinisë” në dorë” sepse “nuk kanë ku ta gjejnë gjysmën e lekut që kushton çdo numër i kësaj reviste.” Mirëpo varfanjakët nuk kishin gjysmë leku për të blerë krodhën e bukës e jo më për të blerë ushqim për mendjet dhe zemrat e tyre. Në atë kohë një kërkesë e tillë ishte luks i tepërt.

Në fund të vitit të parë të botimit, në shkurt 1934, Vasil Xhaçka i paralajmëron lexuesit se jeta e revistës është në rrezik. Kështu në nr.39 ai e shpall haptazi këtë kur thotë: “Vitin e parë e kaluam, ndonse me shumë vuajtje e mundime për t’u bërë ballë shpenzimeve të botimit”. Dhe pak më vonë përsëri lëshon thirrjen: “Këndonjës! “Vatra e Rinisë” ndodhet në rrezik! Ai që e çmon dhe e do ta ndihmojë me pajtime!”

Të tilla thirrje u botuan gjer në fund të vitit 1938; disa herë ato u shkruan nga vetë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët u drejtoheshin shokëve të tyre anembanë vendit që të luftonin për ta mbajtur të ndezur vatrën ku ngrohej rinia... Një thirrje të tillë botoi edhe letrari e dëshmori i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Kristaq Tutulani, i cili ka qenë një nga lexuesit e pasionuar dhe bashkëpunëtor i ngushtë i “Vatrës së Rinisë”, fitues i shumë konkurseve që shpallte kjo revistë për të vegjëlit.

Po edhe pse me shumë vështirësi, Vasil Xhaçka vijoi ta botojë “Vatrën e Rinisë”, i ndihmuar edhe nga fëmijët vetë, duke luajtur kështu një rol me rëndësi për edukimin e të vegjëlve shqiptarë të atyre viteve.

Dalja e “Vatrës së Rinisë” u mirëprit nga forcat përparimtare e demokratike të vendit, nga lexuesit e vegjël, mësuesit, prindët dhe gjithë opinioni ynë. Për këtë bindesh kur lexon letrat e

përschendetjet e shumta që i vinin redaksisë. Lexuesit e vegjël që i shkruanin ishin nga Durrësi e Dhërmiu, nga Oroshi e Përmeti, nga Korça e Shkodra, nga Vidohova e Uji i Ftohtë i Vlorës, nga Lukova e Peqini, nga Zerqani e Vunoj. Një fakt i bukur është vizita që i bënë shumë fëmijë botuesit të revistës, Vasil Xhaçkës, në përvjetorin e parë të botimit të “Vatrës së Rinisë”, më 5 shkurt 1934, ditë që u kthye në një festë të vogël por kuptimplote. Fëmijët, mësuesit e prindërit i dërguan përschendetje, letra, madje edhe vjersha ku i uronin jetë të gjatë. “Vatrën e Rinisë” dhe Vasil Xhaçkën i përschendetën edhe gazetatat e revistat e kohës, madje edhe shqiptarët e mërguar. Kështu vogëlushi shqiptar, tetëvjeçari T.D., nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shkruan: “Jam i lumtur që vëllezërit e mi shqiptarë, bij të shqipes, kanë një organ si “Vatra e Rinisë”, të cilën e lexoj edhe unë me kënaqësi”. Ndërsa gazeta e shqiptarëve të Konstancës (Rumani) i dërgoi edhe këto radhë në përschendetjen e vet: “Dëshiroj që “Vatra e Rinisë” të rrojë, të përparojë, të përkrahet e të përhapet sa më shumë. Familjet shqiptare të mërgimit i këshillojmë të abonohen në “Vatrën e Rinisë”.

Daljen e revistës dhe botuesin e saj i përschendetën edhe të rinj që nesër do të bëheshin vetë shkrimtarë dhe që do ta lanin me gjakun e tyre ëndrrën për ta parë brezin e ri të Shqipërisë të lumtur. I tillë ishte Kristaq Tutulani, i cili, në letrën që i dërgonte “Vatrës së Rinisë”, botuar në numrin 49, thotë edhe këto: “Sikundër hunda ime kishte nevojë për erëra lulesh, ashtu edhe mendja ime kërkonte një zambak për t’u dëfryer e për të përfituar. E ky zambak jeti, o Vatër e dashur, që ushqen për ne një dashuri prej nëne...”

Publicisti Vasil Xhaçka, qysh në numrin e parë, në fjalën e redaksisë, u premtonte lexuesve të vegjël se: “Kemi një revistë që do t’ju mësojë sende shumë të bukura e të çuditëshme. Një revistë që do t’ju mësojë shumë sende duke ju dëfryer”. Dhe këtë premtim ai do ta mbajë qysh nga numri i parë gjer tek i fundit, pasi ky ishte

programi i revistës, një program me kërkesa përparimtare e atdhetare për kohën, pavarësisht nga lëkundjet e zikzakët që pati herë pa here. Kështu “Vatra e Rinisë” u mësoi lexuesve të vegjël të shohin mirë gjithshka ndodhte rreth tyre. Në regjimin feudoborgjez të Zogut nuk kishte si të lulëzonin lulet, nuk dilte dielli pranveror, nuk bleronin fushat dhe lumenjtë nuk rridhnin gazmorë, as zogjtë këngëtarë nuk ia thoshin bukur dhe fytyrat e fëmijëve nuk ishin të qeshura e të gëzuara. Prandaj nëpër faqet e revistës vërshonin copa nga mjerimi, copa nga realiteti i zyrtë i atyre viteve dhe shkrimet u mbushën nga numri i parë gjer tek i fundit me lypës, bonjakë, të varfër, të mjerë, kurbetllinj, sakatë e varre. Këtë e tregojnë edhe titujt e shumtë të krijimeve që botoi “Vatra e Rinisë” në prozë e në poezi si : “Varri mbi mal”, “Mbi varrin e nënës”, “I mërguari”, “Sakati”, “Bonjaku”, “Jetimi”, “Ke vorri i nanës”, “I mjeruari”, “I ardhhtë keq”, “Të mjerët”, “Varri i nënës”, “Dora e shtrirë”, “Lypësit”, “E vetmuemja”, “Vetmija”, “I verbri”, “Lotët e nënës”, “Jevga”, “Djali i vetmuar” dhe përsëri “Mbi varrin e nënës”...

Jo vetëm në krijimet letrare por edhe në shumë shkrime publicistike të redaksisë, të Vasil Xhaçkës apo të bashkëpunëtorëve të ndryshëm, vend kryesor zë mjerimi, vuajtja, shtypja, varfëria. Prandaj disa herë rresht Vasil Xhaça ngre zërin në revistë për të ndihmuar të varfërit, ata që nuk kanë asgjë. Kështu në numrin e 14 shkurtit 1937 lëshon thirrjen: “Ndhmoni të vobektët... Kudo po mblidhen ndihma për ta!” Dhe për ta çuar edhe më tej këtë thirrje Vasil Xhaça pajton falas herë pas here fëmijë të varfër që e donin dhe e përhapnin “Vatrën e Rinisë”. Dikujt i dërgon një numër, dikujt dy e dikujt tjetër edhe më shumë. Poshtë këtyre thirrjeve gjithmonë revista do të botojë edhe ndonjë vjershë ose tregim me tituj tronditës: “Bonjaku” në nr.37, “I mjeruari” në nr.38, “Lëmosha” në nr.72 etj.

Natyrisht problemi i varfërisë së madhe, i skamjes e i mjerimit,

i shfrytëzimit e shtypjes nuk zgjidhej me thirrje e lëmosha, por “Vatra e Rinisë” dhe botuesi i saj bënin një punë të madhe duke e pasqyruar këtë gjëndje në faqet e revistës ashtu siç ishte, pa e zbukuruar, duke ju kundërvënë haptas shtypit zyrtar që e paraqiste në lulëzim e mirëqënie Shqipërinë e atyre viteve.

Shumë herë duke mos dalë dot haptas kundër rendit në fuqi dhe për shkak të kufizimeve si në vlerësimin e gjendjes ashtu edhe të perspektivës, në shkrimet që botonte “Vatra e Rinisë”, mjerimi, varfëria e vuajtjet jepeshin simbolikisht, disa herë edhe me stinët, me festat e motmotit etj. Prandaj edhe krijimet mbusheshin me erërat e vjeshtës, me fletët e verdha që rrëzoheshin nga furtuna dhe nga ngricat e dimrit që të thanin...

E shtypur nga regjimi i Zogut, në Shqipëri jo vetëm që nuk mbylleshin plagët e shumta shoqërore, por përkundrazi shtoheshin dita ditës. Këto ishin plagë të mëdha që i thellonte shoqëria me klasa, të cilat goditnin pa mëshirë edhe fëmijët, madje ata në radhë të parë. Me krijimet e tyre shumë autorë nuk paraqitnin vjeshtën me shira e mjergull por rendin në fuqi që ishte në kalbëzim. Çdo gjeth i zverdhur, si në vjershën “U thanë gjethet” të Kristaq Tutulanit, çdo lule e vyshkur, si në vjershën “Djali dhe lulja e vyshkun” të Mark Gurakuqit etj., çdo pamje e zyrtë e çdo peisazh i vetmuar i përshkruar në krijimet që botonte “Vatra e Rinisë” ka funksionin e vet për të paraqitur me besnikëri shoqërinë e prapambetur e reaksionare të kohës në të gjitha shfaqjet e veta.

Këto janë temat zotëruese në revistë. Po autorët shpesh herë u drejtohen edhe momenteve të ndritura të historisë sonë kombëtare, në emër të një ideali të ri që i nevojitej popullit në një periudhë të tillë të errët siç ishte ajo e regjimit të Zogut. Prandaj në faqet e revistës do të gjeesh edhe krijime që evokojnë fytyrën e ndritur të Skënderbeut, siç ishte vjersha e nxënësit të gjimnazit të Korfuzit Spiro Çomora, dialogu i gjatë “Flamuri dhe shqiptari”, i nxënësit të shkollës Tregtare të Vlorës Aleks Çaçi, vjersha “Shqipëria” e

nxënësit të gjimnazit të Shkodrës Mark Gurakuqi, apo shkrimi i Vasil Xhaçkës “Mos harro se je shqiptar”, ku autori ndërmjet të tjerave u thotë të vegjëleve: “Dua që edhe juve miqve të mi të vegjël t’u shoh të gjallë dashurinë për atdheun tuaj të bukur. Dua t’ju dëgjoj në çdo rast që të thoni me gojë dhe me zemër: “Jam shqiptar!”

Shkrimet që i kushtohen atdheut janë me dhjetëra, ashtu siç ka edhe vjersha, tregime etj. që i kushtohen plakut atdhetar Ismail Qemali ose fshatit. Vend me rëndësi në faqet e “Vatrës së Rinisë” zë edhe flamuri kombëtar, të cilit i këndohet në prozë e në poezi. Ka shumë shkrime që i këndojnë flamurit, disa herë gjithë numri i kushtohet këtij simboli të kombit si “Valo flamur”, “Flamuri shqiptar”, “Ngritja e flamurit”, “Lart flamurin”, “28 nëntor 1912” etj. Po mbi të gjitha i këndohet popullit tonë trim e atdhetar, punëtor e liridashës, siç ngjet në shkrimin “Trimëri dhe sgjuarësi”, të botuar në numrin 69, ku i këndohet njeriut të thjeshtë, të varfër e të papërkultur. Në këtë shkrim të Vasil Xhaçkës shpallet me krenari: “Duhet të krenohemi me popull që kemi! Ta mësojë bota se shqiptari nuk ka duruar e as nuk duron kurrë përunjësi para armikut!”

Në revistën “Vatra e Rinisë” është trajtuar shumë edhe tema e dashurisë për njerëzit, prindët, farefisin, miqtë, shokët e dashamirët. Veçanërisht e trajtuar është dashuria për nënën. Asaj i këndohet në prozë e në poezi dhe gjithmonë ngrihet lart figura e saj si krijuese e jetës, por edhe si viktimë e shoqërisë me klasa. Kështu në vizatimin letrar të botuar në nr.55, datë 10 shkurt 1934, Heroi i Popullit Qemal Stafa, atëhere fëmijë 13-14- vjeçar lexojmë: “Nana! Ma e ambla, ma e dashtuna, ma e mira fjalë që del prej zemre, ma e para që kemi nxanun, fjala që e kemi shqyptuemun ndër çastet ma të vështira të jetës e ndër gëzimet tona ma të mëdhaja!... Nana! na mësoj me thanun atdhe e me e dashtun megjithë zemër!”

Në të gjitha këto shkrime e në plot e plot të tjera ndeshim në

një frymë disi romantike, por me nota të theksuara realiste që i diktonte vetë koha, mjedisi ku jetonin krijuesit e tyre. Këto nota do t'i gjejmë veçanërisht në tregimet, përrallat, vjershat e shkrimet e ndryshme të shkrimtarëve atdhetarë Milto Sotir Gurra e Ilo Miktë Qafëzezi, te Vasil Xhaçka dhe sidomos te autorët e rinj që përpiqeshin të krijonin një letërsi të re si Aleks Çaçi, Mark Gurakuqi, Spiro Çomora, Moisi Zaloshnja e plot të tjerë.

Në revistë Vasil Xhaçka u bëri vend edhe shkrimeve e krijimeve me tema të larmishme, duke ecur kështu në gjurmët e rilindësve, si për mësimin, shkollën, punën dhe sidomos për edukatën, në rubrikat e larmishme: “Arka e postës”, “Dy fjalë nga dallëndyshja”, “Ç’duhet të dini”, “Zbavitje dhe ushtrime të mendjes”, “Enciklopedia e njerëzve të shquar” etj. Si dhe me krijimtarinë letrare e publicistike që botoi vetë.

Një ndihmesë të madhe e të pazëvendësueshme dhanë “Vatra e Rinisë” dhe botuesi i saj Vasil Xhaçka në dy drejtime me shumë interes për kohën kur kishim rreth nëntëdhjetë përqind të popullsisë analfabete. Së pari, “Vatra e Rinisë” u bë tribunë e forcave të reja letrare që po hynin në letërsi dhe u hapi rrugë talenteve, shumë prej të vilëve më vonë u bënë shkrimtarë të njohur. Në faqet e kësaj reviste i hodhën hapat e para në letërsi Heronjtë e Popullit Qemal Stafa, Margarita Tutulani e Themo Vasi, dëshmorët Gjikë Kuqali, Kristaq Tutulani e Koço Çamçe, Heroi i Punës Socialiste, shkrimtari Besim Levonja, shkrimtarët Jakov Xoxa, Mark Gurakuqi, Spiro Çomora, Nexhat Hakiu, Aleks Çaçi, Moisi Zaloshnja, Thoma Frashëri etj. Së dyti, në “Vatrën e Rinisë” u lëvruan shumë nga gjinitë publicistike e letrare, duke i dhënë kështu një shtytje të ndieshme zhvillimit të letërsisë e të publicistikës për fëmijë, të cilat i kishin nisur rilindësit. Në revistë u botuan tregime, skica, vjersha, legjenda, përralla, fabula, ushtrime, gjëza, loja zbavitëse, artikuj, kryeartikuj, korespondenca, përshkrime, reportazhe, këngë, vizatime etj.etj. Vend me rëndësi zunë edhe

shkrimet e rilindësve si të Naimit, Çajupit, Mjedës, Asdrenit etj. Dhe përkthimet nga vepra e kolosëve botërore si Hugoi, Tolstoi, Charl Peroja, Edmond Deamicis, Turgenievi, Anderseni, Ljuis Kerëli etj.

“Vatra e Rinisë” u bë edhe tribunë për botimin e folklorit. Numër për numër sheh se botoheshin gjëza, vjersha, këngë, përralla, lodra, proverba etj, të cilat i ka krijuar populli ynë në shekuj. Kështu “Vatra e Rinisë” vijoi të eci në gjurmët e “Bletës shqiptare” të Thimi Mitkos dhe “Valët e detit” të Spiro Dines. Madje bëri edhe një hap më përpara pasi Mitkoja dhe Dineja e mblodhën folklorin popullor ndërsa Vasil Xhaçka jua dha në duar fëmijëve për ta lexuar, për ta mësuar e për t’u edukuar.

Vasil xhaçka themeloi një revistë të posaçme për lexuesit e vegjël, një nevojë kjo që e shtronte koha dhe fëmijët, duke u bërë kështu një publicist me emër i viteve ‘30 në fushën e gazetarisë për fëmijët. Me revistën “Vatra e Rinisë” ai u bë edhe një mbështetje e madhe për zhvillimin e letërsisë sonë për fëmijë, ndihmoi shumë në shtimin e leximeve për të vegjëlit me shkrime origjinale e të përkthyer, duke ndikuar fuqimisht në edukimin e brezit të ri të vendit tonë. Vasil Xhaçka u përpoq edhe vetë të krijojë proza të shkurtra për fëmijët dhe të japë mendime për letërsinë e tyre jo vetëm në “Vatrën e Rinisë” që e drejtonte vetë por edhe në organet e ndryshme që delnin atëherë, si në “Ylyria” ku botoi shkrimin e guximshëm “Kujdesi për fëmijët - detyrë kryesore për shtet, për shoqëri e për prindër”.

Për të gjitha këto, publicistin e shkrimtarit Vasil Xhaçka, themeluesin e revistës “Vatra e Rinisë”, e kujtojmë me respekt dhe e nderojmë për shërbimet që i ka sjellë brezit të ri, letërsisë sonë për fëmijë dhe vendit të vet.

KUR SHKRUAJMË GJËAGJËZA PËR FËMIJËT

1.

Disa vjet më parë, në një takim kombëtar të estradave, këngëtarët e njohur vlonjatë Meliha Doda, Kostandin Thana e Reshat Osmani, edhe pse nuk ishin të profilit të komedisë, patën një sukses të jashtëzakonshëm në çfaqjen “Këndojmë e mësojmë”. Ata dolën në skenë dhe kënduan disa gjëza popullore të muzikuara, të ndërtuara në formë kupleti, pyetjet e të cilave u drejtoheshin fëmijëve që mbushnin sallën plotpërplot. Reagimi i shikuesve të vegjël ishte i menjëhershëm dhe salla buçiste nga zërat e gëzuar të qindra fëmijëve, të cilët i jepnin përgjigjet në kor- në shumicën e rasteve të goditura, po ndonjëherë edhe duke i ngatërruar sendet, objektet e dukuritë dhe duke dhënë përgjigje tjetër për tjetër. Kjo shkaktonte një atmosferë edhe më të gëzuar, shpërthime të qeshurash që nuk përmbaheshin.

Me gjëzat e ndërtuara në formë pyetjeje e përgjigjeje u vendos një lidhje e ngushtë dhe e gjallë ndërmjet skenës dhe sallës si rrallë herë dhe këtë nuk e harrojnë as artistet vlonjatë që e ruajnë si një

nga kujtimet më të bukura të jetës së tyre artistike, e as shikuesit e vegjël që tashmë janë bërë burra e gra dhe punojnë në fronte të ndryshme të jetës.

Duke kujtuar këtë çfaqje të suksesëshme, të vjen keq kur mendon se forma të tilla aq komunikuese nuk përdoren nga estradat tona në premierat që përgatisin për fëmijët dhe veçanërisht nga teatrot tona të kukullave, që nuk janë pak po njëzetegjashtë.

E përmendëm këtë fakt për të treguar se gjëza është një lloj shumë i dashur e komunikues, të cilën të vegjëlit e pëlqejnë. Dhe kjo për disa arsye. Gjëzat janë mësimdhënëse, pasi u japin fëmijëve njohuri nga më të ndryshmet, të përmbajtjes apo të formës, për sendet, objektet dhe dukuritë e jetës e të botës që i rrethon.

Ato venë në lëvizje mendjen e të vegjëlve dhe u ndezin fantazinë pasi në bazë të disa të dhëna të tërthorta-shpesh herë krahasuese-duhet të gjejnë atë që kërkohet. Kjo do mprehtësi, gjykim dhe horizont të gjerë, njohje të çdo gjëje që na rrethon dhe veçanërisht vëzhgim të thellë.

Gjëzat zakonisht ndërtohen në formë pyetjeje e përgjigjeje, pra ato janë njëlloj dialogu që zhvillohet ndërmjet atij që pyet dhe atij që përgjigjet. Dihet se fëmijët, për shkak të moshës e të mungesës së përvojës, janë të prirë nga aksioni, veprimi e biseda dhe nuk i tërheqin shumë përshkrimet, sado të bukura qofshin (sa e sa përshkrime kemi kaluar pa i lexuar nëpër libra, për të mësuar si zhvillohen ngjarjet e si vijon fati i personazheve! A nuk na ka ngjarë të gjithëve kjo në fëmijëri?). Veprimin e aksionin i gjen në mënyrë të përkryer te gjëzat që ka krijuar populli.

Gjëagjëzat vërtet kanë dy gjer në katër vargje, por në to mendimi jepet i plotë, i saktë dhe i bukur, me varg të punuar e të rrjedhshëm, plot ritëm e dinamizëm. Rrobja artistike që u vishet dhe konçiziteti me të cilin krijohen, bëjnë që fëmijët t'i ndjekin me interesim të madh. Fëmijët e pëlqejnë rimën dhe ritmin e në praktikën e tyre të përditshme ndërtojnë edhe vetë strofa dy-tri e

katërvargëshe nganjëherë edhe pa kuptim fare si “*Se meraku/tiki-taku/ si zambaku*” apo “*Dyshe nga dyshe/ bukë pes’i edyshe*” etj.

Gjëzat kanë edhe vlera të mëdha edukative pasi me objektet, sendet e dukuritë e jetës e të natyrës për të cilat flitet në to, fëmijët janë në marrëdhënie për ditë e për orë dhe prej tyre mësojnë ç’është mirë e ç’është keq, ç’është e dobishme e ç’është e dëmshme, çfarë duhet të përqafojnë e çfarë të flakin tej. Të gjitha këto së bashku na flasin për rëndësinë e për domosdoshmërinë e krijimit të gjëzave sa më të bukura e sa më të gjetura.

2.

Gjëagjëzat apo, si i quan ndryshe populli, kashelashat (thjesht gjëzat), janë një lloj metafore që ndërtohet në formë pyetjeje, në mënyrë që të gjëndet objekti, sendi, dukuria ose çdo gjë tjetër për të cilën pyetet dhe që nuk thuhet troç por nënkuptohet nga disa të dhëna krahasuese e të tërthorta që jepen.

Gjëzat, ky lloj nga më të lashtët e letërsisë gojore, janë përdorur në shekuj jo vetëm si mjet argëtimi në raste festash, gëzimesh, mbledhjesh popullore, mbrëmjesh rreth vatrës në dimër etj. por edhe për të vënë në provë e në lëvizje dhe për të mprehur sgjuarsinë e të vegjëlve dhe të të rinjve. Por edhe të burrave e të pleqve. Ato kanë lindur si një nga mjetet më me efekt për të njohur jetën, natyrën dhe botën që rrethon njerëzit.

Gjëagjëzat, qysh në fillimet e veta, kanë patur për objekt njeriun, shpendët, bimët, natyrën e dukuritë e saj, mjetet e punës e të prodhimit dhe të jetesës së njeriut. Më të shumtat janë krijuar për punët e ndryshme të bujkut e të blegtorit dhe në përgjithësi për të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore. Veçanërisht zhvillim të mbarë kanë patur gjëzat për njeriun dhe për trupin e tij, për pjesët

përbërëse e veçanërisht për sytë, veshët, gojën, hundët, duart, këmbët etj. si “*Dy shigjeta pendëzeza/shkujnë atje ku t’i dërgosh*” ose “*Dy shkujnë/dy dëgjojnë*”. “*Ç’është një top me shtatë vrime*” etj. (respektivisht: sytë, sytë dhe veshët, koka e njeriut).

Në shekuj janë krijuar edhe shumë gjëza me karakter të theksuar shoqëror, për të goditur, ironizuar e tallur klasat në fuqi, për të damkosur padrejtësitë shoqërore, për të dhënë gjendjen e mjeruar të të varfërve por edhe revoltën e tyre, për të fshikulluar shërbyesit e fesë etj. Si “*Në një kallam të gjatë/ hyn e del një krimb i thatë*” ose “*Shtëllungë ka në mjekër/ dhe dreqin ka në bark*”. (Respektivisht: hoxha prifti.)

Shpesh gjëzat përshkohen nga nota lodruese e gazmore (“*kur i lidh ikin/kur i zgjidh rrinë*” - *këpucët*), nga humori i hollë e domethënës (“*Një zagare/në kamare*” - gjuha), nga mprehtësia në dhënie e asaj që është thelbësore si në formë edhe në përmbajtje (“*Një litar i gjatë, i gjatë/ që s’pushon as ditë, as natë*” - për formën e lumit dhe për vetinë e tij kryesore se ecën ditë e natë pa pushuar.)

Dhe të gjitha këto kërkesa që ka gjëza populli i hedh në dy, tre e rrallë në katër vargje, asnjëherë më shumë se kaq, duke ruajtur të fshehtë sa më mirë, por duke përshkruar të tilla të dhëna e cilësi që ta afrojnë objektin, sendin apo dukurinë për të cilën flitet. Në asnjë nga gjëzat që ka krijuar populli nuk zbulohet e fshehta e nuk thuhet troç gjërat. Trinomi mendim, e fshehtë dhe koncizitet plus art janë “tabu” në kuptimin e plotë të kësaj fjale, në gjëzat që krijon populli.

Në shumicën e gjëzave është gjithnjë e pranishme pyetja “*ç’është?*”, “*ç’na është?*”, “*ç’është njëzë e njëzë*” e ndonjë variant tjetër i tyre. Edhe kur kjo mungon, ndihet e kuptohet lehtë, pra nënkuptohet. Ndonjëherë - kjo ngjet shumë rrallë - gjëza e humbet formën pyetëse duke hequr pyetjen, e cila zakonisht thuhet në fillim por mund të thuhet edhe në fund.

I shtruar të gjitha këto veçori të gjëzës popullore për të dalë

te pyetja: sa e si materializohen në përmbledhjet me gjëza ose në tufat e gjëzave që botohen në libra më vete ose në organet letrare të fëmijëve si në “Yllkat”, “Fatosi” e “Skena e fëmijëve”.

3.

Një nga llojet që u lëvruan më shumë në vitet '50 e '60, që vazhdon të lëvrohet edhe sot dhe që shërben si për edukimin ashtu edhe për argëtimin e të vegjëlve është padyshim edhe botimi i shumë përmbledhjeve me gjëagjëza nga autorë të ndryshëm si Ferhat Çakërri, Vasil Koçi, Them Bello, Edmond Daliu, Bedri Rama, Muharrem Gazioni, Pirro Skëndo, Klementina Qesko etj. Libri i parë me gjëza, të krijuara nga autorët tanë, është botuar në vitin 1958 dhe mbante titullin “Mendo e përgjigju”.¹⁾

Më pas u botuan njëra pas tjetrës edhe shumë përmbledhje dhe ne sot numërojmë me dhjetra libra me gjëagjëza, të rreth njëzet e pesë autorëve. Në to gjen krijime me vlera, të ndërtuara mbi modelet e gjëzave që ka krijuar populli, ku ka edhe të fshehtë, edhe koncizitet edhe veshje të pëlqyeshme artistike, veçanërisht në përmbledhjet “Mendo pak se do ta gjesh”, “Me ca letër e me gërshërë”, “Kur t'i mbyll gjumi qepallat”, “Kush e gjen?”, “Kush e di emrin't'ia thotë”, “Gjëagjëza”, “Gjashtëdhjetë pikëpyetje” etj. Mirëpo jo të gjitha gjëzat që përfshihen në këto libra - në të tjerat jo se jo- janë krijime me vlera. Në mes tyre gjen shumë gjëza pa të fshehtë, të thëna troç, tepër të gjata e të zvarritura, gjëza që janë vargëzime të thata dhe me plot të meta e dobësi të tjera.

Këto të meta e dobësi, në vend që të shmangeshin në librat e rinj me gjëza që shkruajnë autorët dhe në ato që botohen në organet letrare të fëmijëve, me kalimin e vjetëve kanë ardhur duke u

1) O. GRILLO - “Mendo e përgjigju” (njëqind e një gjëza për fëmijë). Piktur Zef Bumçi, T.1958.Sh.B. “Naim Frashëri”. Me ilustrime.

thelluar. Ky është edhe shkaku që këta vjetët e fundit fëmijët kanë marrë në duar pak libra me gjëza.

Të metat e dobësitë janë të shumta e të ndryshme dhe ku më pak e ku më shumë i ndesh te të gjithë autorët, edhe tek ata që pak më lart u zunë në gojë për mirë. Arsyet janë të gjithduarshme por kryesorja mendojmë se është lehtësia me të cilën merret ky lloj nga autorët dhe nga mungesa e përkushtimit. Shumëkush e quan gjëzën të lehtë, diçka të vogël e që bëhet në çast. Vërtet gjëza është e vogël në dukje, - një distik apo një katrenë - po ka vlera të mëdha artistike, edukative, mësimore e njohëse të pazëvendësueshme.

Teorikisht të gjithë autorët i dinë këto kërkesa të veçanta që ka gjëza dhe rëndësinë e saj të madhe në edukimin dhe pajisjen me njohuri të të vegjëleve, në zhvillimin e fantazisë së tyre, por kur vjen puna për t'i shkruar e për t'i vlerësuar në praktikën letrare, ose kënaqen me pak ose i hedhin në letër shpejt e shpejt.

E meta kryesore e gjëzave që krijohen nga autorët tanë është se ata nuk kanë parasysh shembullin e shkëlqyer të gjëzave që ka krijuar gurra popullore në shekuj, e cila jep tiparet thelbësore të sendeve, dukurive, objekteve etj., (kryesisht të përmbajtjes por edhe të formës), gjithmonë në mënyrë të figurëshme se ndryshe nuk do të kishim gjëagjëzë, me shumë mprehtësi e zgjuarsis që të nxitë e të ndezë fantazinë dhe kureshtjen e fëmijëve, të verë mendjen në lëvizje dhe t'i japë të voglit njohuri që ndofta i di por jo nën këtë këndvështrim të ri, e aq më tepër kur u jep njohuri të reja, të panjohura për ta. Pikërisht këto tipare thelbësore u mungojnë shumë përmbledhjeve me gjëza dhe tufave me gjëagjëza që botojnë herë pas here "Fatosi", "Yllkat" dhe "Skena e fëmijëve". Kështu populli ka kapur një nga veçoritë kryesore të makinës, në përmbajtje e në formë, dhe thotë: "*Katër motra venë e vinë/ njëra tjetrën s'e arrijnë*". Autorët tanë kapen formalisht nga makina dhe krijojnë gjëza të tilla anemike "*Ajo nget e nget / të çon dhe në*

fshat/ edhe në qytet” ose “*Shkon e vjen / vjen e shkon. / kudo mallra, / njerëz çon*”. Si në gjëzën e parë ashtu edhe në të dytën janë kapur anë të jashtme e jo thelbësore të makinës, që të çon në fshat e në qytet ose që çon mallra e njerëz. Mirëpo në fshat e në qytet të çon edhe kali, karroca, biçikleta, treni etj. dhe po këto çojnë edhe mallra edhe njerëz, për të mos përmendur këtu edhe vaporin, aeroplanin etj. Pra në këto gjëza nuk jepet thelbësorja por diçka anësore, e sipërfaqshme. Kështu gjëza nuk i intrigon të vegjëlit, nuk i shtyn në objektet, sendet etj.

Në përgjithësi gjëzat që kanë krijuar e krijojnë autorët tanë venë në qendër objekte, dukuri, sende etj. të rëndomta e të konsumuara shumë herë. Kështu ata përsëritin, thonë e rithonë gjëra tepër të njohura e të dëgjuara nga fëmijët, pa sjellë asgjë të re origjinale, për aeroplanin, makinën, diellin, hënën, lumin, erën, yjtë, gojën, etj., etj. Gjëzat për këto objekte do t’i gjesh patjetër në çdo përmbledhje pothuajse pa ndryshim ose me ndonjë ndryshim të vogël. Të gjitha gjëzat për aeroplanin do të kenë patjetër shprehjet apo krahasimin “*porsi zogu fluturon*”, “*e çan diellin si shigjetë*” ose variante të tyre. Aq më keq ndodh kur krijojnë gjëza të dobta për sende e dukuri që populli ose autorë të tjerë kanë shkruar gjëza të bukura, të gjetura e me vlerë. Në këto raste s’kemi gjë tjetër veçse kopje të këqia të origjinaleve të mira. Kështu p.sh. në një gjëagjëzë për qymyrin populli me dy vargje ka thënë shumë qartë: “*I zi i ati, / i kuq i biri*”. Sikur të mos mjaftonin këto, një autor shton nga xhepi edhe dy vargje të tjera që s’kanë asnjë vlerë “*Në fund nga të dy / mbetet vetëm hiri*” dhe e bën me katër vargje gjëzën. Kështu ai prish bukurinë e gjëzës popullore, s’na thotë gjë të re dhe e zbulon të fshehtë vetëm me fjalën “hiri”, se hi bën druri, ose në rastin konkret qymyri (“I zi i ati...”)

Një zgjerim i spektrit tematik, duke krijuar gjëza për objekte, dukuri e sende të reja, veçanërisht nga jeta e sotme që është më e gjërë e më e larë, do të ishte me interes si për autorët, pasi mund

të sillnin prurje të reja në përmbajtje e në formë, ashtu edhe për lexuesit e vegjël, të cilët i mirëpresin, ta zemë gjëzat për helikopterin, që e shohin vazhdimisht në qiellin etj. Përsëritja, sado e bukur qoftë, për shpatë që tashmë ka dalë nga përdorimi por që e gjen shpesh nëpër përmbledhjet me gjëza nuk u sjell asnjë kënaqësi të vegjëlve.

Ndonjë përpjekje e autorëve tanë për zgjerimin e tematikës ka dalë pa sukses se është bërë në drejtime që s'të japin mundësi për t'i trajtuar në këtë lloj letrar, të vështirë e tepër konciz. Kështu vitet e fundit shumë autorë janë munduar të krijojnë gjëza për simbolet e shenjta si flamuri, ylli partizan, ose për dëshmorët e heronjtë e luftës e të punës. Për simbolet e shenjat mund të shkruhen vjersha të bukura e madhështore por jo gjëza, se duke i futur në kornizën e dy apo katër vargjeve nuk themi dot ato që duhen thënë. Aq më tepër se nuk i themi ashtu siç duhet e siç e meritojnë. Për heronjtë e luftës e të punës praktika ka treguar se gjëzat ngjasin shumë me njëra tjetrën si dy pika uji dhe fëmijët mund të ngatërrohen kur të duash e të përgjigjen tjetër për tjetër. Kështu gjëzës "*Kush si trim / ra në kufi / mori plumbin / mu në gji / dhe s'ju drodh / qerpik në sy*" mund t'i përgjigjesh me shumë emra dëshmorësh apo heronjsh që kanë mbrojtur kufijtë dhe kanë dhënë jetën për ta, dhe jo për atë që ka patur në mëndje autori.

Dihet se gjëza duhet të ketë një të fshehtë të veçantë, unike të papërsëritshme për objektet ose dukuritë e tjera që ta bëjë të mendojë fëmijën, por kërkon edhe saktësi të madhe që një objekt, send etj. të mos merret për një tjetër por t'i pëkasë vetëm atij, se ndryshe i ngatërrojmë të vegjëlit. Këto objekte e dukuri mund t'i ngatërrosh kur të duash kur nuk kanë të veçantën por të përbashkëtën. Kështu ngjet me shumë gjëza që janë krijuar për nënën dhe atdheun etj. Në të autorët thonë pak a shumë të njëjtat gjëra: "e dua më shumë se sytë". "Edhe jetën jap për të", "porsi ti tjetër nuk ka" etj.

Në një gjëagjzë autori thotë: “*Ti më do / e unë të dua / shumë e shtrenjtë / je për mua*” dhe në fund, në kllapa shënon “*nëna*”. Mirëpo kushdo mund të heqë emrin “*nëna*” dhe të thotë shoqja, motra etj. Në një tjetër thuhet: “*Edhe jetën / jap për ty / ti je dritë / në çdo sy / nëpër zemra / thellë rri*”. Dhe poshtë saj, po në kllapa, shënon “*nëna*”. *Kësaj gjëze mund t’i përgjigjesh edhe “atdheu”...*

Në shumë raste gjëzat që kanë krijuar autorët janë si dyer të hapura. Kështu fëmija s’ka nevojë për “çelës” dhe nuk e vret fare mendjen për të gjetur të fshehtën, se të fshehtë s’ka. Të tilla gjëza çdo gjë e thonë troç, nuk kanë enigmë, qoftë kjo edhe e thjeshtë fare. Në këtë mënyrë objekti, dukuria, sendi etj. zbulohen lehtë nga vetë autori, pasi disa nga veçoritë e tyre jepen pa fshehtësinë e nevojshme që e kërkon me deomos gjëza. Ky “vetëzbulim” i autorit mund të jepet edhe nëpërmjet një shprehjeje apo një fjale... Në shumë gjeza për trenin, ta zemë, do të gjesh shprehjet “*ecën mbi dy shina*”, *bën fi, fi, fi*; për tezgjahet “*end për mua, end për ty*”; për sobat se “*ngrohin zyra e shtëpi*”; për furrën se “*pjek byrek e kabuni*”; për librin e aritmetikës se “*ka mbledhje, zbritje*”. Vetë përdorimi i foljeve *ecën, end, bën, ngroh, pjek, e ka*, të pasuara nga togfjalëshat “*mbi dy shina*”, *zyra e shtëpi* etj. zbulojnë të fshehtat pasi mbi dy shina e fi, fi, fi bën vetëm treni, zyrat e shtëpitë i ngroh soba, byrekët i pjek furra e kështu me radhë.

Populli i ka ndërtuar gjëzat me mjeshtëri të rrallë dhe shkurt, shumë shkurt. Shumë autorë këtë dukuri të gjëzës popullore nuk e kanë fare parasysh dhe kashelashat e tyre i ndërtojnë me gjashtë, tetë e me dhjetë vargje, sikur të jenë vjersha. Disa herë shkojnë edhe në tej, i bëjnë me nga pesëmbëdhjetë e njëzet vargje dhe për t’u justifikuar para lexuesit të vogël në krye të tyre shënojnë “*gjëza-vjersha*”, duke harruar se këto nuk janë as gjëza e as vjersha po krijime pa asnjë vlerë. Shembuj të tillë gjen veçanërisht në organet letrare të fëmijëve, po të shkruara nga poetët jo nga të vegjlit: “*Nëpër fusha / në pranverë / gjelbëron / për bukuri / lulekuqet /*

midis tij / si flamurët / kuqezi. / Nëpër fusha / në qershor / ngjyrë floriri / merr dhe thotë / Bukë e re / jan unë për ju / do t'ju mbush / hambarët plot”, thuhet në një gjëzë të botuar në “Yllkat”. Siç shihet kjo gjëzë-vjershë nuk ka asnjë të fshehtë (vetë fjalët hambar, bukë etj, e zbulojnë të fshehtën). Po kjo nuk është aq kryesore sa lumi i vargjeve (gjithsej gjashtëmbëdhjetë ose sa katërfishi i gjëzave popullore). Edhe sikur t’i bashkojmë vargjet e thyer katërrokëshe në tetërrokësh do të na dilte prapë një gjëzë e gjatë me tetë vargje të thatë, të konsumuar e që zvarriten. Të tilla krijime nuk janë gjëagjëza po vjersha të dobta, pa forcë, pa gjetje, pa të fshehta, të ndërtuara në formë pyetëse. Pra formalisht përpiqen t’i ngjasin gjëzës...

Disa herë autorët krijojnë gjëza për objekte, dukuri etj. të cilat fëmijët nuk i njohin ende, pasi nuk i lejon mosha e përvoja e tyre, si për raportorin, vitin e brishtë, galaktikat etj. Nuk ka si të jetë i informuar e i përgatitur një gjashtë apo shtatëvjeçar, sado i zgjuar që të jetë. Ai këto do t’i mësojë kur të jetë në klasat e larta, prandaj gjëza të tilla s’ka pse të shkruhen e aq më tepër të botohen në përmbledhje apo revista. Duke qenë se gjëzat kryesisht u drejtohen fëmijëve të kopshteve dhe nxënësve të ciklit të ulët të shkollës tetëvjeçare (pavarësisht se lexohen e pëlqehen edhe nga pionierët e të rriturit) ato duhet të kenë në qendër objektet e dukuritë që i rrethojnë të vegjëlit, të jenë si një ushtrim i vogël, i cili e vë në provë e në lëvizje fëmijën. Gjëza s’ duhet të jetë as shumë e thjeshtë se kështu gjendet në çast e pa vështirësi, dhe as shumë e vështirë që të mos gjendet dot nga lexuesi apo dëgjuesi i vogël.

Kur krijojnë gjëza shumë autorë kujtojnë se mjafton të futësh të fshehtën në kornizën e disa vargjeve apo të një strofe dhe kështu gjithçka është në rregull. Kjo ka sjellë dyndjen e gjëzave të dobta, anemike e prozaike, pa ndërtimin e fizionominë që kërkon lloji, pa vargje të bukur e të rrjedhshëm, të çveshur nga çdo lloj detaji e gjetjeje, të mbushur me rima foljore, me vargje të çalë teknikisht

etj. Krijime të tilla si “*Është një ekspozitë në Tiranë / ku plot dritë e madhështi / para syve tanë / shpaloset nëna Shqipëri*” apo “*Ka lotë e djersë dhe gjak, / ndaj shpohet e gërmohet / lërohet e betonohet*” (për ekspozitën “Shqipëria sot” dhe për tokën) që i gjen rëndom nëpër përmbledhje ose në revistat letrare të fëmijëve, nuk janë gjëza por vargëzime pa asnjë vlerë që prishin shijet e lexuesve të vegjël. Në to mungon jo vetëm e fshehta e gjetja intriguese, por edhe arti i fjalës se janë pa bukuri dhe pa më të voglën forcë artistike.

Ndërtimi i gjëzës nuk është thjesht vargëzimi i mendimit, i të fshehtës dhe i veçorive të objektit, dukurisë apo sendit por edhe i gjuhës poetike, i mjeteve të saj shprehëse në mënyrë që ta bëjë sa më të afërt e sa më të dashur për lexuesin apo dëgjuesin e vogël.

Pa mohuar disa arritje që kemi në këtë lloj letrar që fëmijët e kanë aq për zemër, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se në gjëagjëzat ka dobësi e të meta të ndieshme, të cilat mund të kapërcehen me punë këmbëngulëse, me kërkim e përkushtim, me respekt më të madh për fëmijët në mënyrë që edhe kashelashat të ecin krahas llojeve e gjinive në të cilat kemi arritje më të mëdha.¹⁾

1) Të gjithë shembujt janë nxjerrë nga përmbledhjet që u cituam më lart por edhe të autorëve të tjerë si Y.Xhyheri, L.Gjirja, F.Lamaj, Xh.Zaganjori, K.Proganati, J.Doja, V.Çomo, Ç.Petriri etj. dhe revistat letrare të fëmijëve.

BASHKËBISEDIM ME LEXUESIT E LEXIKONIT...

Shumë vjet më parë rastësisht u ndodha në Fushë-Krujë, ku po organizohej një seminar me mësuesit e letërsisë të rrethit të Krujës. Aty do të zhvilloheshin disa veprimtari e, ndërmjet tyre, edhe mësim shembullorë për letërsinë, në ciklin e lartë të shkollës tetëvjeçare. Me që njihja disa mësues e kisha dhe disa miq që merrnin pjesë në seminar, më ftuan në këtë veprimtari dhe unë nuk ua prisha qejfin. Shkova e zura vend aty nga fundi i sallës, e cila ishte mbushur me mësues dhe me disa nxënës të klasës së gjashtë, të shkollës tetëvjeçare. Një mësuese e përgatitur për lëndën që jepte, dhe me pretendime (prandaj edhe e kishin caktuar të jepte një mësim shembullor), u kishte dhënë nxënësve si lexim jashtë klase (lekturë shkollorë) tregimin “Letra e vlefshme”, të shkrimtarit *Qamil Batalli*. Folën disa nxënës për vlerat ideoartistike, edukative, njohëse e argëtuese të tregimit, për temën, personazhet etj. Edhe ata ishin përgatitur mirë (pasi ishin nxënës të zgjedhur ndërmjet disa klasave të gjashta...) Në fund foli dhe mësuesja duke plotësuar e saktësuar disa gjëra që fëmijët nuk i kishin kapur. Mësimin shembullor e zhvilloi me zotësi, po kur një nxënës e pyeti se cili ishte shkrimtari që e kishte shkruar, ku banonte e ku punonte,

ç'punë bënte e ç'vepra kishte krijuar, mësuesja ngeci. Tha vetëm se duhej të ishte nga Elbasani apo nga Vlora, pasi aty kishte marrë vesh se jetonin disa familje me mbiemrin Batalli... Kaq dinte mësuesja, e cila nuk kishte asnjë faj, pasi për autorin nuk kishte gjetur dot asnjë të dhënë. Meqë puna më kishte lidhur me shkrimtarët nga Kosova, kërkova leje dhe u tregova gjithçka dija për shkrimtarin Qamil Batalli... Mbetën të kënaqur dhe më falenderuan. Veç kësaj kërkuan që në librat të cilët botoheshin për fëmijët, për të lehtësuar punën e mësuesit, të jepeshin dhe të dhëna për jetën e veprën e autorit. Mirëpo propozimi im mbeti në sirtarët e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", ku punoja, pasi, te ne, nuk ndiqej një praktikë e tillë.

Lidhur me jetën e veprën e shkrimtarëve (aq më shumë të shkrimtarëve që shkruanin për fëmijët dhe krijimet e tyre përfshiheshin në leximet letrare apo në lekturën shkollore) pak më vonë mësova edhe një anekdotë, të cilën ma tregoi shkrimtari Luan Qafëzezi. (I ndritë shpirti aty ku prehet, se ka qenë njeri i mirë e shkrimtar i përkushtuar.) I ndjeri Luan kishte marrë pjesë, në një fshat të Beratit, në një mësim shembullor në letërsi dhe për koincidençë mësuesja do të fliste për një vjershë të këtij poeti. Pasi mbaroi mësimi shembullor, një nxënës e pyeti mësuesen, e cila, edhe pse e kishte brenda në klasë autorin, nuk e njihte, pasi nuk ia prezantuan; për vendin nga ishte poeti, për veprat që kishte shkruar etj. Mësuesja, duke u nisur nga mbiemri i Luanit, u tha nxënësve se autori kishte shumë kohë që kishte vdekur dhe duhet të ishte bashkëkohës i ...Hasan Zyko Kamberit. Luani, që nga natyra ishte shakaxhi, u ngrit në këmbë dhe tha:

- Nuk kam vdekur ende. Ja ku jam i gjallë dhe jam bashkëkohës juaji, jo i Hasan Zyko Kamberit!

Të gjithë qeshën e më tepër nga të tërë vetë autori...

Më pas, duke ndjekur rregullisht gazetën "Drita" e revistën "Nëntori", të cilat i kam koleksion qysh nga numri i parë gjer më

sot, në vitet 80', kur në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve kishte dhe një sektor të letërsisë për fëmijë që drejtohej zonja Shpresa Vreto, filluan të jepen të dhëna të gabuara veçanërisht për shkrimtarët për fëmijë (po edhe për të rriturit) që bënë muuu... Kështu shkrimtari Ll, që nuk ka botuar asgjë për fëmijët, por një poemë e tij është futur në leximet letrare të shkollave tetëvjeçare, delte se ishte një nga krijuesit më prodhimtarë e më të talentuar në letërsinë për fëmijë: prozatori A.B., që nuk kishte shkruar asnjë varg në jetën e vet, lavdërohej se kishte shkruar poema të shkëlqyera (në rininë e vet mbase ka shkruar ndonjë varg, po ai ka botuar vetëm proza dhe është i suksesëshëm); shkrimtarit H.M. nga Vlora, i visheshin gjithë veprat që ka shkruar një shkrimtar tjetër nga Kruja, i cili i ka inicialet po H.M. (njëri quhet Hiqmet e tjetri Hamdi dhe i kanë mbiemrat shumë të afërt: i pari Meçaj dhe i dyti Meça)... E kështu me radhë.

Duke mbledhur gjithë këto xhevahire e shumë të tjera ndofta më befasese, atëherë bëra një shkrim me titull *"101 gabimet dhe fajet e "Dibrës" e të "Nëntorit" për letërsinë për fëmijë"*, të cilin nuk ma botuan dhe e ruaj në arkivin tim si dorëshkrim.

Të tilla pasaktësi, të meta, gabime e madje edhe fajet, në ato vite, gjeje edhe në "Katalogun e librave" që botonte N.Sh. e Tregimit të Librit në Tiranë, në bibliografitë që botonte Biblioteka Kombëtare po në Tiranë dhe në botime, gazeta, revista etj., edhe në gazetën "Libri" madje. Aq më tepër këto gjendeshin në shkrimet, shënimet etj., që jepeshin për letërsinë për fëmijë.

Po në vitet '80 gazeta "Drita" botonte numër për numër një rubrikë bibliografike për shkrimtarët e artistët, po ku patën fatin të përfshihen vetëm katër-pesë shkrimtarë për fëmijë. Ndërkohë më ra në dorë "Fjalori" i Robert Elsie dhe u habita kur pashë se në të mungonin të gjithë shkrimtarët që kanë shkruar për fëmijët, ashtu siç mungonin edhe shumë shkrimtarë të tjerë që krijonin për të rriturit, pasi i kishte përfshirë "lufta e klasave"...

Pak kohë më vonë, më ra në dorë “Pasqyrë e letërsisë shqipe 1500-1986”, i shkrimtarit e studjuesit grek Llambro Mallamas. Edhe këtu ishin përfshirë apo jo rreth dhjetë shkrimtarë që shkruanin për fëmijët ndërsa autorë në zë si Guranjaku, Gjyli, Zaloshnja, Beqaraj etj, “ishin harruar”. Por ndërkohë gjeje shkrimtarë të tjerë që nuk u vinin as te këmbët poetit Beqaraj me shokë. Madje këta shkrimtarë minorë, që në anketat e lexuesve renditeshin nga fundi i listës, zinin vend të gjerë, kur shkrimtarë të tjerë të talentuar kishin katër-pesë rreshta. Kështu dikush, meqë punonte në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve, jepej me 24 rreshta ndërsa Asdreni i shquar apo Kuteli i madh jepeshin me më pak rreshta... Kështu vihej në jetë ajo që ka thënë një kritik: *“Shkrimtarët në Shqipëri nderohen e çmohen sipas karriges që zënë e jo sipas zotësisë dhe veprave që kanë shkruar”*.

Së fundi në vitet ‘90 më ra në dorë “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë”, i shkrimtarit e studiuesit Hasan Hasani nga Kosova. Ky fjalor është një hap i madh përpara në krahasim me fjalorët e tjerë: është më përfshirës, më i saktë, me të dhëna më të plota e me hollësi më të mëdha. Megjithatë, edhe “Leksikoni” i Hasan Hasanit nuk u ka shpëtuar të metave e dobësive, të cilat, në shumicën e tyre rrjedhin nga informacioni që ka marrë autori nga bibliografite, gazetat, revistat etj, por edhe nga keqdashja e ndonjë “konsulenteje”, që nuk mban mend as titujt e dy-tre veprave të veta që ka botuar, jo më të të tjerëve. Aq më tepër se në të ka edhe fyerje... Kështu për shkrimtarë të njohur, si M. Apo G., thuhet se *“njihen si krijues për fëmijët”* (vini re me kujdes: është vënë si përcaktuese krahasorja *si*, që është tepër denigruese) ndërsa për veten e vet “konsulentja” shkruan më gjatë, më me hollësi, me vlerësime të pamerituara dhe e quan veten *shkrimtarë*, jo *“si krijuese”*... “Konsulentë” të tillë nisen nga parimi *“Kam inat talentin tënd, jo ty.”*

Me zotin Hasan Hasani, kohë më parë, u takuam në Tiranë

dhe, si vëllezër që jemi, biseduam për orë të tëra të “Vjeshta” e në shtëpinë tonë, për Leksikonin e tij. Pas këtij konsultimi, në ribotimin e tretë që do t’i bëjë fjalorit, me siguri do të jenë rregulluar shumë nga dobësitë e të metat, veçanërisht për letërsinë për fëmijë e për librat që janë botuar për lexuesit e vegjël në dheun amë, siç thonë në Kosovë.

Të tre fjalorët kanë shumë të meta, dobësi, pasaktësi, gabime e madje edhe fajë. Se faj është kur ve dhjetra emra njerëzish që s’kanë botuar libra dhe i quan shkrimtarë. Kështu, duke i atribuar një libër të poetit Llazar Siliqi, na del shkrimtar dhe artist i merituar. Lazër Filipi; me vepra të të jatit, zotit Vangjel Kule, na del shkrimtar dhe i biri, Virgjil Kule, që nuk ka botuar kurrë vepra letrare; me tekstet e këngëve të festivaleve për fëmijë shpallet poet edhe Sh.K. (pastë ndjesë e pushoftë i qetë aty ku prehet), i cili nuk ka botuar ndonjë libër as për të rriturit e as për fëmijët. Po kështu shpallen shkrimtarë disa ish drejtues të formacioneve partizane apo të pasçlirimit të cilët kanë botuar libra me kujtime, që s’kanë të bëjnë fare me letërsinë po mund të kenë vlera dokumentare e historike. Ja një fragment kujtimesh të një gjenerali: *“Jemi në malet e Labërisë dhe sot, datë 23 prill 1943, bëmë mbledhjen e shtabit ku u analizuan, sipas rendit të ditës, këto çështje: 1. Situata ndërkombëtare, 2. Situata në Frontin e Lindjes, 3. Situata në Frontin e Perëndimit, 4. Situata e brendëshme... U pranuan në radhët partizane filani e filani...”* etj. Të tillë ditare s’janë letrare dhe s’kanë të bëjnë fare me krijimtarinë artistike. Dhe e fundit, për ta sjellë si shembull, se ka shumë e shumë të tjerë: shkrimtarit Andrea Varfi (i ndritë shpirti aty ku prehet se ishte edhe ky njeri i mritë e shkrimtar i përkushtuar) i vishen si vepra të shkruara prej tij *“Estrada e ushtarit”*, *“Estrada e pionierit”* etj., kur dihet se këto kanë qenë buletine të shaptilografuara, në ndihmë të grupeve të estradave amatore të ushtarëve e të fëmijëve. (Është për të qarë e për të qeshur, apo jo?)

Në fillim të viteve '80, një shkrimtar i shquar në Shqipëri u ngarkua të studjonte leximet letrare të shkollave tetëvjeçare dhe më pas botoi në gazetën "Zëri i Popullit" një shkrim të gjatë, ku ndërmjet të tjerave bënte shumë vërejtje e sugjerime me vend për këto tekste, pr tematikën, vlerat artistike, edukative, nivelin etj., por bënte edhe gabime të pafalëshme. Një prej tyre ishte se në tekstet kishte ndeshur emrat e Rexhep Hoxhës, Rifat Kukajt, Qamil Batallit, Agim Deves, Gani Xhafollit etj., të cilët sapo ishin futur në leximet tona letrare dhe, duke mos i njohur, thoshte: "*Ç'janë këta emra të panjohur që futen nëpër leximet letrare të nxënësve, të cilët duhet të njihen me autorët më të mirë në letërsinë tonë për fëmijët e për të rriturit?*"

Më pas, në një shkrim tjetër, për t'u bërë bisht kritikave, ky autor shkroi se gjoja i ishin ankuar vetë shkrimtarët nga Kosova etj., pasi u ishin futur krijime të dobëta në leximet letrare, duke harruar se ai kishte qenë disa vjet më parë në Kosovë, ndërsa leximet ishin botuar atë vit që shkrimtari shkroi artikullin e vet, pra, tre vjet më vonë...

Të gjitha këto tregojnë se letërsia për fëmijë nuk njihej dhe e keqja kryesore është se vlerësimin e bënin ata që nuk kishin lexuar asgjë nga kjo letërsi. Këtë e tregon edhe vetë fakti se letërsinë për fëmijë, si në Lidhje ashtu edhe në Shtëpinë Botuese, e drejtonin njerëz të paaftë (me ndonjë përjashtim) dhe ç'është më e keqja, ishin keqdashës, si p.sh. puthakëmbësi F.K., që i sollën shumë dëme letërsisë për fëmijë dhe shkrimtarëve që shkruanin për lexuesit e vegjël, dëme që po i ndejmë edhe sot...

Pasi lexova të tre fjalorët më erdhi shumë mirë që letërsia jonë në përgjithësi, e në këtë kuadër edhe letërsia për fëmijë, ku më shumë e ku më pak ishte bërë e njohur në Evropë, nga Elsieja e Mallamasi dhe në trevat shqiptarë nga Hasan Hasani e ndonjë tjetër. Kjo është një arritje që tregon se ne kemi letërsi të mirë, pavarësisht nga të metat e dobësitë e rritjes e të sistemit që kaluam.

Këto pohime mund t'i bëjmë me gojën plot edhe për letërsinë për fëmijë.

Po pata edhe një pezmatim: si është e mundur që në Shqipëri nuk u kujtua askush të hartonte një fjalor për letërsinë, në një kohë që janë botuar dhjetra e dhjetra fjalorë për fusha të tjera shumë më pak më të rëndësishme? Kjo është e pafalëshme... Edhe ky fakt është një shtytje e madhe që më bëri t'i futem një fjalori të shkrimtarëve shqiptarë për fëmijët, për të cilin kam derdhur shumë mund, punë e djersë, edhe për arsye se është jashtë fushës e veprimtarisë sime modeste, në letërsinë për fëmijë.

Për të arritur këtu, në dhjetëvjeçarët e kaluar nisa të botoj serinë e biobibliografive të shkurtra për jetën e veprën e shkrimtarëve në revistën "Pionieri" (nën okielon "Shkrimtarët, jeta dhe vepra"). Më pas në "Rilindja për fëmijë" versioni i Tiranës, hapa rubrikën "Vitrina e librit të ri", që vazhdoi rreth dy vjet. Më pas akoma këtë rubrikë e kam mbajtur po dy vjet në emisionet për fëmijë të Radio Tiranës. Së fundi, për dy vjet të tjera, po në "Rilindja për fëmijë", botova rubrikën "Të njohim shkrimtarët tanë për fëmijë" e së fundi, ka më shumë se një vit që, po në këtë gazetë, mbaj rubrikën "Nga fondi i artë i poezisë shqipe për fëmijë". Në të gjitha këto shkrime ka të dhëna biobibliografike për jetën e veprën e autorëve që kanë shkruar për lexuesit e vegjël. Këto më ndihmuan shumë në hartimin e fjalorit.

I nisur nga të gjitha këto që parashtrova më lart, qysh kur dëgjova mësimin shembullor në Fushë-Krujë e gjer në fund të vitit 1995, kur më ra në dorë leksikoni i shkrimtarit Hasan Hasani, iu vura punës dhe u përpoqa të mbledh të dhëna për jetën e veprën e shkrimtarëve që kanë krijuar për fëmijët, me mendimin që të botoj një Leksikon ku të përfshihen që nga Babai i gjuhës shqipe Kristoforidhi, gjer te 11-vjeçarët Edlira Rama, Zyhra Farizi, Arian Krasniqi etj, që kanë botuar librat e tyre të parë.

Leksikoni përmbledh mbi pesëqind shkrimtarë, që nga viti

1872 gjer në fund të vitit 1995. Viti 1972 është marrë si fillim i letërsisë sonë për fëmijë, pasi në këtë vit Kristoforidhi ka botuar “Abetaren e vet (apo “Alfavitarin”) ku janë botuar vjersha “Ylli i vogël lart në qiell” (përshtatje nga poeti Stivensone jo nga Arçibald Kronini, siç shkruan zoti Rexhep Qosja, pasi Kronini ka lindur më 1896, pra 24 vjet më pas nga viti kur u botua “Abetarja” e Kristoforidhit) dhe nja dy fabula.

Leksikoni që kam përgatitur është *informativ* dhe jo *vlerësues*. Në të jepen të dhëna nga jeta e vepra e autorëve: kur kanë lindur (viti), ku kanë lindur, çfarë shkollash kanë kryer dhe ku: çfarë punësh dhe profesioneesh kanë patur dhe ku i kanë ushtruar dhe ku jetojnë. Në fund janë dhënë veprat që kanë krijuar: 1. Në rast se janë autorë që kanë shkruar për të rriturit, por kanë dhënë ndihmesë edhe në letërsinë për fëmijë, në fillim përmenden disa nga librat e tyre më të mirë që u drejtohen të rriturve, e më pastaj jepen librat që kanë botuar për lexuesit e vegjël. 2. Autorëve që kanë krijuar vetëm për fëmijët, u janë shënuar të gjitha veprat kronologjikisht. Ndonjë vlerësim është bërë vetëm për shkrimtarët që nuk jetojnë më, por që kanë lënë emër nga pas, ndërsa për ata që janë gjallë nuk është bërë asnjë vlerësim.

Kriteri bazë për ta futur në leksikon autorin është ky: të ketë botuar të paktën një libër. Përfshihen këtu edhe autorët që nuk kanë shkruar për fëmijët, por që pjesë nga vepra e tyre kanë hyrë në leximet e fëmijëve (në leximet letrare apo në leximet jashtëshkollore - lektura shkollore). Të tilla janë De Rada, Naimi, Asdreni etj.

Në leksikon përfshihen shkrimtarët që kanë lindur e kanë krijuar brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe shkrimtarët e Kosovës, shkrimtarët shqiptarë të ish Maqedonisë e të Malit të Zi, që jetojnë në trojet e veta, dhe nga diaspora.

Leksikoni paraqet rreth 530 autorë, të cilët kanë botuar në harkun e 123 vjetëve (1872-1995). Ky numër, për një vend si yni

e me popullsi të vogël, është befasues. Kjo tregon se populli ynë është i talentuar dhe ka nxjerrë nga gjiri i vet shumë shkrimtarë. Natyrisht midis tyre ka shumë të talentuar, mesatarë e, duhet ta pranojmë, edhe të dobët. Veçanërisht në këta pesëdhjetë vjetët e fundit në letërsinë tonë në përgjithësi e në veçanti në letërsinë për fëmijë kanë hyrë edhe krijues të cilët, nëpërmjet librave që mundoheshin të botonin, përpiqeshin jo vetëm për të bërë emër, por edhe për të siguruar ndonjë punë të mirë, ndonjë transmetim pranë familjes ose për t'u vendosur në qytet etj. Pavarësisht nga këto, të gjithë, kush më pak e kush më shumë, me librat e tyre kanë begatuar e lulëzuar letërsinë për fëmijë, kanë edukuar breza të tërë dhe i kanë shërbyer vendit e popullit të tyre. Për vlerat e krijimeve që kanë lënë pas do të flasë koha dhe njerëzit, të cilët janë gjykatësit më të mirë. Le t'ua lëmë atyre vlerësimet...

Në leksikon janë dhënë edhe njohuri për llojin e gjininë e krijimit, për vitin e botimit etj., po në disa raste këto mungojnë pasi nuk kam patur mundësi të siguroj informacionin e duhur...

Në këto pak fjalë që vlejné si hyrje në leksikon, dua të falenderoj në radhë të parë zotërinjtë Elsie, Mallamas, Deva, Jorgaqi, Kastrati, zonjat Tabaku, Kosturi, Greva dhe të gjithë ata që më ndihmuan për të hartuar këtë vepër, e në veçanti zotin Hasan Hasani, i cili më ka dhënë një ndihmesë të veçantë jo vetëm me Leksikonin e tij por edhe me shënimet që më ka çuar për shkrimtarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanovc.

Bashkë me ta dua të falenderoj edhe të gjithë ata autorë që iu përgjigjen letrave të mia (m'u desh të çoj mbi 250 letra anembanë vendit) dhe më dërguan të dhëna për jetën dhe veprën e tyre, fotografi etj. Por nuk mund të rri pa shënuar edhe pakënaqësinë time për shumë autorë të tjerë që nuk m'u përgjigjen, a thua se në fjalor nuk do të flitej për ta po për njerëz të tjerë... Ka të tillë autorë që u kam shkruar disa herë, apo i kam takuar dhjetra herë, të cilët nuk më kanë ndihmuar në pasqyrimin e jetës e të veprës së

tyre... Megjithatë, i uroj të bëhen lexues të leksikonit.

Duke i mbyllur këto shënime dua t'ju them se leksikoni që po merrni në duar ka një informacion më të gjerë e më të plotë se të gjithë fjalorët e tjerë që janë botuar gjer më sot, për shkrimtarët shqiptarë që kanë shkruar për fëmijët. Po jam i sigurtë se në të do të ketë edhe mangësi, të meta, dobësi e pasaktësi, për ata autorë të cilët nuk m'u përgjigjën dhe sidomos për shkrimtarët që jetojnë e punojnë në trojet e veta në Kosovë, për shkrimtarët shqiptarë të ish Maqedonisë e të Malit të Zi dhe të diasporës, për të cilët e kam patur tepër të vështirë të gjej material, veçanërisht për botimet e tyre në vitet 1990-1995.

U kërkoj falje të gjithëve për mungesat, të metat e dobësitë dhe u lutem autorëve të më shkruajnë në adresën e mëposhtme, për vërejtjet që kanë, të cilat do t'i pres me shumë dashamirëri e mirënjohje dhe do t'i ve në jetë ndonjëherë kur ta ribotoj leksikonin.

DUKURI TË REJA NË LETËRSINË TONË PËR FËMIJË

Pas një “pauze” të përkohëshme që solli shkatërrimi i sistemit të vjetër dhe vendosja e sistemit të ri demokratik, për rreth dy vjet nuk dolën as revista, as gazeta e as libra për fëmijët. Aty nga viti 1992-1993 nisën të dalin gazetatat e revistat e para e njëkohësisht nisën të dalin edhe organe të tjera, të reja, dhe ne tani numërojmë rreth njëzet të përkohëshme, të cilat ose dalin rregullisht ose me ndërprerje, thjesht për arsye ekonomike. Kështu dalin në Tiranë, por edhe në rrethe; “Mrekullia”, “Yjet”, “Tik-tak”, “Kacamisri”, “Sirena e vogël” (gazetë e revistë kjo e fundit), “Fllad”, “Borëbardha”, “Rilindja për fëmijët”, “Bilbilat” (që këndon si sorrë, se nuk duhen vetëm para për të botuar revistë për fëmijë, por talente e përkushtim...), “Gjysmagjeli” etj. Madje kanë nisur të botohen edhe revista nga vetë fëmijët, të drejtuar nga mësuesit. Kështu vetëm shkolla tetëvjeçare “N. Frashëri” në Tiranë boton “Cicërimat” dhe një revistë tjetër. Dolën me hope edhe revistat “Yllkat” (sot “Vogëlushët”), “Fatosi”, “Pionieri” (sot “Filizat”) dhe “Horizonti”. Mirëpo me kalimin e viteve të katër këto botime u mbyllën (më jetëgjata ishte “Filizat”), për arsye se nuk u mbuluan nga shteti. Ne që i ngritëm dhe i mbajtëm mbi shpatulla për disa

dhjetëvjeçarë na dhembti në zemër mbyllja e tyre. Por ngushëllohem se dolën dhe po dalin botime të reja. Dëshirojmë, shpresojmë e urojmë që këto gazeta e revista të mbijetojnë e të shtohen, për gëzimin e fëmijëve, prindërve, mësuesve, edukatoreve, të gjithë lexuesve. Tani të gjitha këto botime janë private, të shoqatave, fondacioneve dhe të personave të ndryshëm. Shumica e botimeve janë me ngjyra.

Në këto tre vjetët e fundit vërshuan edhe shtëpitë botuese private dhe përpiqet të mbijetojë “N.Frashëri”, e vetmja që është shtetërore dhe që boton dy-tre libra në vit për fëmijët, të shkruara nga punonjësit e saj...Gjer më sot janë ngritur rreth njëqind e pesëdhjetë shtëpi të tilla botuese (shifra ndofta nuk është e saktë, pasi ka edhe shtëpi botuese pirate). Këtu vendi ynë zë vendin e parë në botë ndofta, në krahasim me popullsinë që ka (!). Natyrisht jo të gjithë botojnë letërsi për fëmijët. Rreth njëzet prej tyre botojnë për të vegjëlit, kush më shumë e kush më pak. Vendin e nderit e zë “TOENA” e zotit Fatmir Toçi, i cili në vitin 1966 botoi rreth dyzet libra për fëmijët. Kjo është një arritje e madhe, pasi “Naim Frashëri” vitet e fundit mezi botonte 10-15 libra në vit edhe pse në redaksi punonin tetë veta. Pastaj vijnë me radhë Sh.botuese “MÇM-Çabej”, “Onufri”, “Rozafa”, “Ditura”, “Glob R”, “Ardita”, “Hipokrati”, “Feniks”, “Albin” etj. Nga viti në vit po shtohen botimet dhe n.q.s më 1993 u botuan njëzet-tridhjetë tituj, më 1966 numri i botimeve arriti në 120. Një pjesë e tyre janë botime të shtëpive botuese pirate, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Për t’u bindur për këtë mjafton të shkosh në një librari, se me siguri do të gjesh dhjetë-pesëmbëdhjetë tituj të tillë, pa shënuar shtëpinë botuese që i boton, pa autor, pa përkthyes, pa piktor... Një pjesë që vijnë nga jashtë, grafikisht janë shumë më të bukura dhe kështu zenë vendin e parë në shitje, se një fjalë e urtë shkodrane i thotë: “*Vesha-kopilesha*”.

Pavarësisht nga këto çrregullime që i solli koha, tani botohen shumë libra me figura, ilustruar bukur, për lexuesit e vegjël, por

edhe disa të dobët shumë si nga ana artistike ashtu edhe grafikisht. Ka libra për të gjitha moshat dhe kultivohen të gjitha gjinitë e llojet letrare. Ka shumë libra të përkthyer, por ka edhe një vërshim të librave origjinalë, kryesisht të autorëve që për disa dhjetëvjeçarë kanë krijuar për fëmijët e rrallë nga ndonjë i ri. Në mes tyre ka vepra me vlerë, si nga autorët e huaj, si nga autorët tanë, por ka edhe libra të dobët e me pak vlera. Ndërkohë shiten edhe disa libra që vijnë nga shtëpitë botuese në Prishtinë e Shkup. Grafikisht këta libra janë më të arrirë, por shpesh kanë dobësi artistike.

Tani, për botimin e librave ka vetëm një kërkesë: të kenë vlera artistike të dukshme. Kjo është një arritje e madhe, ndryshe nga ç'ndodhte në të kaluarën kur kishte kërkesa ideologjike e politike. Tanimë nuk ka pengesa për tematikën, për raportet pozitive e negative e për shumë kërkesa të tjera absurde që shtroheshin para autorëve në të kaluarën. Po kështu nuk vepron lufta e klasave dhe nuk shikohet biografia e autorëve, që dikur u mbyllte derën shumë krijuesve.

Është e vërtetë se gjer tani kanë botuar e botojnë shumë autorë, por ndërkohë nuk kanë botuar e nuk po botojnë disa të tjerë që kanë patur emër në të kaluarën, si Xh. Beqaraj, A. Mamaqi, N. Prifti, I. Reso, P. Zoto, R. Pasmaçiu e plot të tjerë. Këta jo se nuk kanë krijuar por nuk i kanë mundësitë financiare, me ndonjë përjashtim.

“Toena” por edhe “Rozafa”, “Dituria” e ndonjë tjetër kanë botuar libra me shpenzimet e veta, por kjo nuk është e vetmja rrugë e zgjidhjes. Këtu një ndihmesë të madhe mund të jepnin firma, fondacione, shoqata etj., duke i sponsorizuar botimet për fëmijë. Po kështu mund të mdihmonte edhe Ministria e Kulturës, Rinisë e Gruas. Mirëpo, për fat të keq shumë pak sponsorizime janë bërë, për të mos thënë fare. Dhe të vjen keq, kur mëson se ka një udhëzim të Qeverisë, që të sponsorizohen librat për fëmijë nga shteti, mirëpo gjer më sot Ministria pothuajse nuk ka sponsorizuar

asnjë. Po kështu edhe firmat, fondacionet, shoqatat etj. Kështu arrijmë në përfundimin se disa autorë që kanë pare, po nuk kanë talent, mund të botojnë sa të duan, ndërsa ata që kanë talent, por nuk kanë pare nuk mund të botojnë... Ky është një paradoks i kohës që me dëshirën e mirë mund të kapërcehet. Ndryshe shumë autorë të talentuar do të vazhdojnë të heshtin dhe shumë të patalentuar do të prishin shijet e lexuesve me vepra të dobta!

Është e drejta e gjithkujt të botojë libra e t'i shesë ku të dojë, në librari, në tezga, në shkolla etj. Por ama nëpër shkollat tona duhet të futen librat më të mirë, e jo porkeri. Për këtë rol kryesor duhet të luajnë mësuesit e letërsisë dhe drejtuesit e shkollave. Se jo rrallë ndodh që fëmijëve u janë shitur libra mediokër, ose më mirë ta themi: u është shitur sapuni për djathë... Dhe kjo ndodh pasi ndonjë mësues niset thjesht nga interesi personal, se duke shitur libra diçka përfiton. Mbase mësuesit kanë edhe vështirësi financiare, por ama nuk duhet t'ia shesin shpirtin shejtanit për pesë grosh dhe të çekudojnë fëmijët. Një nismë të vlefshme mori Instituti i Studimeve Pedagogjike vitin e kaluar, duke rekomanduar librat më të mirë për leximet jashtë klase, mirëpo më tej nuk u shkua dhe puna u la në mes. Nga kjo përfitojnë veçanërisht të patalentuarit e trafikantët...

Këto vitet e fundit ka çaluar shumë edhe puna për propagandimin e librit në RTV, në gazeta e revista etj. Është munduar Shoqata Mbarëshqiptare e Shkrimtarëve për fëmijë e të rinj të bëjë prezantime librash anembanë vendit, por kjo nuk mjafton. Po kështu kjo Shoqatë ka mbajtur një rubrikë, "Vetrina e librit" te "Rilindja për fëmijët", po edhe kjo është shumë pak. RTV-ja dhe gazetatat e revistat që dalin duhet të bëjnë më shumë për propagandimin e librit. Po kështu edhe institucionet e ndryshme dhe Instituti i Studimeve Pedagogjike duhet ta rinisë këtë punë më me përkushtim.

Prej disa vitesh kanë rënë boritë e alarmit se në letërsinë për

fëmijë nuk po hyjnë forca të reja letrare. Kjo është një fatkeqësi kombëtare, se letërsia nuk mbahet me ndonjë vepër që krijojnë autorët që shkruajnë për të rriturit-njëherë në njëqind vjet, por nga ata që i janë përkushtuar kësaj letërsie. Teza e ndonjërit apo ndonjëres e hedhur në një simpozium disa vjet më parë se “S’ka ç’na duhen shkrimtarët për fëmijë, pasi veprat mund t’i shkruajnë shkrimtarët që krijojnë për të rriturit” është një lajthitje e një gafë prej çiliminjsh, e jo prej njeriu me mend në kokë. Mirëpo kjo teze zuri vend dhe tani ne pothuajse nuk kemi asnjë shkrimtar për fëmijë nën moshën dyzet vjeç. Pra, kemi një boshllëk prej njëzet vjetësh. Si do të mbushet ky boshllëk, kur dihet se kudo në bootë shkrimtarët për fëmijë e ushqejnë lexuesin e vogël? Si shembull mund të marrim Italinë fqinje. Atje letërsinë për fëmijë e kanë mbajtur dhe e mbajnë Kolodi, Arzhili, Maçioki, Orvjeto, Rodari, Naneti etj. Kësaj i thonë: “Hedh një budalla një gur në det e pastaj nuk e nxjerrin dot as një mijë të ditur!”

Megjithatë këto vitet e fundit kemi filluar të shpresojmë se do të hyjnë forca të reja, tashmë jo njëzetvjeçarë por dhjetë-pesëmbëdhjetëvjeçarë edhe në letërsinë për fëmijë. Në të gjitha trojet shqiptare këto vite (1995-1996) kanë botuar libra shumë autorë të rinj që janë vetë fëmijë. Se sot gjithçka ecën me ritëm tjetër, ndryshe nga dje, edhe në këtë fushë po ndihet përshpejtimi mendor, veç atij fizik etj. Dhe ka prej tyre që krijojnë për fëmijët. Madje ndonjë, si Zyhra Farizi në Tetovë, ka botuar katër libra, në dy vjet, dy në prozë e dy në poezi. Dhe emra fëmijësh të tjerë po bëhen të dëgjuar, si: Edlira Rama, Lira Lasku, Arian Krasniqi, Adriana Iseni, Zanita Halimi etj. Le të shpresojmë se këta do ta çojnë letërsinë tonë për fëmijë më përpara në të ardhmen.

Është detyrë e të gjithëve, po veçanërisht e shkrimtarëve që krijojnë për lexuesit e vegjël dhe e gjithë të tjerëve që t’i përkrahin e ndihmojnë mësuesit e letërsisë që punojnë me shpirt dhe jo ata që bëjnë punën e arsimtarit, të cilët - siç thoshte Dr. Prof.

Aleksandër Xhuvani *“janë rrogëtarë e jo mësues”*.

Ndihmesë të madhe ka dhënë e po jep në këtë fushë Shoqata Mbarëshqiptare e Shkrimtarëve për fëmijë e të rinj, me veprimtaritë e shumta që ka organizuar e po organizon në Tiranë veçanërisht por edhe në qytetet e tjerë si dhe në Shkup e në Ulqin, me krijues nga të gjitha trevat shqiptare. Shtimit të radhëve të krijuesve, veç të tjerave, u ka shërbyer edhe dhënia e çmimeve nga kjo Shoqatë e nga Ministria e Kulturës, Rinisë e Gruas (katër çmime: një për prozën, një për poezinë, një për përrallën dhe një për përkthimin) vit për vit si edhe e çmimeve “Mark Tuen” në bashkëpunim me Qendrën Amerikane, “La Fonten” me Ambasadën Franceze, “Viktor Eftimiu”, me Ambasadën Rumune, “Mitrush Kuteli” me Fondacionin “Velija”, çmimin “Toena” me zotin Fatmir Toçi dhe “Vehbi Kikaj” me Euroriilindjen. Këtë vit kemi shpresa mos japim edhe çmimet “Menalao Ludemis” me Ambasadën Greke dhe “Xhani Rodari” me Ambasadën Italiane. Natyrisht një çmim do të jepet për krijuesit e rinj, se do të jetë nxitje për ata vetë e për të tjerët që kanë talent e që do t’i futen letërsisë për fëmijë.

Në fund të këtyre shënimeve nuk mund të lemë pa përmendur edhe një dukuri që e ka “goditur” disi krijimtarinë për fëmijë. Në vitet e vështirë të tranzicionit shumë shkrimtarë për fëmijë kanë marrë rrugën e mërgimit. Nëse shkrimtarët për të rriturit që kanë marrë rrugët e botës, numërohen me gishtërinjtë e njëjës dorë, shkrimtarët për fëmijë sillen rreth shifrës njëzet. Të tillë janë A.Mamaqi, N.Prifti, I.Reso, R.Pasmaçiu, S. Spahillari, Th. Bello, A.Babe, A. Petromilo, P.Çerkezi, R. Taho, S. Demolli, F.Laholli etj. Mungesa e tyre ndihet shumë në botimet tona për fëmijë. Ne i presim të kthehen përsëri në mes tonë. I presin me padurim edhe lexuesit e vegjël. Dhe ata do të kthehen. Shenjat janë: kohët e fundit u kthye në atdhe shkrimtari Ramadan Pasmaçiu, që me siguri do t’u dhurojë libra lexuesve të vegjël gjatë këtij viti. Le ta urojmë: Mirë se erdhe dhe paç këmbë të mbarë!

LETËRSIA PËR FËMIJË: ÇMIMET DHE PROBLEMET

Shoqata Mbarëkombëtare e Shkrimtarëve për fëmijë e të rinj, që përmbledh në gjirin e vet të gjithë shkrimtarët që shkruajnë për fëmijët e të rinjtë, nga të gjitha trevat shqiptare (Shqipëri, Kosovë, shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi) dhe diaspora, e krijuar më 21 mars të vitit 1991, qysh në hapat e saj të parë nisi të bëjë një sërë veprimtarish të ndryshme e të larmishme të cilat shpesh herë janë bërë të njohura si nga shtypi ashtu edhe Radio-Televizioni. Këto veprimtari i dhanë emër, duke e renditur me simotrat e saj (shoqata shkrimtarësh, piktorësh, skulptorësh, kompozitorësh etj., por edhe me Lidhjen e Shkrimtarëve e Artistëve). Shoqata jonë zë vend nderi për sasinë e cilësinë e veprimtarinë të zhvilluara në Tiranë e nëpër shumë qytete të Shqipërisë, por edhe në Tetovë, Shkup, Ulqin e gjetkë.

Një nga veprimtaritë e saj më të rëndësishme është edhe dhënia e Çmimeve letrare të përvitshme, në letërsinë për fëmijë. Ndahen çmime të shumta për librat më të mirë, në çdo lloj e gjini.

Përpjekjet për të dhënë çmime u bënë qysh në vitin 1991, por dihet se jo vetëm për atë vit, por edhe në vitet 1992 e 1993, nuk u krijua mundësia financiare. Shoqata jonë e varfër në fonde por e

pasur në vlera shpirtërore e letrare, e meritonte që të ndihmohej nga shteti, nga fondacionet e shoqatat e ndryshme... Me gjithë përpjekjet tona, për tre vjet nuk dhamë dot asnjë çmim.

Atë që nuk e arritëm në vitet e parë, mundëm ta realizojmë më 1994. Në këtë vit na u gjend pranë shqiptarja e madhe Nermin Vlorë-Falaski, nëpërmjet Shoqatës atdhetare-kulturore “Ismail Qemali”, me qendër në Vlorë, të drejtuar nga poeti Bardhosh Gaçe. Zonja e nderuar na vuri në dispozicion një shumë modeste dhe Shoqata dha dhjetë çmime, për dy shkrimtarë nga Kosova (Rifat Kukaj e Gani Xhafolli) për një shkrimtar shqiptar nga Meqedonia (Abdylazis Islami), për Redaksinë e letërsisë për fëmijë pranë “Flakës së Vëllazërimit” në Shkup (Resul Shabani, Halil Zendeli e Naxhi Osmani), për shkrimtaren arbëreshe Xhuzepina Khanfranko dhe për shkrimtarët nga dheu amë, siç thonë kosovarët (pra, nga Shqipëria) Mira Meksi, Ndoc Papeleka, Odhise Grillo, Ferhat Çakëri, Hamdi Meça.

Këtë punë e vazhduam edhe në vitin 1995 dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Gruas si dhe me disa ambasada, fondacione etj., dhamë katër çmime: për prozën shkrimtarit Aqif Malaj, për poezinë Odhise Grillos, për përrallën Nexhmije Muçës dhe për përkthimin Neka Turkeshit. Në bashkëpunim me Ambasadën rumune shkrimtari Bedri Dedja mori çmimin “Viktor Eftimiu”, me Ambasadën franceze Ferit Lamaj çmimin “La Fonten”, me Qendrën amerikane Sokol Jakova çmimin “Mark Tuen”, me Fondacionin “Velija” Dalan Shablllo çmimin “Mitrush Kuteli” dhe me “Eurorilindjen” çmimin “Vehbi Kikaj” Bekim Harxhi, pas vdekjes.

Shoqata Mbarëkombëtare e Shkrimtarëve për fëmijë e të rinj, me datën 21 prill 1997, në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, dha çmimet letrare - 1996, si më poshtë:

I. Çmime homazh:

1. *Moisi Zaloshnjës*, për librin “*Gjysmagjeli*” (poemë, botim i familjes së autorit, shtypur në Itali).

2. *Tuni Papuçiut*, për librin “*Supa dhe kamelet*”, (vjersha, tregime, skeçe, botim i Sh.B. “TOENA”).

3. *Bekim Gaçes*, për librin “*Shtëpiza fluturuese*” (tregime, përralla, novelë, botim i Sh.B. “TOENA”).

II. Çmime në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, rinisë dhe gruas:

1. *Viktor Canosinajt*, për librin “*Biri i erës*” (roman, botim i Sh.B. “TOENA”).

2. *Bardhosh Gaçes*, për librin “*Cicërijnë zogjtë e Sharrit*”, (përmbledhje me vjersha, botim i SH.B. “NAIM FRASHËRI”).

3. *Bedri Dedes*, për librin “*Përralla njëmbëdhjetëkatëshe*” (përralla, botim i Sh.B. “TOENA”).

4. *Vedat Kokonës*, për librin “*Fabulë*” të La Fontenit, (fabula të përkthyer nga frëngjishtja, botim i Sh.B. “TOENA”).

5. *Safo Markos*, për ilustrimet e librit “*Përtacukët*”, të O.Grillos (poemë humoristike, botim i Sh.B. “ROZAF”).

III. Çmime në bashkëpunim me Ambasada, Fondacione, Botues etj.:

1. Çmimi “*La Fonten*”: *Skënder Haskos*, për librin “*Mbreti i tigrave*” (novelë-përrallë, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze, botim i Sh.B. “TOENA”).

2. Çmimi “*Mitrush Kuteli*”: *Bardhyl Xhamës*, për librin “*Pse qau delfini*” (rrëfenja, në bashkëpunim me Fondacionin “VELIJA”, botim i Sh.B. “TOENA”).

3. Çmimi “*Viktor Eftimiu*”: *Mimoza Erebarës*, për librin “*Aventurat e 10x10 dhe Munirio Kokëposhti*” (roman, në bashkëpunim me Ambasadën Rumune, botim i Sh.B. “EURORILINDJA”).

4. Çmimi “TOENA” i Sh.B. “TOENA”: *Odhise Grillos*, për librin “*Një zog këndon e qan...*” (balada e legjenda në vargje, botim i Sh.B. “TOENA”).

5. Çmimi “*Vehbi Kikaj*” për talentet e reja: *Edlira Ramës*, për librin “*Kur vallzojnë lulet*” (përralla në bashkëpunim me “EURORILINDJEN”, botim i Sh.B. “TOENA”)

Këto çmime do të jepen edhe për vitin 1997. Shoqata jonë po bën përpjekje për të siguruar edhe disa çmime të tjera. Me ndërmjetësinë e shkrimtarëve Skënder Zogaj, punonjës në gazetën “Rilindja” (e Kosovës, versioni i Tiranës) dhe Odhise Grillos, vitin që vjen të jepet “Çmimi i karrierës” për një nga shkrimtarët më të njohur që do të ketë përvjetorin e 60, 65 ose të 70. I përmendëm të gjitha këto për të treguar se Shoqata jonë ka pasur disa synime e arsye që është munduar të japë kaq shumë çmime. Këto janë të shumta e të ndryshme dhe do të mundohemi t’i shtjellojmë më poshtë.

Dihet mirfilli se Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve ka qenë njerë për shqiptarët që krijojnë për fëmijët. Këtë e tregojnë faktet: asnjë shkrimtar për fëmijët nuk ishte në profesion të lirë, në një kohë që këtë privilegj e gëzonin disa autorë nga letërsia për të rriturit, të cilët nuk kishin dhënë e nuk jepnin ndonjë ndihmesë të ndieshme në letërsinë tonë. Lejet krijuese dhe oraret e redaktuara, shkrimtarëve që krijojnë për lexuesit e vegjël u jepeshin me pikatore. Mjafton të themi se krijuesit më të mirë nga letërsia për fëmijë mezi merrnin një ose dy muaj leje krijuese, ndërsa shkrimtarë mediokër, nga letërsia për të rriturit, merrnin edhe nëntë muaj (disa herë edhe një vit) brenda vitit. Numri i krijuesve për fëmijë që kishin orar të reduktuar ishte i paktë: vetëm katër-pesë veta kishin katërorësh dhe dhjetë-pesëmbëdhjetë prej tyre gëzonin gjashtorësh... Gjatë dyzet e pesë vjet që jetoi Lidhja, pothuajse asnjë shkrimtar për fëmijët nuk shkoi jashtë shtetit, me përjashtim të shefes së sektorit të letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes, që në

anketat e zhvilluara me lexuesit e vegjël vazhdimisht ka zënë vendin e tridhjetë a të dyzetë... si shkrimtare. Veç këtyre dhe shumë të tjerave që s'po i përmendim, shpërblimet për çmimet që merrnin shkrimtarët për fëmijë në konkurset e ndryshme ishin ja një aparat fotografik i papërdorshëm, ja ndonjë reflektor që kushtonte 1,000 lekë të vjetra...

Ky qëndrim i Lidhjes reflektohej edhe në shtypin e saj. "Drita" dhe "Nëntori" i hapnin dyert për krijuesit që shkruanin për fëmijët vetëm një herë në vit, me rastin e Ditës ndërkombëtare të fëmijëve, 1 qershorit, a thua se këta nuk merreshin me letërsi po ishin kalamaj...

Në të kundërtën, si "Drita" ashtu edhe "Nëntori", disa herë të manipuluar nga sektori i letërsisë për fëmijë, u vërsuleshin shkrimtarëve më të mirë për fëmijë duke i fyer e denigruar. Dhe këtë e bënin shkrimtarë për fëmijë të cilëve, "veprat" që krijojnë, ua shkruanin apo ua mermetonin të tjerë... Se duhet ta pranojmë, që si në Lidhje ashtu edhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri" (në redaksinë e letërsisë për fëmijë), me ndonjë përjashtim, kanë drejtuar më të paaftët e më mediokrit, të cilët zor se kishin lexuar edhe Kristoforidhin dhe që vjershat e Naimit ia vishnin Çajupit apo e kundërta.

Edhe në letërsinë për fëmijët, në të kaluarën, jepeshin çmime, kur organizoheshin konkurse me raste përvjetoresh të ndryshëm. Këtu luhej një komedi groteske: në juri viheshin shkrimtarë që shkruanin për të rriturit, po që nuk kishin lexuar asnjë fjalë (lëre më vepra) nga letërsia për fëmijë; çmimet disa herë jepeshin sipas karriges që zinte autori: mund të të jepte juria çmimin e parë; por kur shpalleshin përfundimet mund të përfundoje në çmim të tretë apo të mos figuroje fare etj., etj., marifete. Madje në fund të viteve '80, kur gazeta "Drita" në një kryeartikull lavdëronte disa autorë e disa vepra të tyre, juria shpallte pak ditë më vonë, po në "Drita", se gjatë vitit 1987 nuk kishte vepra cilësore në letërsinë për fëmijë.

Pse bëhej kjo? Që të mos fitonte çmimin “Migjeni” një vepër e një autori që ish shefja e letërsisë për fëmijë nuk e kishte në tarafin evet. E jo vetëm kaq: ky çmim desh t’i jepej një autori të njohur për një vepër të botuar e të ribotuar disa herë, qysh para tridhjetë vjetëve, edhe pse çmimet jepeshin për veprat e vitit 1987 (nga tetori në tetor, që ishte muaji i letërsisë dhe i arteve).

Kjo mendësi vazhdon edhe sot. Kemi dëgjuar se Sektori i Ybb-it në Shqipëri, vitin e kaluar i dha çmimet duke hedhur letra me birë, vetëm e vetëm që të mos fitonin veprat e autorët e mirë e të njohur. Po kështu, në gazetën e këtij Sektori, për të mos publikuar çmimet që u dhanë në Manifestimin poetik të Tetovës - 1995 (ku fituan Gani Xhafolli, Ferid Lamaj, Adem Abdullahu, Taxhedin Halimi e Odhise Grillo), u publikua vetëm emri i F. Lamajt, me shënimin se “çmimin ia kishte dhënë “Flaka e Vëllazërimit”, e cila del në Shkup dhe nuk mori pjesë fare në Manifestimin poetik të Tetovës. Dhe e gjitha kjo bëhet për të mos dalë emri i ndonjë “të padëshiruari” edhe pse është nga autorët më të njohur në letërsinë për fëmijë. Harrojnë te Sektori Shqiptar i Ybb-it se vlerat e shkrimtarëve nuk ulen në rast se nuk i boton “Sirena e vogël” emrat e tyre, por ulet emri i gazetës dhe i botuesve të saj kur diziformojnë...

S’mbaftonin të gjitha këto “prapësi”, kur në një tryezë të rumbullakët, që organizoi Lidhja në vitin 1986, për letërsinë për fëmijë, dy shoqe, njëra "shkrimtare" e tjetra "kritike", dolën me një teori të re që nuk e kishte parë e dëgjuar bota. Këto zonja, të cilat deklarorin se “gjer në fund të jetës do të merreshin me letërsinë për fëmijë”, por që sot merren me tregti apo diçka tjetër të këtij lloji, hodhën parullën: *“S’ka ç’na duhen shkrimtarët për fëmijë. Ne do t’u themi shkrimtarëve tanë më të mirë nga letërsia për të rriturit që të krijojnë edhe për të vegjëlit dhe e kemi të zgjidhur këtë problem.”* Harruan zonjat e nderuara se në Itali letërsinë për fëmijë e mbajtën Kolodi, Rodari, Maçioki, Orvjeto, Arxhili, Naneti

etj., dhe ndihmuan edhe krijues të tjerë nga letërsia për të rriturit. Harruan që ato dhe gjithë bashkëmoshatarët e tyre lexuan vepra të Shqipashovit, Mihallkovit, Bartos, Nosovit, Gajdarit, Çukovskit e shumë të tjerëve që iu përkushtuan letërsisë për fëmijë në ish Bashkimin Sovjetik, ku dhanë ndihmesë edhe shkrimtarë që shkruanin për të rriturit. E po duhej që edhe në fushën e letërsisë për fëmijë vendi ynë të zinte vendin e parë në botë, ashtu siç e “zinim” e siç e “zëmë” edhe sot në të gjitha fushat...

Të gjitha këto (por edhe të tjera, me të cilat duhet të merren kritikët e studiuesit tanë të letërsisë për fëmijë) bënë që shumë autorë, të cilët merreshin me letërsinë për fëmijë, të kalojnë në letërsinë për të rriturit. Le të kujtojmë këtu ikjen e Skënder Drinit, që pasi botoi mbi dhjetë libra për fëmijët (tregime, novela, romane) po nuk fitoi asgjë, kaloi përgjithmonë në letërsinë për të rriturit. Koço Kosta librin e parë e botoi për lexuesit e vegjël, por kur e pa që ishte një fushë “pa bereqet” kaloi në letërsinë për të rriturit. Kështu vepruan edhe shumë të tjerë. Kjo ikje la një boshllëk që u mbush me grafomanë, pasi duhet të botonim njëqind libra për fëmijët, sipas udhëzimeve nga lart, me proporcionin 85% letërsi shqipe dhe 12% letërsi e huaj. Letërsi nga shkrimtarët në Kosovë e nga trevat e tjera shqiptare vetëm 3%...

Shumë të rinj që kishin dëshirë të shkruanin për fëmijët u larguan, nga politika që ndoqi sektori i letërsisë për fëmijë në Lidhje, nga tezat “gjeniale” se s’kishte nevojë për shkrimtarë që të krijonin për fëmijët e në përgjithësi, nga trajtimi që u bëhej krijuesve që shkruanin për lexuesit e vegjël.

Dhe këtë e paguam shtrenjt. Në fund të viteve ‘80 ne mezi botonim dhjetë-dymbëdhjetë libra për fëmijët në vit, në një kohë që tani vetëm Shtëpia Botuese “Toena” e zotit Fatmir Toçi boton dyzet libra në vit. Veç kësaj na u krijua një boshllëk i madh, pasi tani, nga mosha 15 gjer 35-40 vjeçare, duke përjashtuar Mira Meksin, Ferdinand Lahollin e ndonjë tjetër, nuk kemi autorë që të

krijojnë për fëmijët.

. Të gjitha këto e bënë Shoqatën tonë të mendojë për ta stimuluar letërsinë për fëmijë dhe autorët e saj. Këtu po ndiqen shumë rrugë e po bëhen shumë veprimtari. Vend nderi zë edhe dhënia e çmimeve vjetore në letërsinë për fëmijë, të cilën mendoj se e kemi kurorëzuar me sukses. Veç kësaj, në letërsinë për fëmijë po krijojnë edhe autorë të moshuar që s'janë marrë me këtë fushë. Kështu shkrimtari Dalan Shaplo, që gjer në 70 vjet të jetës së tij (u bëftë 170 vjeç!) nuk krijoi asnjë tregim për fëmijët, tani u bë fitues i çmimit "Mitrush Kuteli" (për vitin 1995) me novelën për fëmijë "Vajza që dinte gjuhën e zogjve" dhe ka gati edhe një përmbledhje me legjenda. Mund të përmendim edhe emra të tjerë, por ky shembull mendoj se mjafton.

Tani që po e shohim se në letërsinë tonë për fëmijë po hyjnë forca të reja, se po botohen mbi njëqind e njëzet vepra në vit (origjinale e përkthime), se shtëpitë botuese po ua hapin dyert në dy kanata autorëve që krijojnë për lexuesit e vegjël etj., Shoqata jonë, në mos për vitin 1997, në vitet që do të vijnë, kur letërsia për fëmijë do të jetë çliruar nga vargonjtë e atmosfera mbytëse e së kaluarës dhe do të ecë me këmbët e veta, me siguri do të japë më pak çmime, duke ua rritur vlerën dhe ndikimin çmimeve. Mbase atëherë do të japë një çmim për prozën e një për poezinë. Ndoshta ndonjë edhe për karrierën. Çmime homazh po se po.

EDHE NJË HERË PËR LETËRSINË DHE BOTIMET PËR FËMIJË...

Në vitet '80, për arsye që dihen mirë tashmë, vendi ynë pati një rënie drastike në të gjitha fushat. Kjo u ndie edhe në fushën e letërsisë e të botimeve në përgjithësi, por veçanërisht në botimet letrare. Mjafton të themi se Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", i vetmi institucion që botonte letërsi artistike, mezi arrinte të publikonte rreth njëqind libra në vit, në një kohë që kishte afro tetëdhjetë punonjës, të cilët vite me radhë kishin arritur të botonin edhe treqind libra në vit, duke përfshirë këtu letërsinë origjinale të autorëve shqiptarë, përkthimet nga letërsia botërore dhe ato pak libra (mund ta themi: "me pikatore"...) të shkrimtarëve nga Kosova, shkrimtarët shqiptarë të ish Maqedonisë etj.

Veçanërisht kjo rënie u ndie shumë në letërsinë për fëmijë. Në vitet '70, redaksia e letërsisë për fëmijë në këtë institucion arriti të botonte rreth njëqind libra në vit, paçka se në letërsinë tonë për të vegjëlit nuk kishte kaq forca për ta përballuar një shifër të tillë, aq më tepër se nga letërsia e huaj, për këto lexues e vegjël, botoheshin dhjetë-pesëmbëdhjetë libra e nga shkrimtarët e Kosovës vetëm tre-katër. Po atëherë si mund të botoheshin rreth njëqind në vit?

Shumë lehtë... Burokratët gjetën një rrugë shumë origjinale e për të qeshur: librin me vjersha të poetit të njohur Tasim Gjakutaj e ndanë copë-copë dhe me të botuan shtatë libra me nga tetë e dhjetë faqe (!) Besoj se mjafton ky shembull, prandaj nuk po përmendim të tjerë.

Në vitet '80 numri i librave të botuar për lexuesit e vegjël nisi rrokullisjen dhe zbriti në pesëdhjetë, dyzet, tridhjetë... Ndokush mund të mendojë se me uljen e numrit të botimeve u rrit cilësia. Në një farë mënyre po, se një pjesë e krijuesve më të mirë vazhdonin të botonin, por nuk duhet të harrojmë se nëpërmjet miqësive, tarafeve, gotës së rakisë dhe dreka-darkave, bashkë me librat e mirë botoheshin edhe shumë të dobët, duke u ngushtuar botimin krijuesve me vlera.

Në këtë kohë u ngjall një shpresë në letërsinë për fëmijë, në dy drejtime: në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve u krijua Sektori i letërsisë për fëmijë me drejtuese zonjën Shpresa Vreto, një krijuese e zakonshme, e cila e çau rrugën për të drejtuar letërsinë për fëmijë duke u futur në Partinë e Punës dhe nëpërmjet shumë ndërhyrjeve, a thua se nuk kishte shkrimtarë të tjerë më të talentuar e më të zotë për ta drejtuar këtë sektor... Po kështu, drejtor i Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", fill nga Sektori i Shtypit në Komitetin Qëndror të Partisë, ku punoi përmbi dhjetë vjet, erdhi shkrimtari Gaqo Bushaka.

Të gjithë krijuesit që merreshin me letërsinë për fëmijë gëzuan, duke menduar se tashmë që në këto institucione ishin në krye shkrimtarë që shkruanin për lexuesit e vegjël, letërsia e botimet për fëmijët do të viheshin në rrugë të mbarë. Mirëpo u zhgënjyen...Kjo ndodhi për shumë arsye.

Me të ardhur drejtori i ri në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", u hodh parulla *"Në letërsinë për fëmijë kemi vetëm katër-pesë shkrimtarë, kështu që s'mund të botojmë me shumë se dhjetë-dymbëdhjetë libra në vit."* Dhe kjo u vu për njëherësh në jetë.

Numri i librave të botuar nisi të bjerë vit për vit dhe me të vërtetë arriti në dhjetë. Kjo që një goditje për krijuesit që merreshin me letërsinë për fëmijë dhe veçanërisht për lexuesit e vegjël, të cilët ishin mësuar të kishin në duar me shumë tregime, romane, novela, përralla, vjersha, poema etj. Kjo bëri që shumë shkrimtarë ose të hiqnin dorë nga letërsia për fëmijë, ose të integroheshin në letërsinë për të rriturit, gjë që ishte tepër e vështirë. Megjithatë ndonjë mundi të botojë për lexuesit e rritur.

Kështu ju vështirësua botimi shkrimtarit të mirënjohur Bedri Dedja, antipatinë ndaj të cilit drejtori e kishte shprehur qysh më parë, duke hedhur si leckë romanin “Si u rrit një komisar” të profesorit, para katër redaktorëve të letërsisë për fëmijë e duke thënë : “Ç’janë këta romane pa vlerë që botoni!” Dhe ja përgjigja e të ndjerit Kostandin Leli, redaktor në redaksinë e letërsisë për fëmijë: “Ky roman është më i mirë nga romanet e tu.”

Po kështu u veprua edhe me autorë të tjerë si Bekim Harxhi, Xhahit Bushati etj. Shkrimtarit S. Jakova ju kthyen dy libra megjithëse recensuesit, redaktori e shefi i redaksisë thoshin fjalët më të mira për ta (dikur Sokoli e kishte kritikuar për një vepër, në një shkrim që kishte bërë për letërsinë për fëmijë, dhe drejtori nisi “t’ia shpërblente”...); shkrimtarit Odhise Grillo ia vononin edhe një vit botimin, duke ia mbajtur veprën në sirtar (“Erdhi ditë e Arbrit”, rikrijim i “Milosaos” së De Radës) ose përpunoheshin recensues të shpifur, të cilët nuk kishin lexuar asnjë rresht për fëmijët, që ta hidhnin poshtë si të pavlerë “Don Kishotin e Maçes” (roman i rikrijuar për fëmijët, sipas veprës së Servantesit), në një kohë që Jorgo Bullo, Nasho Jorgaqi etj. kishin bërë recensa të shkëlqyera. (Të gjitha recensat origjinale ruhen në arkivin personal të autorit...) Sa për dijëni, ky roman u botua në 15.000 kopje me 1994 dhe fitoi çmimin “Ismail Qemali”, dhënë nga Shoqata omonime dhe nga zonja e nderuar Nermin Falaski Vlora.) Mjaftojnë këta shembuj, po në rast se duhen mund të përmendim

me dhjetra të tjerë, ashtu siç mund të përmendim raste kur libra të dobët e të kthyer nga gjithë redaksia (jo vetëm nga redaktori), si ai i shkrimtarit E., u dha urdhër të botohen, pas një darke me gjeldeti që ishte ngrënë në fshatin e autorit...

Nuk mjaftuan këta grushte kundër shkrimtarëve që krijojnë për fëmijët, kur goditjet erdhën edhe nga Sektori i letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes së Shkrimtarëve. Së pari u "unifikuan" ato pak leje krijuese që jepte Lidhja, për ata që merreshin me letërsinë për fëmijë: dy muaj merrnin shkrimtarë me emër e dy muaj edhe grafomanë e zanatçinj si R,Ç. etj. që kopjonin shkrimtarë të letërsisë së huaj, ndërsa i ndjeri Bekim Harxhi që botonte vazhdimisht libra me cilësi, nuk merrte asnjë muaj... Edhe në qoftë se mori, leja ju dha më vonë, me ndërhyrjen e kryetarit të Komisionit të letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes, të Dritëro Agolli. Kështu ndodhi disa vjet.

Pasi u kthye nga një vizitë në Francë dhe shkrimtarët për fëmijë prisnin të përfitonin nga përvoja e shkrimtarëve francezë që krijojnë në këtë fushë, zonja Shpresa Vreto u tha kolegëve të vet: "*Mos u merni me letërsinë për fëmijë se ajo është e dorës së dytë.*" (Duhet të shtojmë këtu se edhe ata dy-tre krijues për fëmijët që shkuan jashtë shtetit, në ato vite, ishin nga shkrimtarët më të dobët, ose shkrimtarë të tjerë që jo vetëm s'kishin krijuar për fëmijët, por as kishin lexuar letërsi për ta qyshse kishin qenë të vegjël...)

Goditjen më të madhe letërsia për fëmijë dhe krijuesit e saj e morën në simpoziumin e organizuar me shkrimtarët në Tiranë, me temë "*KOHA, LETËRSIA, SHKENCA LETRARE*", ku pati edhe një tryezë të rrumbullakët për problemet e letërsisë për fëmijë, të cilën e drejtoi shkrimtari Zija Çela, në cilësinë e anëtarit të kryesisë së Lidhjes. (Zoti Zija Çela është një nga krijuesit më të mirë në fushën e prozës për të rriturit, por me letërsinë për fëmijë nuk e lidhte asgjë në atë kohë... Ndryshe nga sot që ka shkruar një përmbledhje me tregime për ta...)

Në tryezën e rrumbullakët u hodh ideja se "*S'ka ç'na duhen*

shkrimtarët për fëmijë. Ne do t'u bëjmë thirrje shkrimtarëve që krijojnë për të rriturit që herepashere të shkruajnë nga një vepër për të vegjëlit dhe kështu e zgjidhin këtë problem." Kjo ide u hodh nga shefja e sektorit të letërsisë për fëmijë, edhe me cilësinë e zëvendësekretares së organizatës bazë të Partizë së Punës të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve dhe mbështet edhe nga "studjuesja e kritikja" Z.K., të cilën në letërsinë për fëmijë e kishte sjellë nevoja për të marrë një rrogë.

Të gjitha këto por edhe shumë të tjera, të cilat i kam trajtuar në shkrimet "Dukuri të reja në botimet tona për fëmijët", dhe "Letërsia për fëmijë: çmimet, problemet", botuar te revista "Universi i librit" nr.1-1996, faqe 55-57 dhe "Universi shqiptar i librit", nr.1-1997, faqe 38-40, bënë që në letërsinë tonë për fëmijë të mos hyjnë forca të reja e madje të ikin edhe ato forca që kishin dhënë ndihmesë të madhe në letërsinë tonë për të vegjëlit. Si përfundim ne tani kemi një boshllëk të paktën njëzetvjeçar, pasi krijues nga mosha pesëmbëdhjetë gjer në dyzet vjeç nuk kemi pothuajse fare me përjashtim të dy-tre vetëve, si M.Meksi, V. Canosinaj, F. Laholli, Sh. Zalli e ndonjë tjetër.

Duke qenë i lidhur me letërsinë për fëmijë nëpërmjet krijimtarisë pesëdhjetëvjeçare por edhe nëpërmjet fijesh të tjera, të them të drejtën pësova një zhgënjim e rashë në pesimizëm për fatin e kësaj letërsie. Mirëpo kohët ndryshuan, të tjera erëra frynë në vendin tonë e në këtë kuadër edhe në letërsinë për fëmijë, dhe tani më ka përfshirë... optimizmi.

Dhe s'ka pse të mos bëhesh optimist kur sheh se në letërsi po hyjnë forca të reja. Vetëm gjatë viteve '95-'97 kanë dalë me nga një, gjer katër libra shumë autorë të rinj, pjesa më e madhe e të cilëve krijojnë për fëmijët, në prozë e në poezi. Dhe këta janë nga gjashtë gjer në pesëmbëdhjetë vjeç. Se tani në letërsi nuk hyhet më në moshën 17-18-vjeçare si dikur, pasi brezi i ri i ditëve tona vjen në jetë shumë më i përgatitur në të gjitha drejtimet. Fëmijët

sot kanë përshpejtim të habitshëm psikologjik, mendor, fizik etj., po t'i krahasosh me moshatarët e tyre të disa dekadave më parë. Ata vijnë më të përshpejtuar edhe në fushën e krijimtarisë.

Talentet e reja të bëjnë patjetër optimist edhe në fushën e letërsisë për fëmijë, kështu që urojmë të mbushen sa më parë radhët e mbetura bosh.

MIRË SE ERDHE!

Shumë vjet më parë, në një ditë të nxehtë vere, te pishat para Shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, ku punoja, më ndaloi një djalosh trupvogël e i imët, me sy tepër xixëllues e zhbirues, a thua se ishte Jezu Krishti vetë! Edhe vetëm nga sytë e tij e kuptoja se ishte i zgjuar e kërkonte për të çelur rrugë në jetë... Më pyeti në se isha shkrimtari O.G., u prezantua dhe u interesua për fatin e librit të tij me vjersha për fëmijët.

U zura tepër ngushtë. Nuk dija çfarë t’i thosha. Për një çast m’u lidh gjuha, pastaj e mora pak veten dhe e inkurajova duke i thënë të shkruante vjersha lirike për të vegjlit, pasi aty e shikoja të ardhmen e tij. (Dhe jeta e tregoi më së miri këtë gjë...). Prej djaloshit kisha lexuar tri-katër përmbledhje me vjersha për fëmijët, në dorëshkrim, dhe kisha vënë re se kishte prirje t’i këndonte natyrës, luleve, zogjve, pyllit, lumit, ylberit, blerimit, gjithçkaje të bukur që na rrethon e na kënaq sytë dhe zemrën. Ai nuk u befusua nga ato që i thashë, pasi në përgjigjet që i kishim dërguar për dorëshkrimet, i kishte lexuar disa herë po ato fjalë...

Një çast mendova t’ia them në sy të vërtetën, por pastaj u pendova: një veprim i tillë mund të më kushtonte shumë shtrenjtë.

Unë sapo isha kthyer nga një degdisje pesëvjeçare vetëm për një figurë, që e kisha huajtur nga Naimi i madh dhe nga populli: nga folja “digjet” (“Digjem, përvëlohem” thotë Naimi. “Digjet nur” thotë populli. E po populli thotë për një dëshmor: “ Në ballë të digjet ylli” etj.) Dikush në majë të piramidës e kishte quajtur të gabuar dhe u akuzova se “*kisha djegur simbolet e komunizmit*”, dhe kur pa, më 1975!). Natyrisht këtu kishte ndihmuar edhe ndonjë shkrimtaruc që ishte puthakëmbës i diktaturës (të thuash puthadorës, është pak...) me “analizën” që i kishte bërë vjershës sime. Pas kësaj m’u hoq e drejta e botimit për dy vjet e mora rrugët jashtë Tiranës, familjarisht. Si mund t’i thosha s’e ai s’botonte dot libra, pasi ishte i internuar e “armik i klasës”? Po të bëja këtë “më priste prifti gjuhën”, siç thonë në Vuno. Se kishte dhe më keq: pas Elbasanit ku shkova me familjen, kishte edhe Shpat, kishte edhe Zavalinë e, ruajna Zot, kishte edhe Savër e Spaç!

U ndava me një brengë në zemër për fatin e atij djaloshi të talentuar, që edhe pse e pashë vetëm një herë e për pak çaste, më mbeti në mendje për gjithë jetën.

Kaluan shumë vite dhe për të nuk mësova asgjë. Në vitin 1991, në ato ditë kur Shqipëria me guxim djaloshar dhe studentor kërkonte të hynte në Evropë, m’u kujtua djaloshi i internuar në Savër, pasi në “Zërin e Rinisë” lexova vjersha të nxjerra nga shtypi arbëresh, të cilat i kishte shkruar emigranti “Felahu”. I lidha tri rrokjet me emrin e tij dhe u binda që ai djalosh i kishte shkruar. Pra kishte ikur me “valën e ambasadave” dhe kishte shkruar në Gjermani. Sa mirë...

Duke qenë i çliruar nga frika e diktaturës e ndjeva për detyrë të shkruaja diçka e t’i kërkoj falje për sa kishte ndodhur dhe në gazetën “Lira” botova shkrimin “*Më ndje zoti Ferdinand...*” Aty tregoja për djaloshin që diktatura nuk e la të këndonte, për librat e tij, për takimin tonë të dikurshëm dhe për fatin e krijimeve që kishte shkruar për fëmijët. Në fund i kërkoja ndjesë, jo vetëm se

nuk i kisha botuar dot librat por në radhë të parë, që s'kisha patur guximin t'i tregoja të vërtetën e hidhur, që ai, edhe pa fjalët e mia, e kuptonte vetë... Dhe isha i sigurtë se djaloshi, duke e ditur më mirë se unë në ç'ferr jetonim, do të më falte.

Dhe ja ku erdhi ajo ditë që poeti i ri të më ndjejë: kohët e fundit, pas dy librave për të rriturit, të botuar nga Shtëpia botuese "Lilo" në Tiranë, ai ka dërguar për botim nga Gjermania një libër me vjersha për të vegjlit, të titulluar "Libri i dëshirave", e që ka shprehur edhe një dëshirë më shumë se ato që ka në vjersha: t'i shkruaj një parathënie.

Këtë kërkesë e pranova me kënaqësi, se kështu mund të shlyej sadopak atë detyrim të madh që kam ndaj tij... Po para se të shpreh ndonjë mendim për vjershat që ka shkruar për fëmijët, zemra më tha të tregoj diçka për jetën e për dëshirën e tij të flakët për të krijuar për të vegjëlit, për njohjen tonë, për kalvarin e vuajtjeve që hoqi edhe në fushën e letërsisë, veç vuajtjeve që përjetoi në mes të baltrave të Savrës së Lushnjës.

Le të mbeten të gjitha të shkuara e të paharruara!

* * *

Pasi mbarova së lexuari përmbledhjen poetike të poetit të ri e të talentuar Ferdinand Laholli dhe e lexon krye e fund me një frymë e me kënaqësi të madhe), me një herë thua me vete:

"Ky është një poet lirik që i këndon natyrës, ashtu siç mund t'i këndojë vetëm fëmija! Është një peisazhist, si Mioja i famshëm, në poezinë për fëmijë".

Po të bësh një ekskursion tematik në vjershat e Lahollit do të gjesh patjetër një lumë që rrjedh me rrëmbim apo qetë-qetë (si Devolli në dimër e në verë...); do të gjesh një vjershë për nënën e tij e për nënat e të gjithëve, të shkruar me shumë ngrohtësi; do të gjesh një vjershë për hënën e zbehtë që ka nevojë për ca drita të

mëdha elektrike që të ndriçojë më shumë (ndofta “Hënë” është Savra me baltë e errësirë...): do të gjesh një vjershë për erën e për dëshirën e fëmijës që ta shalojë si kalë (i vetmi mjet me të cilin mund të udhëtonte në internim...); do të gjesh një derë shtëpie që të pret e të përcjell me mall (kueshedi sa mall kishte djaloshi për shtëpinë e vendlindjes...); do të gjesh një pyll të mbuluar jo nga degët e fletët si çdo pyll në botë, por “*të mbuluar nga këngët e zogjve*”, siç thotë poeti. Dhe me radhë: do të gjesh një vjershë për diellin, detin, shiun, borën, horizontin, ylberin, ombrellën, traktorin, dimrin, mackën, fletoren, ëndrrën, vizatimin...

Siç shihet, syrit të poetit, pothuajse nuk i shpëton asgjë nga ato që na rrethojnë. Mirëpo këto nuk përbëjnë atë që është thelbësore në poezinë e tij. Këto janë objektet për të cilat kanë kënduar sa e sa poetë në shekuj. Prandaj me të drejtë pyet:

“Ku është e veçanta në poezinë e Ferdinand Lahollit? Ç’ të re sjell ai në vjershat e veta?”

Ferdinand Laholli nuk ka ngelur thjesht një peisazhist në poezinë për fëmijë. Ai ka shkuar më tej me gjetjet e reja e befasuese, me mantelin që u ka hedhur krahëve krijimeve të veta e që kanë vulë personale, me figuracionin e spikatur e të kursyer që i shkon moshës, me ndjenjën e ngrohtë që përshkon poezitë dhe me njohjen e botës së vogëlushëve. Plus këtyre edhe me rimën, ritmin dhe muzikalitetin e vargjeve.

Janë të rralla vjershat e poetit që të mos kenë një gjetje sado të vogël, por të bukur (njëlloj mikrofabule), ashtu siç e duan fëmijët, që t’u ngelet në mendje pasi ta lexojnë vjershën. Natyrisht ka edhe ndonjë krijim me gjetje disi të vakët apo mesatare e ndonjë tjetër që diçka përsërit, por këto nuk përbëjnë të tërën dhe janë të natyrshme në rrugën krijuese të çdo poeti. Aq më tepër të fillestarëve. Thelbësore në përmbledhje mbetet kërkimi dhe gjetjet interesante, ku me vargje të kursyer poeti ka shkrirë mendimin, ndjenjën, figurën dhe teknikën e organizimit të vargut.

Ku e shohim lirizmin? Ku i shohim prurjet e reja të këtij poeti të ri?
Përgjithësisht në poezinë tonë për fëmijë, të vegjëlve u vihen
flatra zogu për të shkuar me mendje në planetet e tjerë. Mirëpo sot
kjo është anakronike, prandaj edhe Laholli e zëvendëson mjetin e
udhëtimit dhe shkruan:

Kjo dëshirë,
e dimë mirë,

na do hipur në... raketë!

Një gjetje e vogël në dukje, por që thotë shumë.

Dera e shtëpisë na vlen të gjithëve për të hyrë e për të dalë.
Për poetin ajo ka edhe një detyrë tjetër, shumë të rëndësishme:

...po shpesh herë,
të më nxjerrë

për të njohur botën mbarë!

Kjo ka një domethënie të madhe veçanërisht për ne, që i patëm
të mbyllura dyert e botës për rreth pesëdhjetë vjet. Aq më tepër
për poetin Laholli...

Dashurinë për gjyshen autori e shpreh me një gjetje interesante,
natyrisht të parë me sytë e fëmijës: kur të rritet vogëlushi do të
ngjitet në qiell, do të marrë diellin, do ta zbresë në tokë në mënyrë
që *“gjyshja e tij ta ketë në sy!”*

Në verë deti buçet jo nga valët, por nga zërat gazmore të
fëmijëve dhe pushuesve. Prandaj është i gëzuar... Por në dimër
tërbohet e ulërin si i marrë dhe është i trishtuar. Me sa duket është
zemëruar që i kanë ikur njerëzit. Për ta qetësuar, pranë tij vogëlushi
dhe deti *“ndihet më i qetë...”* e ndofta bëhet qengj.

Në dimër bie shumë shi e shpesh fushat përmythen. Për këtë i
dhemb në shpirt vogëlushit, prandaj mendon që kur të rritet do të
shpikë një mjet që ta ndalojë shiun e tepërt në dimër dhe do ta
urdhërojë të bjerë *“bimët kur të kenë vapë!”*

Një dëshirë të përafërt ka vogëlushi edhe në vjershën *“Dëgjo
erën”*. Objekti ndryshon, por edhe gjetja: ai mendon ta futë erën e

marrë në shishe dhe natën t'i heqë tapën e ta lëshojë nëpër rrugë e sheshe, në mënyrë që të ndihmojë fshesarët, të cilët lodhen nga puna e vështirë e nga pagjumësia, për ta bërë qytetin më të pastër. Në këto vargje ndihet një ndjenjë e madhe dashurie e respekti për punën e punëtorit...

Ç' dëshira fisnike të shprehura në vargje nga poeti! Këto janë dëshirat e fëmijëve, se ata veprojnë e flasin nëpër vjersha, por edhe të autorit, prandaj titulli i librit është shumë i përligjur e i gjetur, edhe pse i thjeshtë e ndofta i përsëritur.

Fedinand Laholli pothuajse në çdo vjershë përpiket të gjejë figura të lehta në pamje të parë, por që i shkojnë përshtat moshës, që pëlqehen shumë e kapen lehtë prej fëmijëve. Kështu në vjershën "*Hëna*", autori ndërton një figurë (e bën hënë piktores dhe shpik një ngjyrë të re: ngjyrën hënore) kur thotë se hëna:

Si piktores,
bojë hënore
i jep botës rrethëqark.

Në vjershën "*Ombrella*" poeti i ka vënë retë "*të kapen për flokësh*" e të qajnë, se ka ardhur "*stina e grindjes*" së tyre, vjeshta. Por nuk mbetet me kaq; ai ka dëshirë të ndërtojë një ombrellë të madhe sa të mbulojë krejt botën, që "*të mos laget asnjeri!*"

Është dimër por fëmijët i kanë këpucët të pastra e pa një pikë balte. Këtë "çudi" e bën bora: ajo shtron rrugët e sheshet dhe kështu "*Këpucët e vogëlushëve ndritin si pasqyrë*". Pikërisht te kjo çudi e borës qëndron figura e qëndisur me shije nga autori.

Figurat në vjersha janë të shumta e vijnë varg njëra pas tjetrës:

Fëmija i ka sytë të kaltër prandaj edhe babai i vet e do më shumë se të tjerët. Po pse? Se "*babi detin sheh aty*", pasi është peshkatar.

Ka ardhur pranvera dhe pëmishtja po vishet me të bardha, prandaj poeti thërret nëpërmjet një figure kuptimplote: "*Hapu fletë! Zgjohu ngjyrë!*"

Fëmija shkruan mbi rërë emrin "*Babi*", se e do shumë, po

vjen vala dhe ia fshin, ia merr... Por vala s' mund të thotë se e la pa baba vogëlushin, pasi ai e ka brenda në zemër e *"nga zemra s'ia merr dot!"*

Poeti Ferdinand Laholli, ndryshe nga shumë të tjerë të moshës së tij, që nuk u kushtojnë kujdes mjeteve të formës, organizimit të vargut e të strofës, larmisë së ritmeve, vargjeve, rimave etj., (dikush nën ndikimin e poezisë moderne që u shkon për shtat të rriturve po jo fëmijëve, dikush nën ndikimin e poezisë moderne që u shkon për shtat të rriturve po jo fëmijëve, dikush nga mungesa e këmbënguljes dhe e kërkesave ndaj vetes e dikush nga pazotësia...) na shfaqet një mjeshtër i vargut që të kujton Lasgushin në poezinë për të rriturit e Adelina Mamaqin, Xhevat Beqarajn e Bekim Harxhin në poezinë për fëmijët.

Të gjitha poezitë e tij në këtë përmbledhje që u drejtohet lexuesve të vegjël, kanë rimë e ritëm: vargjet kanë muzikalitet e rrjedhin dhe rrallë, për të mos thënë asnjëherë, të takon të ndeshësh në rima të varfra, asonanca e konsonanca. Veçanërisht të lë mbresë këmbëngulja e autorit për ndërtimin e strofave gjashtëvargëshe (sestinave), ku vargu i parë rimon me të dytin, i treti me të gjashtin dhe i katërti me të pestin (AA-B-CC-B), gjë që ndeshet rrallë në poezinë tonë për fëmijë.

Ja "fati" që u përcakton vargjeve të veta poeti, kur u thotë të vegjëlve:

*I gëzuar,
i menduar,
nëpër fletë i mbjell me penë.
Hiç mos prisni,
i braktisni
zemërbardha po mos qenë!*

Falë talentit e djersës së autorit, fëmijët as do t'i braktisin e as do t'i grisin, por do t'i rilexojnë vargjet më të bukur të poetit, se ato janë shumë zemërbardha e të frymëzuara.

Vjershat, gjetjet apo fabulat e vogla, figurat, befasitë, vargjet

që rrjedhin, rima, ritmi, konciziteti etj., tregojnë qartë se Ferdinand Laholli i njeh fëmijët, njeh dëshirat, ëndrrat e kërkesat e tyre ndaj poezisë dhe di t'i krijojë vjershat për ta me mjeshtëri, duke patur zërin e vet origjinal qysh në përmbledhjen e parë poetike.

Ashtu siç e nënvizuar edhe më lart, mund të themi me plot gojën se poeti Ferdinand Laholli është një poet lirik që i këndon natyrës, është një peizashist që di ta përdorë me mjeshtëri penelin... në poezinë për fëmijë.

Po jo vetëm kaq. Ai shkon edhe më tej, se manteli që u vesh krijimeve bën që në vjersha t'i këndohet njeriut e dëshirave të tij (pra, të vogëlushëve), të cilat janë të shumta, të ndryshme, të bukura e frymëzuese.

A nuk e gjejmë këtë njeri-vogëlush te vjersha ku thuhet se te planetët e tjerë fëmijët do të shkojnë me raketë; te vjersha ku i vogli do të shalojë erën; te vjersha që i thotë derës së shtëpisë ta nxjerrë anembanë botës; te vjersha ku thuhet se do të ngjitet në qiell të marrë diellin e t'ia vendosë gjythes së vet të verbër në sy; te deti që qetësohet në dimër nga prania e fëmijës; te dëshira e vogëlushit për ta ndaluar shiun në dimër e për ta "kaluar" në stinën e verës; te vjersha ku dëshiron ta mbyllë erën në shishe që me të, të ndihmojë fshesarët për të fshirë rrugët dhe në sa e sa të tjera?

Pra, Laholli është poet që në radhë të parë i këndon njeriut, nëpërmjet natyrës. Pas zogut, erës, plepit, lumit, detit, shiut, pyllit etj., me siguri te vjershat e tij do të ndeshësh njeriun-vogëlush me dëshirat e ëndërrat e tij, gjithmonë të para me syrin e fëmijëve.

Kjo është një arritje e autorit, prandaj, me të drejtë, në krye të këtyre radhëve kemi shënuar fjalët e zakonshme por shumë kuptimplote, të shkruara me shkronja kapitale: **MIRË SE ERDHE!**

E meriton Ferdinand Laholli një urim të tillë, e meritojnë vjershat e tij këtë urim që del nga zemra!

TIRANË, 11 MAJ 1994

NJË KËNGË QË U PRE NË MES

Në radhët e shkrimtarëve që hynë në letërsinë tonë për fëmijë, në fund të viteve '40 e në fillim të viteve '50, zë një vend të nderuar edhe shkrimtari Bekim Gaçe, autor i shumë librave në prozë, por edhe në poezi, të cilat i dhanë emër dhe u pritën me interes nga studiuesit, kritikët dhe lexuesit e vegjël e të mëdhenj.

Shkrimtari Bekim Gaçe ka lindur në qytetin e Përmetit, në vitin 1931, në një familje me tradita atdhetare, arsimore e kulturore. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes (shkollën shtatëvjeçare), ndërsa të mesmen në gjimnazin e Shkodrës, si konviktor. Në Tiranë vazhdoi Fakultetin Histori-Filologji (ish - Instituti i Lartë Pedagogjik) dhe u diplomua për gjuhë e letërsi shqipe.

Me mbarimin e studimeve të larta, një kohë punoi drejtor i Pallatit të Pionierit në Tiranë (sot Qendra Kulturore e Fëmijëve) e më pas kryeredaktor i revistës "Fatosi". Në fund të viteve '60 kaloi kryeredaktor i revistës "Pionieri" (sot "Filizat"). Në këto dy revista shkrimtari Bekim Gaçe jo vetëm drejtoi, por edhe botoi një pjesë të krijimtarisë së vet dhe grumbulloi rreth tyre gjithë krijuesit më të mirë nga letërsia për fëmijë e nga letërsia për të rriturit, dhe kështu dha një ndihmesë të vyer në zhvillimin e përparimin e

letërsisë sonë për të vegjëlit, por edhe të publicistikës për ta, pasi revistat, veç krijimtarisë letrare, botonin edhe përshkrime, reportazhe, kronika, skica, lajme, reçensa, etj.

Në fillimin e vitit 1974 shkrimtarin Bekim Gaçe e përfshiu lufta e klasave dhe për gjashtë vjet rresht u internua e punoi si punëtor i thjeshtë krahu, në punët më të vështira, në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit. Po kështu u hoqën nga qarkullimi të gjithë librat që kishte botuar dhe iu hoq edhe e drejta e botimit të librave të rinj që shkruante ndërkohë.

Nuk mjaftuan vuajtjet e internimit, por në vitin 1980, shkrimtari Bekim Gaçe ndërroi jetë në një aksident automobilistik, duke e ndërprerë krijimtarinë e tij kur ishte në vllugun e punës e do t'u kishte dhuruar lexuesve të vegjël edhe shumë libra të tjerë...

Bekim Gaçe me krijimtari nisi të merret që kur ishte në bankat e shkollës së mesme, në Shkodër, dhe vjershat e tregimet e para i botoi në gazetën "Pionieri", në "Rinia" (sot "Zëri i Rinisë"), "Letrari i ri" etj. Këtë bashkëpunim që e filloi në fund të viteve '40, e vazhdoi për më shumë se tridhjetë vjetë dhe emrin e tij do ta gjesh në periodikun letrar e publicistik nga viti 1949 e gjer në vitin 1974, pa ndërprerje. Pas vitit 1974 diktatura ia hoqi të drejtën e botimit gjersa vdiq.

Librin e parë për fëmijët autori e botoi në vitin 1963. Ai mbante titullin "Teuta, kukulla, shoferi" (poemë). Më pas botoi edhe disa libra të tjerë poetikë, si "Arushat ngrenë një shtëpi" (poemë-përrallë, 1968), "Zilja e saj na fton" (vjersha, 1970).

Pas vitit 1970 autori u muar kryesisht me prozën për fëmijët dhe botoi disa libra, si "Shtëpiza fluturuese" (përralla, 1970), "Përrallat e pyllit" (1972), "Gruaja me këmbë të madhe" (tregime, 1972).

Shkrimtari bëri sprova edhe në fushën e romanit e na dha një vepër me vlera, e cila u nderua edhe me çmim në Konkursin Kombëtar, me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, në vitin 1974. Romani mbante titullin: "Ju jeni partizanë". Ky roman për

vlerat që ka është përkthyer edhe në rusisht, në mezin e viteve '70.

Bekim Gaçe ka dhënë ndihmesën e vet edhe në fushën e kritikës e të studimeve letrare për letërsinë për fëmijë, si për vepra të veçanta ashtu edhe për probleme dhe zhvillime të kësaj letërsie, të cilat janë botuar në gazeta e revista të ndryshme, si “Zëri i Rinisë”, “Drita”, “Nëntori” etj. Po kështu në gazeta e revista të ndryshme (veçanërisht në “Pionieri” dhe “Fatosi”), ka botuar edhe shkrime publicistike, si reportazhe, përshkrime, skica, portrete etj.

Jashtë interesave të tij krijuese nuk ka mbetur edhe drama e pjesët teatrale për fëmijët. Kështu, në vitin 1976 ai botoi përmbledhjen me skeçe “Shokët”, një nga botimet e para në këtë fushë në letërsinë tonë për fëmijë, e më vonë shumë pjesë teatrale për kukullat e drama po për fëmijët, si “Këmisha e shkruar”, “Shtëpia që fluturon” etj., të botuara në buletin “Bota e fëmijëve”.

Pas vdekjes, me interesimin e familjes së vet, një pjesë e krijimtarisë së tij në fushën e tregimit për fëmijë u përmbloodh dhe u botua në një vëllim më vete, nën titullin “Një ditë shtatori” (1982).

Shkrimtari Bekim Gaçe ka lënë në dorëshkrim edhe disa vepra të tjera, si një përmbledhje me përralla dhe gjashtë novela.

Duke studiuar dhe njohur krijimtarinë e shkrimtarëve tanë të Rilindjes Kombëtare dhe vlerat e tyre atdhetare, edukative, letrare e njohëse, Bekim Gaçe zgjodhi e botoi më vete pjesë të krijimtarisë së Naim Frashërit dhe Andon Zako Çajupit, duke i pajisur me parathënie, fjalor, aparat shënimesh, etj., duke dhënë kështu një ndihmesë të vyer për shkollën tonë e për lexuesin e vogël në përgjithësi.

Kjo është në vija të përgjithëshme jeta dhe krijimtaria e shkrimtarit Bekim Gaçe, duke mos pretenduar së i thamë të gjitha. Me këtë krijimtari të gjerë dhe me vlera, duke bërë zgjedhje që i përgjigjen edhe kohës në të cilën jetojmë, mund të ribotohen e botohen si libra ashtu dhe dorëshkrime, se ato ruajnë vlera letrare dhe edukative.

Duke u nisur nga kjo vlerë, me interesimin e familjes së tij, dhe veçanërisht të së shoqes, zonjës Manushaqe Gaçe (Veçani), që u mbështet me zemër nga shoku dhe miku i tij, zoti Fatmir Toçi, drejtor i Shtëpisë botuese "Toena", unë mora përsipër të zgjedh krijime nga më të spikaturat e shkrimtarit Bekim Gaçe dhe në përmbledhjen që kemi në dorë "Shtëpiza fluturuese", përfshiva përrallat, tregimet e një novelë, si një obligim ndaj shokut e kolegut tim, të cilin e kujtoj me nderim.

Nga shkrimtari Bekim Gaçe, në të ardhmen mendoj se mund të botohen edhe zgjedhje të tjera, si nga vjershat e poemat, ashtu edhe nga novelat që ka lënë në dorëshkrim dhe romani "Ju jeni partizanë".

Nga dora e fatit, para të cilit jemi të pafuqishëm, dhe nga dora e diktaturës, kënga që këndoi Bekim Gaçe u pre në mes, në një kohë që ai lulëzonte në moshë e në krijimtari.

TIRANË, KORRIK 1996

DUKE KËRKUAR HORIZONTE TË REJA POETIKE

Duke qenë se për një kohë të gjatë kam punuar si redaktor e shef në Redaksinë e letërsisë për fëmijë, në Shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, dhe pata fatin të merrem për më se dy dekada me botimin e veprave për fëmijë, të shkrimtarëve që jetojnë e punojnë në trojet e veta në Kosovë e gjetkë, një ndër autorët që më tërhoqi vëmendjen qysh kur lexova krijimet e tij të para, ishte edhe poeti Ali Huruglica. Ai ka lindur në vitin 1930, shkollën fillore e disa klasë të shkollës së mesme i kreu në Gjilan e pastaj, për 24 vjet, punoi mësues në fshatin Ramjan. Gjatë kësaj kohe kreu edhe shkollën normale dhe shkollën e lartë pedagogjike, në degën e gjuhës e të letërsisë shqipe në Prishtinë. Më tej, për një vit punoi në revistat për fëmijë që dalin në Shkup (“Fatosi” e “Gëzimi”) dhe përsëri u kthye në Gjilan ku drejtoi Biblotekën e qytetit, gjersa u pensionua. Vjershën e parë e botoi në vitin 1956, në revistën “Pionieri” të Prishtinës, e prej atëherë gjer më sot emrin e tij e gjen jo vetëm në periodikun letrar për më shumë se 25 vjet, por edhe në ballinat e shumë librave për fëmijë, në veprat që shkroi në poezi e në prozë.

Në fillim të viteve ‘70, u përpoqa ta bëj të njohur edhe te lexuesit tanë të vegjël, duke i botuar vjersha të veçanta ose tufa

me vjersha, në revistat për fëmijë që dilnin në Tiranë. si "Pionieri" (sot "Filizat") "Fatosi", "Yllkat" (sot "Vogëlushët") e gjetkë, që ta lexonin e shijonin edhe fëmijët në dheun amë. ashtu siç e lexonin edhe në prishtinë, Shkup e më gjerë. Si botuesit e revistave ashtu edhe lexuesit i pritën me interes krijimet e poetit dhe veçanërisht poezinë e shkurtër "Ç'ka fshin goma?", një vjershë kjo me vlera antologjike, me bashkautor poetin e njohur Fejzi Bojku, nga Veleshta e Strugës. Vjershat e tij u pëlqyen shumë dhe u ribotuan disa herë nëpër revista dhe në përmbledhje me vjersha të shumë autorëve nga Prishtina e Shkupi, si "Me xhakëtën kuqezi", "Vendlindja ime", "Gishti ngjyrëvjollcë" etj.

Më vonë, nëpërmjet poetëve tanë të njohur për fëmijë si Vehbi Kikaj, Rifat Kukaj e Xhevat Beqaraj, (i cili pati fatin ta takonte në Kosovë), mësova edhe më shumë për jetën dhe krijimtarinë e poetit dhe më ranë në dorë disa libra të tij, si "Zani i zamerës", "Ylli më ka tregue", "Këngët e plakut me lahutë", "Shkurtabiqi zemërtarë", etj. Veçanërisht më lanë mbresë ato që më tregoi shoku e miku im, Xhevati, për Aliun, të cilin natyra i kishte dhënë mirësi e talent, por jo shëndet.

Duke lexuar e rilexuar përmbledhjet që kishte botuar gjer nga mezi i viteve '80 (ndofta jo të gjitha, se nuk kisha ku i siguroja), ju vura punës dhe zgjedha krijimet më të mira të tij, natyrisht duke lënë jashtë ndonjë poezi të mirë e duke bërë ndonjë redaktim apo shkurtim që i kërkonte koha me kërkesat absurde që bënte... Të më fali Aliu, ashtu si edhe krijuesit e tjerë nga Kosova, të cilëve u botova vjersha e libra, nëse padashur u kam prekur vlerat disa krijimeve të tyre. Vetëm një njeri që ka punuar redaktor në ato vite, dhe që është marrë me botimin e librave të autorëve shqiptarë nga Prishtina e Shkupi mund ta kuptojë sa vështirë e kishim t'i ribotonim krijimet e tyre, ashtu siç ishin në origjinal... Mjafton të përmend faktin se një herë, për shprehjen "e ashtuquajtura Serbi Jugore", vënë në krye të poezisë së poetit Esad Mekuli, nga autori

vetë, na u desh të djersitim për një muaj nepër mbledhje dhe një zot e di si shpëtuam pa shkuar me gjithë familje në Shpat apo në Zavalinë të Elbasanit. Dhe kur pa? Atëherë kur sapo isha kthyer nga deportimi pesëvjeçar në Elbasan, për shprehjen “digjet ylli”, pë të cilën u akuzova se “kisha djegur simbolin e komunizmit!” dhe më ishte hequr e drejta e botimit për dy vjet.

Kështu lindi e u formua në duart e mia përmbledhja me vjersha “Dreri me yll në ballë” (1988) e poetit Ali Huruglica, një botim luksi për ne në atë kohë, me një ballinë për ta patur zili, të piktorit të mirënjohur Gëzim Tafa. Libri u botua në dymijë kopje dhe brenda kishte disa të dhëna shkurt për jetën e veprën e autorit. Libri u përpi nga lexuesit e vegjël në një kohë rekord (sipas statistikave të N.T.SH. Librit, brenda tre muajsh) edhe pse çmimin nuk e kishte dhe aq të vogël për fuqinë blerëse të lexuesve tanë fëmijë.

“Dreri me yll në ballë” fluturoi nga vitrinat e librarive në duart e në bibliotekat e të vegjëlve dhe hyri në mendjet e në zemrat e tyre, pasi kishte vlera të mirëfillta atdhetare e letrare, pasi në të rrihte një zemër poeti e kishte art, kishte ndjenjë, fantazi e bukuri mahnitëse.

Me tematikë të larme e frymëzuese, me gjetje të bukura e befasuese, me figuracion të pasur e domethënës, me varg plot mendim, me njohje të botës, gjuhës e psikologjisë feminare dhe me muzikalitetin që duket sikur të nanurit, Ali Huruglica vinte me zërin e vet te lexuesit tanë të vegjël e të mëdhenj në dheun amë, ashtu siç erdhën para tij edhe poetët Rexhep Hoxha, Vehbi Kikaj, Rifat Kukaj, Agim Deva, Gani Xhafolli e shumë të tjerë para e pas tij.

Kohët e fundit lexova përmbledhjen e re me vjersha e poema (në dorëshkrim) të poetit Ali Huruglica, e cila ka një titull të gjetur e intrigues: “Jastëku i ëndrrave”. Kjo është një përmbledhje e gjerë, ndofta m e gjera ndër ato që ka botuar poeti, me rreth tridhjetë vjersha dhe rreth njëzet poemtha e poema.

Qysh në leximin e parë vë re se në këtë libër, edhe pse krijimet janë shkruar disa vite më parë, ka prurje të reja tematike, me gjetje

të bukura artistike e me një arsenal të pasur figurash letrare që të befasojnë dhe me një bagazh të madh njohurish nga vendlindja e poetit, Gjyryshevci e Kosova, aq sa nuk i gjen dot as në dhjetra libra të leximeve letrare e të librave historikë. Kjo tregon mirëfilli se grafiku i krijimtarisë së poetit Ali Huruglica është në ngjitje e në kërkim të horizonteve të reja, më të mëdha e më të gjera.

Ekskursioni i tij tematik në të katër anët e vendlindjes e në trevat e tjera shqiptare, në këtë anë e në atë anë të kufirit shtetëror, rrugëtimi në historinë e sotme e të kaluar, prekja me dorë e “operacioni” në plagët e majisura shoqërore, ekonomike e politike të Shqipërisë e veçanërisht të Kosovës, himnizimi i bukurive e vetive më të mira të vendit e të popullit tonë, krenaria për traditën e për të përditshmen, kënga e kënduar me tone lirike, por edhe heroike, ia zgjerojnë frymmarrjen poezisë që ka krijuar gjer më sot Ali Huruglica dhe e bëjnë këngëtar tribun.

Të gjitha këto shpjegohen edhe me gërshetimin që i bën autori poezisë për fëmijët me poezinë për të rriturit, me gërshetimin që u bën këngëve popullore me krijimtarinë poetike bashkëkohore, si nga letërsia jonë ashtu edhe nga letërsia botërore, të cilën poeti e njih mirë. Kështu poezia e tij në këtë përmbledhje, ndryshe nga përmbledhjet që ka botuar më parë, një këmbë e ka te fëmijëria e një këmbë te adoleshenca. Këtë e vë re mirë sidomos te poemthat e poemat e veta.

Ngjizja e të gjithë këtyre elementëve letrarë, tematikë etj., të dhënat me gjuhën e lexuesve të vegjël, i ka dhënë poezisë së Ali Huruglicës origjinalitet e bukuri, të shprehura me art, në vargje që rrjedhin si muzikë dhe i bëjnë për vete fëmijët.

Këto pak rrjeshta, që hapin librin e tij të ri “Jastëku i ëndrrave”, vijnë si një homazh, pak kohë pas botimit të librit, si një peng kujtimi e vlerësimi për autorin, i cili u nda nga ne në fillim të këtij viti.(1997)

TIRANË, GUSHT 1996-1997

KËSHTU DO TA KEMI MË PRANË

“Shumë të dashur lexues të vegjël,

ende nuk ka kaluar as një vit që jam ndarë nga ju dhe e ndjej se më ka marrë malli shumë për të gjithë, prandaj me anën e kësaj letre, të shkruar nga bota tjetër ku kam gjetur prehje e qetësi, vij e ju sjell të falat e përqafimet e mia duke iu lutur Zotit që të jeni shëndoshë e mirë dhe të jeni të shkëlqyer në mësimet e në sjellje. Është shumë e vështirë për mua që nuk ju shoh, që nuk ju dëgjoj dhe që nuk jetoj më gëzimet, ëndrrat dhe shqetësimet tuaja, se ato kanë qenë qëllimi kryesor i jetës sime, për shumë dekada.

Dhe tani, në prag të njëvjetorit të ikjes e të ndarjes nga ju, bashkë me letrën, nëpërmjet shokut, mikut e vëllait tim, shkrimtarit Odhise Grillo, vij t’ju sjell edhe një libër të ri që mban titullin “I kujt është dielli?” Në të janë përmbledhur vjershat e poemat e mia më të mira. Dëshira ime e zjarrtë është: t’i lexoni e t’i keni në bibliotekat tuaja, bashkë me librat e tjerë të cilët i kam botuar për ju, që jeni e ardhmja e Shqipërisë. Se unë kam botuar për fëmijët pesëmbëdhjetë libra në gjuhën shqipe dhe tre libra në gjuhën italiane, në poezi e në prozë. Pa kam botuar edhe dhjetë libra të tjerë për mësuesit tuaj, që ju mësojnë e ju edukojnë dhe që ju me

siguri i doni njëlloj si prindërit tuaj.

Kur të mbani librin në duar, unë do të jem pranë jush, edhe pse nuk do të më shihni e nuk do të më dëgjoni. Dhe do të gëzoj bashkë me ju.

U bëfshi të mirë, të ditur e të bukur dhe qofshi të lumtur!
Ngado që të shkoni t' u bëhet rruga diell!

Jua dua siç desha fëmijët e mi, si Arditën e Gencin.

BEKIM HARXHI,
SHKRIMTAR "MËSUES I POPULLIT"

* * *

Shkrimtari Bekim Harxhi ka lindur në viti 1934, në Gjirokastrë, në një familje me tradita atdhetare, kulturore e artistike. Babai i tij Ramiz Harxhi, ka qenë atdhetar i njohur dhe poet demokrat, pasues i Nolit të madh.

Mësimet e para dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta në Universitetin e Tiranës, për gjuhë e letërsi shqipe. Pas mbarimit të studimeve ka punuar për katër dekada mësues i letërsisë në shkollat e mesme të qytetit të lindjes dhe në Universitetin "Eqerem Çabej".

Krijimtarinë letrare e nisi qysh në shkollën e mesme, me bashkëmoshatarët Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Agim Shehu etj., ndërsa krijimet e para i botoi në "Letrari i Ri", "Zëri i Rinisë", "Pionieri" (sot "Filizat"), "Fatosi", më pastaj në "Drita", "Nëntori" etj. Vitet e fundit u bë edhe bashkëpunëtor i ngushtë i "Rilindjes për fëmijët".

Librin e parë shkrimtari e botoi në vitin 1968. Ai mbante titullin "Gurgdhëndësi i vogël" (tregime). Më vonë botoi shumë libra në prozë e në poezi, të cilët u pritën shumë mirë nga lexuesit e vegjël e të mëdhenj, nga kritika e nga opinioni ynë letrar.

Një vit më parë Shoqata e mjekëve humanitarë “Tolba”, i botoi tre libra në italisht, një në poezi dhe dy në prozë: “Tri vjersha për të qeshur”, “Arushi i vogël dhe historitë e pyllit” dhe “Laraska pispilluqe”.

Botimi i këtyre librave tregon se ne kemi shumë vepra me nivel artistik për fëmijët, të cilët mund të botohen kudo në botë e të na nderojnë, ashtu siç nderuan të paharruarin Bekim Harxhi, i cili u nda nga ne më 1994, në moshën gjashtëdhjetëvjeçare, në një kohë që mund të jepte edhe më shumë edhe më mirë në fushën e letërsisë për fëmijë.

Bekim Harxhi ishte njeri i mirë, i dashur dhe i drejtë. Në jetën e vet bëri shumë miq e shokë, e në radhë të parë ju lexues të vegjël. Ai e kishte zemrën të gjerë sa deti e oqeani. Bekimi ishte më i mirë, më i drejtë e më i dashur nga sa mund të mendohet! Bekimi ishte mirësia vetë!

Bekimi ishte edhe mësues e pedagog i shkëlqyer. Ai nuk u mësoi nxënësve e studentëve vetëm letërsinë. Në radhë të parë u futi në shpirt dashurinë për atdheun e njerëzit, për gjithçka të mirë e të bukur që ka vendi ynë dhe bota. Prandaj edhe Bekimin e bënë “Mësues të Popullit”.

Bekimi ishte poet i talentuar e prozator i zoti. Ai mund të ishte bërë një shkrimtar i njohur për të rriturit, por zgjodhi rrugën e letërsisë për fëmijë, se ajo e çonte te të vegjëlit që i kishte në zemër, se ajo e çonte tek e ardhmja e Shqipërisë.

Si njeri, si mësues e si shkrimtar ai ndoqi rrugën e të mëdhenjve Leon Tolstoi e Naim Frashëri, prandaj nxori nga dora, nga shpirti e nga mendja e vet krijime të bukura për të vegjëlit. Se ishte një mik i madh i fëmijëve!

Bekimi gjithçka pati e dha për vendin e vet, si njeri, si mësues e si shkrimtar dhe iku duke mos kërkuar asgjë për vete, prandaj mbi varr do t'i shkante epitafi: *“Besoj në gjithçka të mirë,/ shpresoj në gjithçka të bukur,/ shkoj i lumtur”*

Ikja e Bekim Harxhit na hidhëroi pa masë e për të na dhëmbi në shpirt të gjithëve, të vegjëlve e të mëdhenjve. Në sofrën e përbashkët të letërsisë për fëmijët na mbeti një vend bosh. E në zemër na ka mbetur një boshllëk që s'do të mbushet kurrë.

Le ta shuajmë pak mallin për të duke shfletuar këtë kopsht poetik që mban titullin *"I kujt është dielli?"* Shkrimtari do të ngazëllet kur të dëgjojë fëshfëritjen e fletëve të librit në duart e lexuesve të vegjël e të mëdhenj. Kështu do ta kemi më pranë!

TIRANË, 1995

NJË MJESHTËR I POEZISË HUMORISTIKE PËR FËMIJË

Një ndër poetët më të njohur në fushën e poezisë për fëmijë në vendin tonë, por edhe më gjerë: në Kosovë, te shqiptarët e ish-Maqedonisë e të Malit të Zi dhe kudo që jetojnë e punojnë shqiptarët, është edhe Tasim Gjokutaj. Ai ze një vend të merituar në lëvrimin e poezisë në përgjithësi e veçanërisht në lëvrimin e poezisë e të poemës humoristike, të përrallave në vargje e të poemave. Të njëzet e dy librat që ka botuar në këtë fushë e renditin atë në radhët e para të krijuesve tanë për lexuesit e vegjël dhe një ndër poetët humoristë më të shquar në letërsinë tonë për fëmijë. Sidomos ai është një mjeshtër i poezisë dhe i poemës humoristike.

Tasimi ka lindur në Kuç të Kurveleshit (rrethi i Vlorës) më 2 prill 1944 në një familje me tradita atdhetare, kulturore e arsimore. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje ndërsa ciklin e lartë të shkollës shtatëvjeçare dhe të mesmen i ka vazhduar në Gjirokastrë. Po këtu është diplomuar për gjuhë e letërsi shqipe në Institutin e Lartë Pedagogjik (sot Universiteti "Eqerem Çabej").

Për pak kohë Tasim Gjokutaj ka punuar mësues në shkollat tetëvjeçare të rrethit të Gjirokastrës, si në Libohovë e gjetkë, ku veç punës plot pasion në mësimin e edukimin e brezit të ri, dha

ndihmesë edhe në zhvillimin e talenteve të reja në fushën e letërsisë. Veçanërisht një punë të madhe ka bërë ky autor gjatë viteve që punoi dhe drejtoi bibliotekën e fëmijëve në ish-Shtëpinë e Pionierit (sot Qendra Kulturore e Fëmijëve) në qytetin e Gjirokastrës. Me punën e tij shembullore Tasim Gjokutaj jo vetëm u futi në shpirt fëmijëve dashurinë për librin e dëshirën për lexim por dha ndihmesë edhe për lulëzimin e shumë talenteve të reja. Kanë mbetur të paharruara veprimtaritë e ndryshme që organizonte Tasimi për paraqitjen e autorëve e të veprave të tyre te fëmijët, për takimet me shkrimtarët, për konkurset e ndryshme dhe për sa e sa veprimtari të tjera të larmishme, me vlera e të frytëshme.

Me krijimtari ka nisur të merret qysh kur ishte nxënës dhe krijimet e para i ka botuar në revistat për fëmijë si “Fatosi”, “Pionieri” (sot “Filizat”), “Yllkat” (sot “Vogëlushet”), ku vuri gurë themeli. Po kështu shumë krijime të tij janë botuar edhe në gazetat e revistat e fëmijëve në Prishtinë, Shkup, Tetovë, Ulqin e gjetkë, si te “Pionieri”, “Rilindja për fëmijët”, “Gëzimi”, “Fatosi”, “Gazeta e pionierëve”, “Nxënësi” etj.

Librin e tij të parë, të titulluar *“Do ndërtojmë hidrocentral”* (përrallë në vargje), e botoi në vitin 1969. Më pas botoi edhe këta libra poetikë: *“Buzëqesh Mentori”* (vjersha, 1972), *“Dhelpra dhe Baloshi”* (përrallë në vargje, 1973), *“Keci që s’bëri detyrat”* (përrallë në vargje, 1975), *“Dita e parë”*, (vjersha, 1976), *“Kush e hëngri akulloren?”* (përrallë në vargje 1977), *“Bleta lulet i ka xhan”* (vjersha, 1977), *“Familja dhe hekurudha”* (vjersha, 1997) *“Në fshatin tonë malor”* (vjersha, 1977), *“A e dini ç’tha Artani?”* (vjersha, 1977), *“Qajnë sorrat në një ferrë”* (vjersha, 1978), *“Luftë me aspirina”* (poemë, 1979), *“Keci me katër këpucë”* (përrallë në vargje, 1980), *“Derrkuci që bëri dush”* (përrallë në vargje, 1981), *“Bisedë me një dallëndyshe”* (vjersha, 1983) *“Bisedë me mbesën”* (poema, 1983), *“Ç’ëndrra thurin kalamajtë...”* (poemë, 1984), *“Alo, të vijë mamaja”* (poemë, 1985), *“Obobo, i ziu ç’bëra”*

(përrallë në vargje, 1988), *"Vët kopan!"* (përrallë në vargje, 1990) *"S`duron iriqi një gjilpërë"* (vjersha, 1990) dhe *"Ku ta gjejë daullen gjyshi?"* (vjersha dhe përralla në vargje, 1995).

Tasim Gjokutaj është marrë edhe me skenën e fëmijëve e ndonjëherë edhe me të të rriturve, duke shkruar edhe dialogë, skeçe, pjesë për kukulla etj., shumë prej të cilave janë publikuar nëpër buletinet që botoheshin në ndihmë të estradave ose janë vënë në skenë në teatrot e kukullave në Tiranë, Gjirokastrë e gjetkë. Estrada profesioniste e qytetit të Gjirokastrës i ka vënë në skenë edhe ndonjë libret të plotë me krijime skenike për shikuesit e vegjël, ku ka zotëruar humori që autori e ka aq për zemër.

Disa herë Tasim Gjokutaj ka shkruar edhe recënza, kritika e studime për letërsinë për fëmijë në përgjithësi, për gjini e lloje të veçanta, dhe për libra të autorëve të ndryshëm. Në sesionet shkencore e në simpoziumet e organizuara nga ish-Komisioni i letërsisë për fëmijë, pranë Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, ka mbajtur kumtesa me interes për poezinë për fëmijë, për poemën etj.

Prej vitesh punon pedagog i folklorit dhe i letërsisë për fëmijë në Univesitetin e Gjirokastrës. Fryt i kësaj pune janë edhe disa studime, mes të cilave shquhet monografia *"Lirika e dasmës tradicionale Gjirokastrite"* (1996) ku në 243 faqe, mbështetur në një material të bollshëm faktik, bën analiza të shumanëshme për këngët lirike që shoqërojnë dasmat në rrethin e Gjirokastrës. Me këtë studim autori ka mbrojtur titullin Doktor i Shkencave Filologjike.

Këtë vit Tasim Gjokutaj botoi edhe një tekst të letërsisë për fëmijë, për pedagogët që japin këtë lëndë në Univesitetet e vendit tonë. Kjo është një ndihmesë e madhe për të gjithë ata që merren me letërsinë, për studjuesit e krijuesit, për mësuesit e letërsisë në shkollën tetëvjeçare e më gjërë.

Në të gjithë krijimtarinë e tij për fëmijë Tasim Gjokutaj është shquar për ndërtimin e fabulave interesante, për kapjen e trajtimin

e temave ne mënyrë intriguese e me të papritura të këndshme, gjë që u pëlqen shumë lexuesve të vegjël; për mbështetjen e fuqishme në gurrën popullore të trevave të Jugut e veçanërisht të krahinës së Kurveleshit, për vargun e tij melodioz, për humorin e hollë e për batutat e goditura që shpesh i bëjnë fëmijët të venë buzën në gaz apo të kruajnë kokën, në rast se e kanë mizën në kësulë... (siç thotë populli), për komunikimin lirshëm e me njohje të botës, gjuhës e psikologjisë femënore, për bashkëbisedimin e ngrohtë me lexuesit e vegjël e për shumë cilësi të tjera, të cilat e bëjnë autorin ndër krijuesit më të dashur në këtë fushë.

TIRANË, MAJ 1997

KUR ZË VEND TË NDERUAR NË BIBLIOTEKË...

Ju, të dashur lexues të vegjël, e njihni mirë shkrimtarin Qamil Batalli, pasi herëpashere, në revistat tuaja “Fatosi” e “Pionieri” janë botuar skica, tregime e përralla të tij, si: “Do të vdisja për Skënderbeun”, “Letra e vlefshme” etj. Veç kësaj ju e njihni edhe nga vëllimet me skica, tregime e përralla të zgjedhura që janë botuar disa vjet më parë te ne dhe që mbajnë titujt e bukur “Pupëza” dhe “Dallëndyshja e parë”.

Shkrimtari Qamil Batalli ka lindur në Prishtinë të Kosovës më 1936. Ka mbaruar Fakultetin e Gjuhës e të Letërsisë në Universitetin e Prishtinës dhe ka punuar në Radio-Prishtina, në revistën “Pionieri”, në redaksinë e letërsisë për fëmijë të “Rilindjes”, dhe në revistën “Shkëndia”, e cila merret me problemet e shkollës.

Tregimin e parë për fëmijët e ka botuar në vitin 1955, ndërsa vëllimin e parë, i cili titullohet “Buzëqeshjet”, në vitin 1966. Ai është autor i shumë përmbledhjeve me skica, tregime e përralla dhe një nga shkrimtarët më të talentuar e më prodhimtarë në letërsinë për fëmijë në Kosovë. Të shkrimtarit Qamil Batalli janë përmbledhjet me skica, tregime e përralla “Buzëqeshjet”,

“Dëshirë”, “Dyzet tregime”, “Tri dritaret”, “Njomëzat”, “Tregime të zgjedhura për fëmijët”, “Mësuesja dallëndyshe”, “Ditari i kaltër” etj., si dhe vëllimi me vjersha “Pëllumbat e mi”. Ai është autor i romaneve-përrallë “Princesha e bariu” dhe “Agimet e kaltra”, që kanë në qendër personazhe e ngjarje të frymëzuara nga përrallat tona popullore.

Tani ju po merrni në dorë një vëllim tjetër të këtij autori, ku është përmbledhur një pjesë e krijimtarisë së tij me skica, tregime dhe përralla, të vjela nga vëllimet e shumta që ka botuar. Ai mban titullin domethënës “Do të vdisja për Skënderbeun”.

Pasi e mbaron së lexuari këtë vëllim, ndien një kënaqësi të veçantë jo vetëm se autori shkruan bukur dhe i ndërton skicat e tregimet e veta si përrallat që ka krijuar populli, por në radhë të parë, se ato kanë vlera të mirëfillta artistike, përmbajtje të shëndoshë, tematikë të larme e të gjerë dhe vlera njohëse e edukative të rëndësishme. Nëpërmjet këtyre krijimeve shkrimtari kërkon të edukojë të të vegjëlit veti nga më të vlefshmet për vete, për familjen, për shokët dhe për popullin e tyre.

Në këtë vëllim dhe në gjithë krijimtarinë e shkrimtarit Qamil Batalli, një kapitull më vete përbëjnë tregimet me temën e atdhedashurisë, që e marrin lëndën nga e kaluara e largët dhe heroike e popullit tonë, në rrjedhën e shekujve. Në këto tregime autori nënvizon disa nga cilësitë kryesore të popullit tonë, si: besën, trimërinë, burrërinë dhe shpirtin liridashës të shqiptarëve. I tillë është, p.sh., tregimi “Do të vdisja për Skënderbeun”, në të cilin autori na sjell në mendje figurën e ndritur të Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Hero i tregimit është një fëmijë, Fatosi i vogël, i cili në një lojë plagoset për të mbrojtur Skënderbeun dhe gjithë krenari i thotë nënës së vet se nuk do t’i dhimbsej as jeta po të vdiste për Skënderbeun. Në këtë tregim, ashtu si edhe në shumë të tjerë me këtë temë, ndihet krenaria kombëtare për vendin tonë që nxorri të tillë heronj, të cilët luftuan jo vetëm për lirinë e popullit të tyre,

por edhe të popujve të tjerë. Qëllimi i autorit këtu është i dyfishtë: fëmijët jo vetëm të krenohen me të parët e tyre trima, por edhe të ndjekin rrugën e tyre në jetë e të veprojnë posi ata, kur të ketë nevojë atdheu.

Një vend me rëndësi në krijimtarinë e Qamil Batallit, zënë edhe tregimet e skicat që sjellin ngjarje nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare që bëri populli i Kosovës kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhëtarëve të vendit. Në këtë luftë një ndihmesë të madhe e të gjithanshme dhanë edhe fëmijët kosovarë. I tillë është Azemi, heroi i tregimit “Duke mbledhur manushaqe”, i cili, duke qenë vigjilent e duke i vlojtur ndjenjat atdhetare në zemër, ndihmon partizanët për të kapur dy armiq që fshiheshin, duke përdorur një lojë djallëzore: ata maskonin radiomarrësen, duke vendosur mbi antenë një sorrë të ballsamosur, e cila i mbante krahët të hapur e dukej sikur fluturonte. Po dredhia e armiqve dështon, sepse Azemi kishte sy si të shqiponjës, se edhe ai vetë ishte shqiponjë e nga vendi i shqiponjave. Me këtë temë janë dhe tregimet “Vizatimi i Lurandit”, ku autori përpiqet t’u ngulitë në mendje e në zemër fëmijëve dashurinë e respektin për invalidët e luftës e të punës dhe “Letra e vlefshme”, në të cilin tregohet si ua hedhin armiqve dy barinj që çonin një letër në shtabin partizan. Si këto Qamil Batalli ka edhe tregime e skica të tjera.

Në këto tregime, autori mundohet të hyjë në botën e brendshme të të vegjëlve dhe ta shpalosë atë para lexuesit sa më mirë e sa më të plotë, duke vënë në dukje zgjuarsinë e mprehtësinë e heronjve. Nëpërmjet ngjarjesh të gjetura bukur e kuptimplote, autori tregon sa të qetë qëndronin fëmijët e sa mirë manovronin edhe në çastet më të vështira, duke nxjerrë njëkohësisht në pah forcën e idealit që mbronin, pasi ata luftonin për lirinë e popullit të tyre.

Populli ynë është jo vetëm trim e luftëtar, që ka luftuar në shekuj për liri e drejtësi, jo vetëm punëtor e i talentuar, por edhe i ditur e i zgjuar. Ai nuk e ka ndarë kurrë librin nga kazma, nga

shpata e pushka, prandaj edhe ka dalë fitimtar në sa e sa rrebeshe që i janë kanosur nëpër shekuj. Ai ka një dashuri e respekt të veçantë për shkollën, dijen e kulturën. Kjo del mirë e qartë në tregimin “Shtëpia e falur” si dhe në krijime të tjera, ku në qendër është vënë figura e babait të Fatbardhit, i cili, kur sheh se fëmijët e kanë larg shkollën, i fal fshatit dhomën e vetme që ka dhe atë e kthejnë në klasë mësimi për vocërrakët. Me temën e luftës së popullit tonë për gjuhë e kulturë ka edhe skica e tregime të tjera. Në këto krijime autori nënvizon me të madhe se gjuhën shqipe duhet ta duam e ta ruajmë si sytë e ballit, se ajo është një ndër shenjat që na dallon ne si komb dhe që për të është derdhur shumë djersë e gjak.

Fëmijët nuk edukohen vetëm në shkollë, por edhe në familje e në shoqëri. Këtë fakt autori është munduar ta shfrytëzojë e ta shtrojë në shumë krijime të tij. Këtu edukatorë janë jo vetëm gjyshet e gjyshët, babai e nëna, më të rriturit etj., por edhe vetë të vegjëlët për njëri-tjetrin. Në familje pajisen me disa nga vetitë më të mira që ka populli ynë: të respektojnë dhe të ndihmojnë të moshuarit e më të vegjëlët, të jenë të ndershëm e punëtorë, të jenë kurdoherë të bashkuar, ta duan shoku-shokun e fqinjën, t’i ndihmojnë ata ashtu si do të ndihmonin njerëzit e tyre, të punojnë në shtëpi e kudo krahas të rriturve, ta kenë zemrën të pastër, të dashur e të hapur për miqtë dhe të mbyllur e hekur për armiqtë. Këto ide shtrohen e zgjidhen me zotësi në disa tregime e skica, si te “Shëtitje me motrën e vogël”, “Dijari ndihmon Arjetën”, “Balona” etj.

Veçanërisht në këto tregime autori ka nënvizuar me të madhe dashurinë për shokun, duke nxjerrë në pah disa cilësi që shqiptari i ka trashëguar dhe i trashëgon nga një brez në tjetrin, siç janë: shpirti i sakrificës dhe i solidaritetit, bujaria e vetmohimi. Këto cilësi dalin qartë e thjesht në tregimet “Në pleshtë”, ku hero i vogël rrezikon të mbytet vetë në lumë për të shpëtuar shokun, “Një mollë shokut”, “Rruga e shtruar me hi” dhe në mënyrë të

veçantë të tregimi “Letra”, ku vihet në dukje shpirti i pastër e i gjerë dhe dashuria e madhe që kanë fëmijët për njëri-tjetrin. Mjafton që shoku i tyre të mos jetë i mërzhitur e i brengosur, por ata janë gati të bëjnë shumë gjëra për të, madje të shkruajnë edhe letra në emër të prindërve të shokut të tyre...

Në përmbledhje ka edhe tregime, ku spikat dashuria e të vegjëlve për zogjtë e kafshët, për lulet e bletët dhe në përgjithësi për natyrën e Kosovës, që ka peisazhe nga më mahnitëset, me lumenj të kaltër, me pyje madhështore e me male që kapin retë, si: “Dallëndyshja e parë”, “Zogu që bisedoi me Afërditën” etj. Këto skica e tregime ngajsin si këngë për natyrën e bukur të Kosovës.

Të gjitha skicat, tregimet e përrallat e përmbledhjes janë shkruar shkurt e qartë dhe rrallë i kalojnë të dy faqet. Autori shkruan pak që ju të kuptoni shumë. Në qendër të çdo tregimi shkrimtari Qamil Batalli vë nga një fabul sado të vogël, apo nga një gjetje interesante që juve ju tërheqin shumë dhe ju befasojnë. Kjo tregon se ai e njeh mirë botën e madhe të të vegjëlve. Këtë fabul apo gjetje shkrimtari e zberthen deri në hollësi, duke vënë gjithmonë në dukje kryesoren dhe pa rënë në moralizime. Morali buron vetvetiu dhe dora e autorit nuk ndihet fare. Shkrimtari nuk rend pas të papriturave që të tërheqë vëmendjen e lexuesit të vogël, por rëndësi i kushton paraqitjes së botës së fëmijëve, duke e shpalosur atë me ngjyra sa më të bukura para lexuesit. Këtij qëllimi i shërben shumë edhe ngjeshja e frazës me frazeologji të pasur popullore, fraza e shkurtër dhe lodruese, përshkrimet njohëse dhe mënyra e të treguarit shtruar që të kujton përrallat popullore.

Është me interes të shënojmë se autori, personazheve që kanë skicat, tregimet e përrallat e tij e që janë me qindra, u vë emra ilirë, arbëreshë e shqiptarë, si: Fatbardh, Lurand, Bashkim, Shkëlzen, Ndrçim, Lulzime, Fatos etj. Këtu ai ndjek një qëllim të lartë: emrat tanë të bukur t’i trashëgojmë brez pas brezi e të mos rendim pas emrave të huaj që s’kanë asgjë të përbashkët me traditën

e popullit tonë edhe në fushën e emrave të njerëzve (anomastikës).

Një qëllim tjetër që ndjek autori në tregimet e veta është edhe përpjekja për t'u pasuruar lexuesve të vegjël fjalorin, në mënyrë që t'u rrënjosë në shpirt dashurinë për gjuhën shqipe, për gjuhën e të parëve tanë ilirë, për gjuhën me të cilën shkruan Naimi, Çajupi, Mjeda, Noli e Migjeni. Këtë e sheh edhe te begatia e fjalëve të vjetra e lokale, por të bukura që mbajnë kuptime të larme e të ndryshme, si: lazdrajkë (lozonjare), egërshan(i egër), etçuar (i etshëm), rrezitem (ngrohëm në diell), cubel (bisht shkurtër), xeheror (minierë) e plot e plot të tjera. Këto fjalë duhet t'i mësojmë e t'i përdorim edhe ne në të folur e në hartimet apo letrat që bëjmë.

Me vlerat e mëdha njohëse, edukative e letrare që kanë skicat, tregimet e përrallat e shkrimtarit Qamil Batalli, përmbledhja "Do të vdisja për Skënderbeun" do të shërbejë për edukimin tuaj dhe do të zerë një vend të nderuar në të gjitha bibliotekat tona.

TIRANË, 1984

LETËR ERISIT GJASHTËVJEÇARE

Shumë e dashur Eris.

Së pari të uroj shëndet!

Pse ta bëj këtë urim?! Se pa shëndet nuk bëhet asgjë. Po të kesh shëndet arrin gjithçka!

Ja, ti e ke shkruar përrallën me shpirt e me mendje kur ke gëzuar shëndet të plotë, prandaj ajo ka dalë aq e mirë, aq e bukur dhe aq e shëndetshme. Po ta kishe shkruar në një kohë që ke patur pak temperaturë ose pak kollë, edhe përralla do të kishte dalë disi e dobët, anemike, siç thonë mjekët...

Nuk po them se për të shkruar përralla të bukura duhet vetëm shëndeti. Jo, njëqind herë jo!

Që të krijosh gjëra të bukura në çdo fushë të letërsisë, të artit etj., duhet edhe talenti, që ty ta ka falur Zoti me pashë! Pa duhet edhe puna e madhe këmbëngulëse. Se, si ka thënë populli?

“Një talent dhe nëntë punë!”

Dhe unë e kam parë me sytë e mi se ti punon shumë. E mendon përrallën gjatë e gjatë, e ndërton dhe e prish aty-këtu për ta rindërtuar më mirë e më bukur në mendjen tënde, pastaj e tregon...

Veç këtyre, ti je edhe me fat të madh: nënën e ke piktore dhe

babanë shkrimtar. Nëna të ka hedhur në letër përrallën që i tregove e të ka bërë parathënien e librit, ndërsa babai të ka shkruar pasthënien.

Veç dhuratës së Zotit e punës tënde, ti trashëgon edhe nga talenti i tyre, se të dy prindët i ke të njohur e të dëgjuar.

Pra, ti i ke të gjitha ato që i duhen një krijuesi: shëndetin, talentin, punën dhe trashëgiminë. Lum si ti! Se këto janë një thesar i madh e i pallogaritshëm. Jo cilido krijues i ka të gjitha këto dhunti e miradina! Ruaji si sytë e ballit e çoji më tutje...

Ti edhe shkruan, edhe pikturon edhe pse nuk di të shkruash e të lexosh, edhe pse nuk i njeh teknikat e të fshehtat e pikturës. Për të shkruar të ndihmon nëna me dorën e saj. Për të pikturuar të ndihmon mendja dhe dora jote.

Këtë (nuk desha të bëja një parathënie ose pasthënie të dytë dhe as të të jepja këshilla për përrallën tënde...) por ta shkruaj si shkrimtari shkrimtarit. Dhe a e di pse?

Se ti me të vërtetë je shkrimtare dhe piktoresh me të dhëna, që premtojnë për të ardhmen. Ani pse je ende e vogël.

T'i them këto fjalë jo për të të bërë qejfin, por nga ç'pashë te përralla jote, të cilën e lexova dhe e rilexova disa herë. Se ne jemi shokë e miq dhe kolegë bashkë, edhe pse na ndajnë rreth gjashtë dhjetëvjeçarë! Dhe shoku, miku e kolegu nuk ta bëjnë qejfin kurrë në qoftë se nuk e meriton diçka. Ata që të duan me gjithë shpirt të thonë vetëm të vërtetën!

Te përralla që ke shkruar unë pashë një fantazi të ndezur, një fabul të ngjeshur që disa herë nuk i gjen edhe te shkrimtarë të rritur. Gjithashtu pashë edhe të papritura të bukura e domethënëse, ngjarje interesante e njohje të përrallave popullore. (Lulja, Princi dhe bëmat e tyre të kujtojnë gurrën popullore ku pinë të gjithë krijuesit. Po kështu edhe magjistrica etj.). Pashë edhe personazhe që je munduar t'i skalitësh me aq sa ta lejon moshën... edhe mënyra si e ke shkruar është e rrjedhshme.

Po të ishte shënuar në krye të përrallës emri i ndonjë autori e

jo yti, unë do ta kisha besuar se e ka shkruar një krijues me përvojë. Për të gjitha këto, të them me plot gojën e me shkronja të mëdha: TË LUMTË!

Dikush mund të thotë: “Si mund të jetë shkrimtare e piktore një fëmijë gjashtëvjeçare, që ende nuk di as të shkruajë e as të lexojë?”

Unë do t’i përgjigjesha:

Ja që ka edhe të tillë. Se Zoti e Natyra bëjnë mrekullira! Këtë e tregon edhe përralla me më-se 30 faqe që ka krijuar vogëlushja Eris Bushati nga Shkodr locja!

Nëna vetëm sa ta ka hedhur në letër. Pa e tregojnë edhe ilustrimet e saj plot ngjyra, që i ka bërë me dorën e vet!

Në botë mund të ndodhë çdo gjë, aq më tepër tani që fëmijët lindin me “Universitet”, siç thonë pedagogët, psikologët e shkencëtarët.

Do të të tregoj një ngjarje të vërtetë për një tjetër vogëlush gjashtëvjeçar:

Gjatë kryengritjes greke për liri e pavarësi, një ndihmesë të madhe kanë dhënë edhe shqiptarët e arvanitët. (Arvanitët janë shqiptarë të vendosur prej shekujsh në Greqi. Për këto ti do të mësossh më vonë, kur të rritesh...) Gjatë kësaj kryengritjeje (1821-1829) është zhvilluar një betejë e ashpër edhe në Mesolonjë (emër vendi) ku luftuan shumë suljotë nga Suli, fshat shqiptar që gjendet brenda tokës greke. Ndërmjet të tjerëve ishte edhe një topçi nga Suli, i cili mbante pas vetes edhe të birin gjashtëvjeçar. Tamam sa ti, Eris... Babai që quhej Kristo, nuk kishte ku ta linte të biri, Jorgon, pasi nëna dhe të afërmit e tjerë ja kishin vdekur, ja kishin rënë për lirinë e Greqisë.

Në këtë betejë ranë gjithë suljotët, me përjashtim të Kristos dhe të Jorgos. Me që topçiun nuk kishte kush ta ndihmonte më, gjylet nisi t’ia çojë afër topit i biri gjashtëvjeçar. Jorgoja e Kristoja mbush e qëllo, e bën tym e flakë Mesolonjën!

Pak më vonë ra edhe Kristoja...

Tani Jorgoja jo vetëm çonte gjylet pranë topit. por edhe i vendoste në fole (kështu quhet vendi ku vendosen fishekët ose gjylet), u vinte zjarrin dhe i tmerronte osmanët!

Kur i mbaruan predhat, osmanët e kapën Jorgon e vogël dhe e torturuan që të tregonte kush kishte shtirë me top pasi i ishte vrarë babai. Vogëlushit nuk iu drodh qerpiku po tha si burrë i madh:

- Unë qëllova! Po të doni më provoni!

Pashai osman, që nuk e besoi një gjë të tillë, urdhëroi të sillnin një gjyle dhe ta vendosnin te arkat. Dhe e sollën.

Jorgoja e mori në duar, e vuri në fole, e ktheu grykën e topit mbi osmanët, i vuri flakën dhe shtiu mbi ta e i bëri përshesh!

Qysh atëherë, populli, historianët, këngëtarët popullorë, poetët e prozatorët, piktorët e kompozitorët dhe krijues të tjerë e kënduan trimërinë e tij dhe Jorgon gjashtëvjeçar e quajtën:

"Heroi më i vogël i të gjitha kohërave!"

Mos harro se Jorgoja ishte shqiptar nga Suli dhe gjashtëvjeçar sa ti, Eris!

Për mua ti je shkrimtarja më e vogël e të gjitha kohërave.

(Natyrisht, në moshë e jo në talent...)

Unë, me aq sa di, me sa kam dëgjuar e me sa kam lexuar, nuk kam ndeshur në ndonjë shkrimtar apo piktor tjetër në botë, në moshën tënde.

Duke e mbyllur letrën time, dua të të uroj:

U bëfsh shkrimtare e piktore e madhe! Se asgjë nuk të mungon për t'u bërë e tillë. Të shkruash gjëra të mrekullueshme e të ma kalosh jo vetëm mua por edhe shumë të tjerëve që janë më të zot se unë!

Të gush e të puth fort e fort, moj shoqja ime e vogël shkrimtare e piktore:

xhaxhi Odhise Grillo d.v.

TIRANË, KORRIK 1966

LETËRSIA PËR FËMIJË NIS TË ECI PËRSËRI

Pas një heshtjeje pothuaj dyvjeçare, shtypi ynë për të vegjlit dhe letërsia e tyre nisën të ecin përsëri... Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe: era e demokracisë, që fryu me vull, bëri që të hapen dyert e dritaret dhe të hyjë dielli kudo: edhe në shtëpitë e krijuesve, edhe në shtëpitë e botuesve. Kështu nisën të ridalin (ndonjëherë me tituj të tjerë) revistat për fëmijë. Gjer tani kanë dalë dhjetë numra të "Filizave" (më parë quhej "Pionieri"), disa numra të "Fatosit", ndonjë numër i "Horizontit" dhe i "Vogëlushëve" ("Yllkat"). Falë përkushtimit të autorëve të njohur për fëmijë si Xhevat Beqaraj, Myzejen Velça, Thanas Qerama, Liljana Cukalla, Sokol Jakova e ndonjë tjetër, të piktorëve Safo Marko, Xhilda Paloka, Jusuf Shahini e Lec Harapi dhe të bashkëpunëtorëve të shumtë, revistat po dalin përditë e më mirë, përditë e më të freskëta dhe me frymëmarrje më të gjerë.

Një grup shkrimtarësh entuziastë e të përkushtuar ndaj shtypit e letërsisë për fëmijë nisën botimin e gazetës "Bota e fëmijëve", një përpjekje që u përshëndet e u mirëprit nga të vegjël e të mëdhenj. Me vështirësi të shumta dolën 5-6 numra (s'mjafton vetëm dëshira, por duhet njohur edhe ekonomia e tregut...) dhe

pastaj pati ndërpreje. Tani gazeta del si revistë, me njëzet faqe, me ilustrime të shumta, një pjesë e tyre edhe me ngjyra. Rugën e kësaj gazete e ndoqi edhe një botim humoristik i zonjës Minerva Kumi (Dilaveri) me titullin befasues “Bim, bum, bam”, e cila s’po e hedh ende hapin e saj të dytë. Në Korçë shkrimtari Sefedin Spahillari me shokë nisën botimin e “Gjysmagjelit”, që ka një fillim të mbarë. Nuk e dimë ç’po bëhet në rrethet e tjerë. Zonjat Shpresa Vreto e Mira Meksi, me ndihmën e SOROS-it, po botojnë gazetën “Sirena e vogël”, organ i IBBY.(Ah sikur SOROS-i apo ndonjë tjetër bamirës t’i sponsorizonte gjithë botimet për fëmijë... Sa mirë do të ishte, si për krijuesit ashtu edhe për lexuesit e vegjël. Dhe kjo mund të ngjasë, nuk është ndonjë çudi! Ja, shkrimtari e botuesi i “Globit”, Petraq Risto, së shpejti do të nxjerrë revistën e ilustruar për fëmijë, me një titull fantastik: “Mrekullia”. Ky fat mund të trokasë edhe në dyer të tjera. Le të shpresojmë!) Ndërkohë, botuesi i “Kunjit”, “Grenzës”, “Qerosit” etj., zoti Haxhi Isufi, ka nisur botimin e revistës “Bilbilat”, e cila nuk po këndon dhe aq bukur për fëmijët pasi, për të nxjerrë një gazetë ose revistë për të vegjëlit, nuk duhen vetëm lekë e letër, por edhe cilësi shkrimesh e cilësi bashkëpunëtorësh... Revista “Hosteni”, e cila ka muaj që nuk del, nxjerr një botim të vogël humoristik, me titullin “Kacamisri” (ndryshe i themi edhe Gishto), për fëmijët. Është me ngjyra dhe e boton shkrimtari Kastriot Mahilaj.

Një punë shumë të mirë e të lavdërueshme po bën gazeta “Rilindja”. Ajo po boton çdo të martë nga katër faqe letërsi për fëmijë. Këtë shembull duhet ta jepte gazeta “Drita”, që është organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, mirëpo nuk ngjet kështu. Ajo jep një shembull tjetër: nuk boton asnjë rresht letërsi për fëmijë. Me sa duket, ndonjë punonjës i saj kujton se letërsia për fëmijë nuk është “letërsi e madhe”, si ajo për të rriturit(!) Dhe bën mirë që nuk boton: më mirë fare se të botojë vetëm ndonjë vjershë për fëmijët me rastin e Një Qershorit, siç ndodhte dikur!

Gazeta e revista për fëmijë mendojnë të botojnë edhe disa shkrimtarë të tjerë si Frederik Reshpja, Baku Gjoni... U priftë e mbara! Sa më shumë e sa më mirë! Këtë duan e presin fëmijët.

Rrugën e gazetave e të revistave e ndoqën edhe librat për fëmijë. Madje ua kaluan. Dolën në krye, sikur të ishin në garë. Shtëpitë botuese private, që nisën të krijohen nga fundi i vitit 1991 e fillimi i vitit 1992, sot kanë arritur në tetëdhjetë. Këtu vendi ynë zë vendin e parë në botë, për frymë të popullsisë... Bashkë me librat për të rriturit, botuesit privatë filluan të botojnë edhe letërsi për fëmijë. Kështu, gjer tani janë botuar rreth pesëdhjetë libra për fëmijët, kryesisht në prozë. Pra, pesëdhjetë libra në rreth një vit e gjysëm. Të qeshet kur dëgjon këtë shifër kaq të lartë dhe e krahason me ato dhjetë-dymbëdhjetë libra në vit që donin të botonin drejtuesit e shtëpisë botuese "Naim Frashëri" në vitet 1990-1991, me pretendimin se s'kishim letërsi për fëmijë.

Hapin e parë në botimin e librave për fëmijë e hodhi shtëpia botuese "Dituria", e zotit Petrit Ymeri. Ajo brenda pak kohësh nxori në qarkullim pesë libra për fëmijë, ndërmyet tyre "Lahutën e Malsisë" të Fishtës, rikrijuar për fëmijët, "Don Kishotin e Mançës" të Servantesit, rikrijuar po për fëmijët, "Totihuakani, vendi i diellit" etj. Këtë rrugë ndoqën pastaj shtëpitë botuese "Glob", "Albinform", "Artemida", "Besa", "Lilo", "Mirazh" etj. Veç duhet patur parasysh se në botimet e mëvonshme vendin e parë e zuri letërsia e huaj, paçka se u botuan edhe libra të dobët. Botuesit tani nisën të botojnë autorë të mëdhenj e të dëgjuar, edhe pse ndonjë vepër s'ruan pothuajse asnjë vlerë. (Le të kujtojmë këtu "Gostia e Konteshës plakë" etj.) Ndërkohë u krijua edhe e vetmja shtëpi botuese që kryesisht do të merret me letërsinë për fëmijë. Ajo quhet "Rozafa" dhe drejtohet nga z. Luçie Doçi, grua e letrave, autore e disa librave publicistike, dashamirëse e letërsisë dhe e fëmijëve. Kjo shtëpi botuese botoi dy libra: "Pesëqind grosh" dhe "Teli dembeli" të dyja poema humoristike. Thuhet se shteti do ta subvencionojë

letërsinë për fëmijë, po për fat të keq kësaj shtëpie botuese nuk i është dhënë asgjë gjer më sot, ndërsa të tjera, që s' botojnë letërsi për të vegjlit, diçka kanë përfituar.

Gjer tani për fëmijët janë botuar mbi dhjetë romane, gjashtë novela, pesë poema humoristike, tri përmbledhje me përralla, dhjetë libra të ilustruar, tre fantastiko-shkencorë, disa balada popullore (si ajo e Rozafës, e Kostandinit e Doruntinës etj.) të shoqëruara me figura etj. Në mes tyre, veç ndonjërit që u përmend më lart, janë me vlera të spikatura "Imiri prej Monunit", "Kacamisri rreth globit", "Laraska pa bisht", "Hundëçipët", "Rrëfim për dy mbretër", "Lahuta e malsisë", "Don Kishoti i Mancës" etj. Të autorëve të njohur Ndoc Pappleka, Bedri Dedja, Hamdi Meça, Loni Papa, Valter File, Odhise Grillo, Thanas Qerama, etj. Po kështu me vlera janë edhe librat e disa autorëve më të rinj si Mira Meksi, Petraç Risto, Sefedin Spahillari, Stavri Pone etj.

Vend me rëndësi në botimet për fëmijë zënë edhe librat e përkthyer nga autorë të shquar e të njohur, nga Franca, Anglia, Italia, Spanja etj., si Aleksandër Dyma, Artur Klark, Ajven Sautholl, Emanuel Gisbert (ky autor thuhet se ka zëvendësuar denjësisht krijuesin e letërsisë fantastiko-shkencore, Zhyl Vernin.) Madje kohët e fundit, ashtu siç e përmendëm më lart, autorët e huaj zenë vendin e parë në botimet tona për fëmijë. Kjo edhe për arsye se ato janë shkruar nga autorë që kanë bërë emër në vendet e tyre e kudo në botë. Kjo u jep siguri botuesve se mund të shiten më shumë. Po duhet patur kujdes, që botimi i tyre të mos bëhet pengesë për autorët shqiptarë. Një dukuri tjetër negative në fushën e botimeve për fëmijë është i ashtuquajtimi botim me pare në dorë, kur autori mbulon të gjitha shpenzimet për botimin e librit me paret e veta. Kjo ka dy të këqia: së pari, kështu mund të mos botojnë dot shkrimtarë shumë të zot, pasi mund të mos kenë "buxhet" dhe, së dyti, kështu, duke patur "buxhet të majmë", mund të botohen libra nga autorë që vlejné pak ose aspak. Këto të këqia

kanë filluar të duken hapur, po kemi shpresë se botues të tillë si zotërinjtë Petrit Ymeri, Fatmir Toçi, Petraq Risto, Shefki Karadaku, Loni Papa, Spiro Dedja, Luçie Doçi etj., nuk do të notojnë në këto ujëra, po do të botojnë libra që do t'u vlejnë lexuesve dhe do të jenë ndihmesë e madhe për lulëzimin e përparimin e letërsisë sonë për fëmijë.

TIRANË, 1993

FËMIJËT E LEXOJNË POEZINË E BUKUR

Këta vjetët e fundit janë botuar shumë pak përbledhje poetike për fëmijët. Ato numërohen me gishtërinjtë e dy duarve, për të mos thënë edhe më pak. Në mes tyre shquhen vëllimi “Libri i dëshirave”, i poetit Ferdinand Laholli, “Pak blu nga qielli” i poetit Kostandin Dharmo e ndonjë tjetër. Janë botuar edhe disa libra të tjerë që nuk arrijnë as vlerat mesatare artistike, si “Lulet, Ola dhe një bletë” etj. Të parat i thërresin lexuesit e vegjël për t’i marrë në duar e për t’i çfletuar edhe përmbledhjet poetike. Të dytat bëjnë të kundërtën: ato ua zbehin dëshirën për ta lexuar poezinë dhe ç’është më e keqja, u prishin shijet lexuesve të vegjël. Është kjo arsyeja që thuhet se fëmijët nuk e lexojnë poezinë. Dhe është një e vërtetë.

Mirëpo përmbledhjet me vjersha të bukura i lexojnë me ëndje të madhe. Këtë e tregon edhe vetëm fakti se, si në emisionet e radios ashtu edhe të televizionit, të vegjëlit recitojnë shumë vjersha. Madje më shumë se lloje të tjera letrare... Dhe këto vjersha i gjejnë nëpër libra. Pastaj të mos harrojmë se shumica e të vegjëleve shkruajnë edhe vetë në poezi..

Një libër i tillë, që me siguri do të lexohet nga fëmijët me dëshirë është edhe përmbledhja poetike “Merrmë vëlla për dore”,

i poetit Skënder Zogaj, nga Lladrovci i Malishevës, në Kosovë.

Skënderi është gazetar i njohur, ka qenë disa vjet kryeredaktor i gazetës së studentëve “Bota e Re”, e nga viti 1979 e këndej punon gazetar në “Rilindja”, më parë në Prishtinë e prej dy vjetësh në Tiranë, ku boton sepatatin “Rilindja për fëmijë”. Ai është autor i një përmbledhjeje me vjersha për të rriturit, që titullohet “Zogu i ekspozitës”, botuar në Prishtinë, në vitin 1983. (Përmbledhja “Merrmë vëlla për dore”, është botim i shtëpisë botuese “Naim Frashëri” në Tiranë, ka redaktor Gaqo Bushakën, piktores Safo Markon dhe recensues Odhise Grillon e Bardhosh Gaçen).

Është një gjë e njohur dhe e pranuar nga studiuesit, kritikët, lexuesit e vegjël e të mëdhenj dhe nga opinioni letrar se poezia shqipe për fëmijët ka patur e ka arritje të ndjeshme. Janë të njohura vjershat e poemat e Rexhep Hoxhës, Vehbi Kikajt, Mark Krasniqit, Rifat Kukajt, Ali Huruglicës, Agim Devës, Gani Xhafollit etj. në Kosovë, të Abdylazis Islamit, Fejzi Bojkut, Kalosh Çelikut etj. në Shkup dhe të Adelina Mamaqit, Bedri Dedes, Xhevat Beqarajt, Bekim Harxhit, Tasim Gjokutajt, Hamdi Meçës, Xhahid Bushatit etj. në Shqipëri. Ato janë bërë provë e të vegjëlve për artin e tyre dhe për vlerat edukative, njohëse e argëtuese që kanë.

Pikërisht në këto arritje është mbështetur poeti Skënder Zogaj prandaj edhe del para lexuesve me një përmbledhje me vlera artistike, në një fushë të vështirë e me kërkesa siç është poezia për fëmijë.

Për të arritur te kjo përmbledhje, ashtu siç nënvizohet edhe në recensat e librit, të cilat janë vendosur në fund të vëllimit, ai ka ndjekur disa hulli, të cilat i ka shkruar në një: mbështetjen me të dy këmbët në folklorin popullor (këtu mund shihet ligjërimi poetik, thjeshtësia e vargëzimit, ndonjë herë edhe figuracioni) mbështetjen te fryma atdhetare e humane në krijimet e poetëve të mëdhenj të Rilindjes e të Pavarësisë, veçanërisht te Mjeda, mbështetjen te poezia moderne që krijohet sot në botë, me të cilën poetët nga

Kosova e Shkupi njihen mirë (ndryshe nga poetët në dheun amë që e kishin “mollë të ndalur” për rreth pesëdhjetë vjet), sidomos për konceptimin fëminor, tematikën e larmishme, figuracionin e mënyrën lodruese të hartimit të vjershave; mbështetjen te poetët bashkëkombas brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë; për gjetjet interesante e intriguese, për frymën atdhetare, për ëmbëlsinë e vargut, të rimës e ritmit dhe të elementëve të tjerë organizues të poezisë dhe, kryesorja, mbështetjen në talentin e vet për të gjetur rrugë të reja bashkëbisedimi me lexuesit e vegjël, për të vëzhguar me syrin, mendjen e zemrën e fëmijës gjithçka që i gazmon, që i vë në mendim apo i shqetëson, për të parë e shprehur me art e me këndvështrim origjinal botën që na rrethon, për të gërshetuar fjalën e urtë, të bukur e të ëmbël shqipe me humorin e hollë e shpesh shpotitës (me mahinë, siç thonë në Kosovë), në vargje që kanë të shkrira në një mendimin, figurën dhe mjetet e formës, që i ka dinamike e jo strikte.

Të gjitha këto cilësi të poezisë së Skënder Zogajt i gjen në shumicën e vjershave të tij. Natyrisht jo të gjitha, pasi në një përmbledhje do të ketë edhe vjersha mesatare. Po kur këto janë të pakta, siç ndodh në vëllimin e Skënder Zogajt, ato s’ndihen fare se i “neutralizon” e mira, e bukura, e gjetura, artistikja.

Këto arritje i nënvizon edhe recensuesi Bardhosh Gaçe, poet e studiues i folklorit. Ai me të drejtë shkruan se:

“Në poezinë e tij Skënder Zogaj tregon se e njeh mirë psikologjinë dhe botën e fëmijëve, prandaj dhe vargjet përcjellin imazhe me ngarkesë emocionale e figura të bukura artistike...

Nëpërmjet vargjeve me ngarkesë poetike e me mendime të kthjellta filozofike, jepen detaje, ngjarje e fabula nga jeta e fëmijëve, të cilat i ka qëmtuar me kujdes në veprimtarinë e tyre në shkollë e mes lodrave”.

Ne do të shtonim edhe në familje e në shoqërinë e të vegjëlve dhe të të mëdhenjve, pasi në to shprehen ëndrra, dëshira e shpresa

që nuk mund t'i ketë një fëmijë i vetëm, por shumë fëmijë e shumë njerëz.

Përmbledhjen poeti e ka ndarë në disa tufëza vjershash, të cilat i bashkojnë idetë, mesazhet, mënyrat e hartimit të tyre dhe tematika. Ato mbajnë titujt “Puthja e erës”, “Lagjja gazmore” dhe “Adresa e dallëndyshes”. Siç shihet edhe nga këta tituj (do të shtonim këtu edhe tituj vjershash, si “Dega e mollës ma bëri me sy”, “Në xhepat e reve”, “Porositë e gjyshes Qamile”, “Ylli me laps magjik”, “Të hëngërt miu veshët” etj.), poeti i kushton një kujdes të madh “emërtimit” të vjershës. Një titull i bukur, i gjetur e i ndërtuar me fantazi, ngjall fantazi te lexuesi i vogël, e intrigon atë, e thërret ta marrë në dorë përmbledhjen dhe ta lexojë gjer në fund.

Pra, siç thotë populli, ai është një “karrem” në kuptimin më të mirë të fjalës, kur edhe vjershat janë të shkruara me ndjenjë, mendim e art.

Në mbyllje të këtyre shënimeve, do të shprehim një keqardhje e një urim: dëshironim që ky poet i talentuar të mos vinte kaq vonë në sofrën e përbashkët të poezisë shqipe për fëmijë. Po më mirë vonë se kurrë... Tani që u ul në sofër, e urojmë të mos ngrihet më kurrë prej saj!

TIRANË, 24 JANAR 1995

KUR BABI DI TË TREGOJË PËRRALLA...

Kohët e fundit janë vënë në shitje shumë përmbledhje me përralla, si të autorëve tanë ashtu edhe të autorëve të huaj. Këtyre botimeve, këto ditë iu shtua edhe përmbledhja “Përrallat e babit tim”, e shkrimtarit Xhahid Bushati.

Këto janë një dhuratë e bukur për të gjithë lexuesit e vegjël, e mund të lexohen me interes edhe nga të rriturit, se përralla u drejtohet të gjithëve, veçanërisht kur është shkruar me zotësi.

Një gëzim i veçantë është sidomos për gjashtë-nëntëvjeçarët pasi, si në të kaluarën edhe sot, në fushën e prozës në përgjithësi e në atë të përrallës në veçanti, këtyre vogëlushëve u është dhënë shumë pak. Ndryshe ka ndodhur me përrallat në vargje, me poemat-përralla e me fabulat në vargje për këtë moshë, ku kemi patur një lloj bollëku... Kjo, veç të tjerave, shpjegohet edhe me vështirësitë e krijimit të përrallës në prozë për gjashtë-nëntëvjeçarët, pasi ajo kërkon fabul të ngjeshur, gjetje intriguese që të mund t’i mbetet në mendje fëmijës, konçizitet e jo zgjatje dhe zvarritje, gjuhë fëmimore e lodruese dhe fantazi të ndezur.

Këto kërkesa i gjejmë të realizuara në pjesën më të madhe të përrallave të Xhahid Bushatit, gjë që tregon se autori e njeh moshën

së cilës i drejtohet, i di kërkesat e interesat e tyre e përpiket t'ua plotësojë ato dhe e zotëron artin e krijimit të përrallës për gjashtë-nëntëvjeçarët. Kjo është një dukuri që e vë re jo vetëm në përrallat e tij, por edhe në vjershat (shih përmbledhjet) “Kush e zgjoi këngën e zogut?”; “Kush t’i solli yjet, hënën?” “Hyni në çadrën time”), përmbledhjet me tregime “Dita e parë e dëborës” dhe në shumë krijime të tjera të tij, si tregime, vjersha, përralla, skica e përkthime të botuara kohët e fundit në gazeta e revista për fëmijë, si në “Rilindja për fëmijët”, “Mrekullia”, “Fatosi” etj.

Mirëpo duhet pohuar se jo të gjitha përralla e përmbledhjes së re i plotësojnë kërkesat e domosdoshme për këtë moshë. Ka midis tyre edhe krijime pa fabul fare, si “Tre ketrushët”, përralla që zgjaten më tepër nga ç’mban fabula e tyre, si “Në ditën e parë të pranverës” apo “Ç’ndodhi një herë me rikën Laramane”, përralla që janë ndërtuar thjesht me një dialog apo përshkrim, si “Përse nuk zgjohej gjinkalla” etj.

Karakteristikë kryesore e përrallave më të mira të kësaj përmbledhjeje është konciziteti. Ato janë të shkurtra shumë dhe shkojnë nga gjysëm gjer në një faqe apo diçka më tepër. Kjo lidhet ngushtë me moshën së cilës i drejtohet autori, por edhe me prirjen e tij për të shkruar shkurt e qartë. Dihet mirëfilli se për çdo grupmoshë fëmijësh dhe për çdo klasë, veçanërisht në leximet letrare, pedagogët, psikologët e metodistët shohin jo vetëm gjatësinë e krijimeve, por edhe fjalorin e tyre, të cilin e kanë të përcaktuar. Këtë, ndofta me intuitë, e ka patur parasysh edhe shkrimtari, dhe kështu është përpjekur të shkrijë në një parimet letrare me ato pedagogjike, gjë që është një nga kërkesat kryesore në letërsinë për fëmijë.

Edhe pse janë përralla të shkurtra e s’kanë hapësirë për të krijuar personazhe të skalitur, autori është munduar të skicojë disa “tipa” interesante, që u tërheqin vëmendjen lexuesve të vegjël, si nga bota e kafshëve, shpendëve etj. Kështu ndodh me përrallat

“Guri i çmuar” (edhe pse personazhi nuk ka emër), “Pushpushi dhe Pushverdhi”, “ Këmbëngulja e zogut të vogël” etj. Në realizimin e tyre sado pak ka ndihmuar edhe gjetja e emrave intrigues e tingëllues për të vegjlit, si Pushpushi, Stiku, Fiku, Kiku, Drina, Dajana etj. Po në ndonjë rast autori e ka shkelur në emërtimin e personazheve. Kështu, në përrallën e rikave ka përdorur mbiemrin e një autori shumë të njohur në letërsinë tonë për fëmijë. Kjo nuk e nderon autorin dhe nuk është në etikën e krijuesit. Dhe besojmë se e ka bërë pa dashur...

Përrallat e Xhahid Bushatit i përshkon një frymë e ngrohtë lirike, që i bën t’u afrohen vjershave të autorit, të cilat përgjithësisht ngjasin si akuarele apo si peisazhe. Ka ndërmjet tyre edhe krijime që u afrohen prozave poetike e ndonjë edhe tregimeve për këtë moshë, sidomos kur u mungon fabula e gjetur dhe e ngjeshur, po këto nuk janë zotëruese në përmbledhje.

Një të metë që e ndeshim te shumë autorë të tjerë, siç është moralizimi i thatë, në fillim, në mes e veçanërisht në fund të krijimeve, Xhahid Bushati e ka mënjanuar me zotësi në shumicën e përrallave. Autori nuk moralizon përgjithësisht dhe dora e tij nuk ndjehet. Edhe kjo është një arritje që ua shton vlerat përrallave. Morali del vetë gjatë zhvillimit të ngjarjeve në përshkrimet, dialogët etj., në mënyrë të natyrshme.

Veç përrallave të krijuara nga autori, në libër janë përmbledhur edhe disa përralla të ndërtuara mbi motive popullore dhe përralla të shkruara me fabula të njohura. Kjo është një rrugë e përdorur nga të gjithë autorët te ne dhe kudo në botë. Të tilla në këtë përmbledhje janë “Guri i çmuar”, “Një mësim për drerin e vogël” (trajtuar dhe nga Epozi, si fabul, në lashtësi) e ndonjë tjetër. Këto janë shkruar mirë nga autori, por pa sjellë ndonjë gjë të re e bashkohore. Megjithatë ato kanë vlerat e veta.

Pavarësisht nga ndonjë dobësi apo e metë që vumë në dukje më lart, “Përrallat e babit tim”, e cila mund të kishte një titull më

të bukur e jo të përsëritur shumë (kujto “Përrallat e gjyshes sime”, “Përrallat e Aljonushkës”, “Përralla u la për nesër”, “Përralla fluturuese”) është një dhuratë e bukur për lexuesit e vegjël, të cilët presin edhe më shumë, edhe më mirë jo vetëm nga Xhahid Bushati, por nga të gjithë shkrimtarët që merren me këtë lloj, i cili është nga më të vështirët, veçanërisht për gjashtë-nëntëvjeçarët.

Si përfundim mund të themi se “babi Xhahidi di t’i tregojë mirë përrallat”.

TIRANË, SHKURT 1995

MESAZHE MIQËSIE

Komshijtë (ose gjitonët, si thuhet në Jug të vendit tonë) japin e marrin me njëri-tjetrin në të mira e në të këqia dhe janë më tepër se vëllezër. Vëllanë e ke larg e nuk mund të të gjendet në çast, siç të gjendet komshiu. Prandaj populli thotë: “Gjitori e perëndia,/ si Krishti e Shënmëria...”

Historia na ka bërë komshij në shekuj me Greqinë, këtë mikpritëse të madhe të refugjatëve shqiptarë, veçanërisht këta vjetët e fundit. I kemi pritur kur kanë patur hall e nevojë e na kanë pritur në të tilla raste. Po i kemi pritur edhe në dasma e gëzime, duke i vënë në krye të sofrës. Kështu na e kanë larë borxhin edhe ata. Të dy palët me zemër.

Këtë dashuri e miqësi të madhe, pavarësisht nga shovinistët e partiakët e sëmurë, e kanë shprehur popujt tanë duke nderuar e respektuar njëri-tjetrin e duke i hapur dritare në të gjitha fushat, kush më shumë e kush më pak. Këtë të vërtetë e sheh dhe e ndjen edhe në fushën e lëtërsisë.

Populli grek, me një letërsi të madhe qysh në antikitet “ka hyrë në Shqipëri” që në fillimet e Rilindjes sonë kombëtare. Qysh atëherë janë përkthyer e janë bërë të njohura në vendin tonë shumë

libra të shkrimtarëve grekë, që nga Homeri (pjesë të “Iliadës” i ka përkthyer qysh në Rilindje Naim Frashëri) e deri te bashkëkohësit. Se librat janë mesazhe miqësie midis popujve. Naimi i madh, që i dinte më mirë se kushdo vlerat e librit, një nga veprat e veta të para, ia ka drejtuar popullit grek, pra komshiut të vet. Dhe jo vetëm kaq: ai e ka shkruar poemën në greqisht dhe e ka titulluar “Dashuria e vërtetë e shqiptarëve” (në vitin 1886). Kjo poemë ka njohur gjer tani tri përkthime në gjuhën tonë. Në mes të tjerash, Naimi thotë:

*Ne me grekët dëshirojmë,
si vëllezër të jetojmë,
përngahera në harmoni.*

Letërsia greke, e krijuar nga kolosalë e që ka ushtruar ndikimin e vet në gjithë letërsinë evropiane, është bërë shumë e njohur dhe është nga më të lexuarat në Shqipëri. Ne e njohim mirë letërsinë frënge, angleze, ruse etj., me shkrimtarët e veprat më të spikatura, po me letërsinë greke nuk barabitet asnjë. Aq e njohur është bërë sa që lista e librave të përkthyer kërkon një bibliografi voluminoze. Në vendin tonë njihen pothuajse të gjithë shkrimtarët e Greqisë antike, që nga Homeri, Aristofani, Eskili, Sofokliu, Alkeu, Euripidi, Arqiloku, Safoja e gjer te Anakreonti. Dhe i njohim të mëdhenj e të vegjël, se një pjesë e madhe e tyre nisin të mësohen nëpër shkolla qysh në klasën e pestë të tetëvjeçares e më pastaj në të mesmen. Në degën e gjuhë-letërsisë në universitet shkrimtarët grekë zënë vend nderi.

Po kështu, lexuesi ynë njih shumë shkrimtarë të Rilindjes kombëtare greke si Kostis Pallamas, Niko Kazanzaqi, Elitis, Seferis etj., për të ardhur te bashkëkohësit si Ricos, Rita Bumi Papa, Paradhisis, Varnalis, Livadhitis etj., etj. Këtu nuk po përmendim përmbledhjet (antologjinë për lexuesin e gjerë e për nxënësit), me prozë e poezi antike greke, me prozë e poezi bashkëkohore etj.

Vend të veçantë në letërsinë e përkthyer nga greqishtja zënë veprat për fëmijë. Ka dhjetra vjet që në duart e lexuesve tanë të vegjël kanë rënë “Iliada” e “Odhiseja” të përshtatura për fëmijët. Po kështu, janë përkthyer “Eskili në prozë”, “Sofokliu në prozë” dhe “Euripidi në prozë” vepra këto të shkrimtarit bashkëkohës Jani Benokos; “Trimëritë e Herkulit”, “Retë dendësohen” e “Djaloshi që numëronte yjet” të Menelao Ludemisit; “Tigri i vitrinës” e Alqi Zeit, “Herói më i vogël i të gjithë kohërave” e Llambro Mallamasit etj., etj.

Edhe në Greqinë fqinje janë bërë përpjeke për përkthimin e letërsisë shqipe, veçanërisht këta vjetët e fundit. Populli ynë ka nxjerrë shkrimtarë të shquar, të cilët mund të përkthehen e lexohen me ëndje kudo në botë. Veçanërisht mund të ishte bërë shumë pesëdhjetë vjetët e fundit, mirëpo diktatura që kaluam vetëkënaqej kur përktheheshin veprat e Enver Hoxhës, paçka se grekët nuk njihnin as Naimin, as Nolin, as Kadarenë e as Agollin. Nuk po flasim këtu për shkrimtarët minoritarë që botonin në greqisht e që asnjë vepër e tyre nuk u ribotua në Greqi.

Këta vjetët e fundit në Greqi janë përkthyer disa vepra të shkrimtarëve tanë. Kryet e vendit e zë “Historia e Skënderbeut” e Fan Nolit, e përkthyer disa vjet më parë. Më pas u botuan “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Ismail Kadaresë, “Thikat” e Neshat Tozajt, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, e Dritëro Agollit dhe përmbledhja me vjersha për fëmijë “Zërat e fëmijërisë” e Odhise Grillos, përkthyer nga poeti minoritar Vasil Koçi. Librat e tjerë janë dhënë në greqisht nga përkthyes grekë. Kohët e fundit në Greqi u botua edhe një përmbledhje me vjersha e poetit minoritar Pano Çuka.

Siç shihet, fillimi është premtues. Janë mundësitë për të dhënë më shumë mesazhe miqësie të letërsisë shqipe në Greqi.

Për lexuesit minoritarë, të mëdhenj e të vegjël, janë përkthyer e botuar shumë libra të shkrimtarëve tanë. Veçanërisht është bërë

shumë në këtë fushë me letërsinë për fëmijë, pasi këto vepra u duhen të vegjëlve për lexime jashtë klase e për veprimtaritë e tjera.

Vetëkuptohet se nga letërsia greke, me tradita shekullore e me kolosë të shumtë, kemi perkthyer e do të përkthejmë edhe në të ardhmen kryevepra të tjera. Edhe në Greqi ashtu si në të gjithë vendet e tjerë duhet të përkthehen e botohen kryevepra nga letërsia e të gjithë popujve, kështu që edhe nga letërsia jonë mund të përzgjidhen e të botohen krijimet më të mira që kemi e që mund t'i jepen lexuesit grek. Këto mesazhe miqësie, nga fusha e letërsisë i presin me dëshirë, si populli shqiptar ashtu edhe populli grek, se jemi fqinjë të mirë, të lidhur me njëri-tjetrin qysh në kohëra që s'mbahen mend.

TIRANË, 1993

GURË THEMELI

Shkrimtari i mirënjohur Bedri Dedja është një krijues poliedrik, si në fushën e letërsisë për fëmijë, ashtu edhe në atë të studimeve pedagogjike, psikologjike etj., i cili ka dhënë ndihmesën e vet të çmuar përmbi pesë dekada rresht. Dhe përsëri ka mbetur i ri në krijimtari, se punon me talent, me përkushtim dhe me shpirt e vull rinor.

Këtë e tregon edhe përmbledhja e re me përralla që po ju dhuron juve, lexues të vegjël, dhe që mban titullin e bukur e intrigues “Përralla njëmbëdhjetëkatëshe”.

Në rrugën e vet krijuese shkrimtarin Bedri Dedja nuk e kanë dehur as lëvdatat e çmimet e shumtë që ka marrë e nuk e kanë lëkundur as anatemat që kanë lëshuar kundër tij, si krijues, disa pseudostudjues e pseudokritikë, të cikët e kanë TBC-në jo vetëm në mushkëri, por edhe në shpirt si psh gjoja kritiku Alben Ushi. Prandaj edhe ka arritur të botojë më shumë se dyzet libra për fëmijët, në të gjitha gjinitë e llojet letrare, pa përmendur këtu edhe shumë libra në fushën e pedagogjisë, psikologjisë etj. Dhe ka shkruar e botuar aq shumë, sa që nesër studjuesit e veprës së tij do të thonë:

“Sa shumë paska punuar! Nuk ka pushuar ndonjëherë ky njeri?” Me sa duket, e ka bërë edhe natën ditë!”

Me veprat që ka shkruar për fëmijët, shkrimtari Bedri Dedja ka vënë gurë themeli të letërsisë tonë që krijohet për të vegjlit, si në prozë ashtu edhe në poezi, dramaturgji, studime e kritikë letrare. Ka shkruar e botuar romane, novela, tregime, përralla, vjersha, poema, poema humoristike, drama, pjesë teatrale e për kukullat. Po kështu ka dhënë ndihmesë edhe në zhvillimin e letërsisë sonë fantastiko-shkencore etj.

Ndihmesë të veçantë ka dhënë edhe në fushën e përrallës në dy drejtime: duke ritreguar përralla popullore dhe duke krijuar përralla origjinale, natyrisht veç përkthimeve. Për këtë flasin veprat që ka botuar gjer më sot e që janë të shumta: *“Përralla popullore mbi kafshët”*, *“Përralla e tre vëllezërve”*, *“Kallëzimet e gjyshe Pastërtores”*, *“Gjyqi i maçokut”*, *“Shkolla e pyllit”* (e cila është nderuar edhe me çmimin e Republikës”), *“Patoku në plazh”*, *“Bariu i vogël në Mal të Thatë”* etj.

Pena e tij shkëlqen veçanërisht në fushën e përrallës origjinale. Po të lexosh të gjithë autorët tanë që janë marrë me përrallën do të vesh re me kënaqësi se Bedri Dedja i krijon përrallat krejt ndryshe nga të tjerët. Ai ka mënyrën e vet të gjetjes së fabulës, të ndërtimit të subjektit, të skalitjes së personazheve, të futjes së problemeve e të frymës së kohës në përrallat e veta, të ndërtimit në mënyrë lodruese të fjalisë e të frazës, të futjes së humorit që është aq i kërkuar nga lexuesit e vegjël etj. Këtu qëndron edhe origjinaliteti i tij, që është i papërsëritshëm.

Veç këtyre, autori me zotësi ndërthur elementë të tregimit me ato të përrallës dhe kjo i bën ato më të pëlqyeshme e më të asimilueshme nga fëmijët. Këto elementë autori i ndërthur me fantazi të ndezur, duke i bërë përrallat të dashura si për lexuesit e vegjël, ashtu edhe për lexuesit e mëdhenj. Veçanërisht këtu luan rol pozitiv edhe njohja e botës, gjuhës e psikologjisë feminare

dhe mënyra e të treguarit në frymën e përrallave popullore. Edhe problemet që ngre në përrallat e veta, përveç vlerave letrare, njohëse e edukative, u interesojnë si të mëdhenjve ashtu edhe të vegjëlve. Në këtë vështrim Bedri Dedja takohet me shkrimtarin e madh italian Xhani Rodari, i cili është përkthyer në mbi tetëdhjetë gjuhë e që të befason me krijimet e tij në përmbledhjen “Xhipi në televizor”, të përkthyer edhe në shqip. Në to Rodari ka ndërfitur me mjeshtëri elementë të tregimit në përrallë dhe ka ngritur probleme që u interesojnë edhe të rriturve, edhe fëmijëve.

Këtë rrugë shkrimtari Bedri Dedja e ka nisur qysh në vitin 1960, kur botoi përmbledhjen me përralla “Kallëzimet e gjyshe Pastërtores”, i cili u prit me interes nga të gjithë kategoritë e lexuesve.

Në këtë rrugë, po më me sukses, falë talentit e përvojës së gjatë, ecin edhe krijimet e përmbledhjes “Përralla njëmbëdhjetë katëshe”, që keni në duar dhe që me siguri do ta lexoni me dëshirë e me nderim për autorin. Dhe pasi ta mbaroni, do të thoni:

- Të faleminderit xhaxhi Bedri për përrallat e bukura që keni shkruar. Ju urojmë shëndet e jetë të gjatë, që në të ardhmen të na dhuroni edhe libra të tjerë si ky!

TIRANË, SHTATOR, 1996

NA ISHTE NJËHERË...

Na ishte njëherë një trim i madh e i rrallë që quhej Gilgamesh, të cilit nuk i gjendej shoku mbi dhe.

Po ai është edhe sot...

Gilgameshin e sollën të gjallë në mes nesh këngët që thuri populli për të, në Babiloni. E sollën gojë pas goje, fjalë pas fjale, varg pas vargu e këngë pas kënge ata që e krijuan nga mendja e nga shpirti, ata që e kënduan, ata që e shkruan dhe e studjuan, ata që e botuan në libra e ata që e përkthyen dhe e përcollën brez pas brezi.

Në shqip ne na e solli Anton Nikë Berisha, studjues e shkrimtar i njohur nga Kosova, pjesë e pandarë e Shqipërisë. Ai lindi në Dobërdol të Klinës, më 1946. Ka mbaruar Fakultetin e Filozofisë, Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe, në Prishtinë. Më pas kreu studimet pasuniversitare në Zagreb, ku mori edhe titullin dëktor i shkencave folologjike. Për njëzet vjet punoi bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Më pas dha leksione në katedrën e Albanologjisë të Universitetit të Mynihut, në Gjermani, ndërsa që nga nëntori i vitit 1993 punon në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe (Departamenti i Linguistikës) në

Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Kalabrisë, në Itali. Ka botuar shumë libra për të rriturit e për fëmijët, studime të ndryshme, ese etj., dhe njihet në të gjitha trevat shqiptare e më gjerë.

“Epin e Gilgameshit”, këtë thesar të krijimtarisë popullore asiro-babilonase, që ka hyrë në fondin e artë të letërsisë botërore, Anton Nikë Berisha e përktheu nga gjermanishtja, duke patur për bazë librin e botuar prej studjuesit e përkthyesit të shquar gjerman G.Burghard, e duke shfrytëzuar edhe botime të tjera.

Kështu shkrimtari Anton Nikë Berisha, me talentin e përkushtimin e vet e bëri Gilgameshin të na flasë edhe shqip, nëpërmjet forcës magjike që ka vargu. Pas botimit në Kosovë e në Tiranë, atë e morën në duar lexuesit dhe e ruajnë në mendjet e në zemrat e tyre.

Këtë poemë madhështore që kaloi rrebeshet e shumë shekujve dhe erdhi gjer në ditët tona, ju nuk mund ta lexoni e ta shijoni tani për tani të plotë, për shumë arsye, të dashur lexues të vegjël.

Për t’u ndihmuar që ta merrni në duar dhe ta lexoni qysh tani, ashtu si edhe më parë me vepra të tjera nga Naimi, Fishta, De Rada, Dara i Riu, Servantesi etj., iu vura punës dhe e përshtata (ose e rikrijova, si mund ta themi ndryshe) në prozë, në formën e një novele, duke hequr e duke thjeshtuar ato gjëra që nuk i shkojnë moshës suaj.

Këtë punë që e bëra unë në shqip e kanë bërë në parë, në gjuhët e popujve të tyre, shumë shkrimtarë të tjerë në botë, të cilët i duan fëmijët si veten e vet dhe i trajtojnë si shokë e miq, prandaj edhe u japin libra të tillë, që nuk vdesin kurrë!

Kur nisa të rikrijoj veprat e autorëve që përmenda më lart, disa shkrimtarucë, kritikucë dhe “ucë” të tjerë, u vërsulën kundër tyre duke shpikur lloj-lloj teorish, që bota i ka kapërcyer prej kohësh, duke u përpjekur të mos i botonin. Dhe për një çast ia arritën qëllimit. Kështu “Don Kishoti i Mançës” u suall për tetë

vjet në duart e burokratëve të shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, ku punoja edhe vetë. Dhe të vjen keq se ndonjëri prej atyre, që nuk donte t’i botonte, si B.G., shkruante vetë për fëmijët, dhe u vinte stërkëmbësia shkrimtarëve të tjerë...

Po kjo nuk vazhdoi gjatë se erdhën ditë më të mira dhe puthadorësit e puthakëmbësit e diktaturës që kaluam ranë nga fiku për gjithmonë. Kështu m’u botuan të gjitha rikrijimet. Se nuk mund të ndodhte ndryshe! Rikrijimet në botë janë nga arritjet më të suksesëshme në letërsinë për fëmijë. Kujtoni anglezët Çarls e Meri Lamb (vëlla e motër) që rikrijuan tragjedinë e Shekspirit dhe u bënë të famshëm; gjermano-kanadezin Ajn Çerç që rikrijoi “Odisenë” e Homerit dhe u bë i njohur kudo në botë; shkrimtaren e dëgjuar italiane Laura Orvjeto, që rikrijoi “Iliadën” dhe i kaloi kufijtë e vendit të vet; çifuto-çekun Jaromir Xhon, që rikrijoi “Don Kishotin e Mançës” (kjo vepër ka njohur mbi njëzet ribotime); shkrimtarin e njohur grek Jani Benekos, që ka rikrijuar tragjeditë e Eskilit, Sofokliut e Euripidit; të gjitha këto të botuara edhe në vendin tonë po nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”...

Shqetësimi i “ucëve” ishte të mos botoheshin rikrijimet e mia prandaj prodhonin “teori” të tilla: “Nuk përshtaten tragjeditë, poezia dhe humori”; “Nuk kthehet poezia në prozë e proza në poezi” dhe të tjera si këto. (Fjalët në thonjëza i kam shkëputur nga përgjigjet që më jepnin “ucët” për “Don Kishotin” etj.)

Kohët e fundit më ra në duar një botim me interes të madh në fushën e përshtatjes: në Angli është botuar një buqetë me kryevepra të letërsisë botërore, të rikrijuara për fëmijët. Janë dhjetë libra, si “David Koperfildi” i Dikensit. “Konti i Montekristos” e “Tre musketierët” të Dumasit, “Don Kishoti i Mançës” i Servantesit, “Kasollja e xha Tomit” e Harriet Biçer Stout etj. Botimi është bërë dygjuhësh: anglisht-frëngjisht, anglisht-gjermanisht, anglisht-italisht etj. Mua më ra në dorë varianti anglisht-greqisht. Të kënaqet shpirti t’i shikosh e t’i lexosh!

Uroj që edhe ju lexues të vegjël të keni fat e t'i lexoni në variantin anglisht-shqip!

Në këtë rrugë, veç poezisë e prozës origjinale që i kam në shpirt prej pesëdhjetë vjetësh, do të eci edhe në të ardhmen, se mësuesit nga bota i kam mbi tavolinë, prandaj po punoj mbi "Bardhën e Temalit", mbi këtë *Enciklopedi* të jetës shqiptare të Vaso Pashë Shkodranit, në shekullin XIX. Zoti më dhashtë jetë e shëndet që ta mbaroj e t'ua dhuroj juve, lexues të vegjël.

Po le të kthehemi te përshtatja e librit që keni në duar.

"Epi i Gilgameshit" na flet për luftën kundër së keqes e kundër territ të vdekjes. Ai na flet për fitoren e jetës mbi vdekjen edhe pse njeriu është i vdekshëm, prandaj ju ftoj ta lexoni edhe në shqip këtë këngë të mrekullueshme që ka thurur në lashtësi populli babilonas, i cili ka qenë edhe poet.

RRUGË PËR TË HYRË NË BOTËN E FËMIJËVE...

me mendime f. se bashkë për letërsinë

- Ç'mendim keni për letërsinë tonë për fëmijë?

- Kjo është një pyetje shumë e vështirë dhe shumë e gjerë. Megjithatë mund të them se letërsinë tonë për të vegjëlit e kemi në rrugë të mbarë, në rritje e në zhvillim. I kemi të kultivuara të gjitha gjinitë dhe kemi vepra të mira, në prozë e në poezi, dhe autorë që kanë individualitet. Artistikisht kemi vepra të nderuara. Për përmbajtjen e veprave tona për fëmijët mund të na e kenë zili gjithë bota. Natyrisht, një letërsi si kjo që kemi ne për fëmijët, e cila trashëgoi pak nga e kaluara, ka edhe të meta e dobësi. Disa i trashin dobësitë, disa të tjerë i minimizojnë. Nuk jam as me të parët e as me të dytët. Për më tepër nuk jam me ata që pa lexuar gjë, ose duke lexuar shumë pak, japin mendime e këshilla dhe arrijnë në përfundimin se letërsinë për fëmijë e kemi të dobët. Është për të ardhur keq që ka edhe të tillë. Unë jam me optimistët: edhe kur e kam gotën përgjysmë, them “e kam gjysmë plot e jo gjysmë bosh!” Forcat e reja letrare që do të vijnë edhe në letërsinë për fëmijë “do ta mbushin gotën plot e përplot!”

- *Ç'moshë duhet të ketë shkrimtari që shkruan për fëmijët?*

- Disa janë të mendimit se po nuk pate mjekër e mustaqe nuk mund të shkruash për të vegjlit, se je pa përvojë jetësore, nuk e njeh botën e tyre etj. Unë mendoj se për fëmijët mund të shkruash në çdo moshë. Pse e them këtë? Se shumë shkrimtarë si Guranjaku, D.Siliqi, Mamaqi, Dedja, Beqaraj, Reso, Harxhi, Gjokutaj, Hasko, Bishqemi, Meça e dhjetra të tjerë nuk pritën të bëheshin burra me mustaqe pastaj të krijoniq, por qysh të rinj u dhuruan të vegjëlve vepra të bukura. Dhe e kundërta, Sako, Çomora, Shuteriqi, Spasse, Çaçi, Gjata, Agolli e plot të tjerë shkruan për të vegjlit në moshë të pjekur. Pra, jeta tregon se mund të shkruash edhe kur je i ri, edhe kur je i vjetër, mjafton që t'i duash shumë fëmijët, të jetosh me ta, të përpiqesh që t'i njohësh, e, natyrisht, të kesh edhe talent.

(Kjo vërtetohet më së miri në ditët tona, kur veç shkrimtarëve në moshë të pjekur, për të vegjëlit shkruajnë e botojnë libra edhe fëmijë nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjeç. Shënim i vitit 1997.)

- *Shpesh thuhet se "në këtë periudhë paraprin poezia... ose romani... ose...". Cili është mendimi juaj për këtë?*

- Këto më duket se janë lojëra fjalësh. Në periudha të caktuara një gjini pëson ngritje sasiore e cilësore, për shumë arsye, një tjetër më pak. Kështu disa vjet më parë u zhvillua shumë novela për fëmijë, në një periudhë tjetër poema e vitet e fundit romani. Disa thonë se zhvillimi i romanit tregon pjekurinë e letërsisë për fëmijë. Kjo më duket është e nxituar. Pse? Se në letërsinë tonë të Rilindjes pothuajse nuk pati romane, por ajo u zhvillua dhe, brenda kuadrit të kohës, lulëzoi e ishte në kulmin e pjekurisë. Ç'do të thoshim për letërsinë greko-romake, ku nuk pati romane, se nuk e arriti pjekurinë? Dihen kryeveprat që u krijuan në Greqinë e Romën e lashtë.

- *Po atëhere, kush e paraprin?*

- Paraprijnë veprat e mira, në cilëndo gjini qofshin. Dhe të tilla kemi.

- *Ka disa që dobësitë e letërsisë për fëmijë i shpjegojnë me "kontigjentin" e autorëve që nuk ecin në letërsinë për të rriturit e që kërkojnë "strehë" në letërsinë për të vegjëlit. Ç'mund të na thoni për këtë?*

- Ata që s'çajnë dot në letërsinë për të rriturit, nuk çajnë as në letërsinë për fëmijë! Të dobëtit mbeten të dobët kudo! Këtu nuk duhet të ngatërrojmë dy dukuri: së pari, ka shumë shkrimtarë që merren me letërsinë për të rriturit, të cilët krijojnë edhe për të vegjëlit, duke nisur nga Shuteriqi, Agolli, Kadareja etj. E duke ardhur te më të rinjtë si Spahiu, Papeleka etj. Këta janë nga më të talentuarit. Së dyti edhe krijues të letërsisë për fëmijë kanë krijuar për të rriturit, si D. Siliqi, Drini, Zoto, Hasko e tj. Edhe këta janë të talentuar. Këtu vendos talenti dhe jo fusha në të cilën shkruan. Edhe në rast se e kanë gjetur të hapur derën e "botimit" në letërsinë për fëmijë disa autorë që kanë dështuar në letërsinë për të rriturit, e kanë gjetur të mbyllur derën e lexuesve!

- *Si mund ta ngremë më lart cilësinë në letërsinë për të vegjëlit?*

- Këtu ka shumë rrugë, unë do të përmend vetëm një të cilën që më duket se është nga më kryesoret: në këtë letërsi të japin ndihmesën e tyre të gjithë autorët më të mirë të letërsisë sonë. Shembullin na e kanë dhënë plot të tillë, që nga Spasse, Bulka, Jakova, Shuteriqi, Çaçi, Çomora, Gjata etj. etj. Po të krijonin shkrimtarët më të mirë nga një vepër herë pas here, ne do të kishim edhe bollëk, edhe cilësi. Po këtu duhet ndjekur rruga e Shuteriqit, Çomorës, Kadaresë, Priftit, Jorgaqit etj., që kanë krijuar shumë vepra për fëmijët dhe jo e Gjatës, Spasses, Xhuvanit, Blushit etj. që hodhën vetëm nga një fishekzjarr të bukur dhe pastaj i harruan fëmijët e fëmijërinë e tyre që e kaluan pa libra. Aq më pak të ndjekin rrugën e Drinit, Kostës e ndonjë tjetri që e nisën për fëmijët dhe ka vite që i kanë harruar të vegjëlit. Këtu na vlen përvoja e rilindësve tanë të mëdhenj si Naimi e Çajupi, që krijuan edhe për të vegjëlit dhe përvoja e

krijuesve me famë botërore si Tolstoi, Verni, Tueni, Gorki, Majakovski etj. Po të ndjekim këtë rrugë do të kemi korrje të mbara edhe në letërsinë për fëmijë, se sado të zot e të talentuar qofshin, letërsinë për fëmijë nuk mund ta mbajmë vetëm dhjetë-pesëmbëdhjetë apo edhe tridhjetë krijues në këtë fushë.

- Po Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve ç' mund të bëjë për ta çuar më tej letërsinë për fëmijë?

- Mund të bëjë aq sa nuk thuhet dot! Nuk mund t' i përmendim të gjitha. Do të zë në gojë disa që ndofta tingëllojnë si probleme administrative, por që s' janë të tilla. Mirë është që letërsisë për fëmijë t' i hapin dyert "Drita" e "Nëntori", duke botuar herë pas here gjërat më të mira, në prozë e në poezi. Gjer tani këto dyer kanë qenë të mbyllura... Po kështu të inkurajojë kritikët e studjuesit që të merren edhe me këtë letërsi e punimet e tyre të botohen në organet letrare. Të organizojë diskutime në qendër e në rrethe dhe të mos kujtohet të bëjë një plenum në 12 vjet siç ka ndodhur (një në 1971 e një në 1983!) Po kështu, shkrimtarët që merren me letërsinë për fëmijë të mos i shikojë me syrin e njerkes, po të nënës (lejet, oraret, profesionalizmi, etj.) në mënyrë që çdo njeri që merr penën për të shkruar për të vegjëlit të mos thotë pas një viti: "S' po merrem me këtë fushë se është pa bereqet e nuk të trajtojnë si të tjerët, sado i zoti që të jesh. Më mirë po merrem me letërsinë për të rriturit se atje edhe trajtohesh më mirë, edhe kamxhiku i kritikës të zë më pak..." Edhe kjo është një arsye që talentet e rinj, me të vërtetë të talentuar, i kemi të paktë shumë në letërsinë për fëmijë: Hamdi Meça, Xhahid Bushati, Astrit Bishqemi, Viktor Canosinaj e ndonjë tjetër.

- Ju keni shkruar në shumë gjini, cila ju pëlqen më tepër?

- Këtu do të flas me shifra: kam botuar shumë përmbledhje me vjersha e poema (rreth 25). Shifra mos ju habitë pasi në

përgjithësi librat për fëmijë, nga volumi, i mban edhe zogu në sqep, por jo nga vlerat... Kjo tregon se më pëlqen më tepër poezia. Por më pëlqen edhe proza, prandaj kam shkruar disa novela, tregime, përralla. Kam provuar edhe në dramë, gjini që e kemi më të varfrën. Herë pas here kam dhënë edhe ndonjë mendim për letërsinë për fëmijë, për autorë, vepra e gjini të ndryshme. Pra, vetëm roman nuk kam shkruar gjer tani.

- *Po roman pse nuk kenë shkruar?*

- Për disa arsye: së pari, se nuk shkruaj dot roman të dobët. Së dyti, se nuk kam ndjerë ndonjë nevojë të brendshme që të më shtynte drejt kësaj gjinie. Së treti, se jam i mendimit se shkrimtar nuk të bën romani, siç kujtojnë disa, të cilët shkruajnë romane "të botueshëm" duke braktisur gjinitë ku kanë dhënë më tepër. Dhe së katërti, se kam menduar që më mirë të përpiqem të shkruaj ndonjë vjershë, të cilën të ma pëlqejnë të vegjëlët se një roman që mund të mos e zënë me dorë. Shkrimtar nuk të bën romani, as faqet e shumta që mund të ketë libri, por vepra e mirë, në cilëndo gjini qoftë.

- *Thuhet se fëmijët lexojnë pak poezi. Është e vërtetë?*

- Këtu ka gjysëm të vërtetë. Fëmijët shqiptarë lexojnë poezinë e mirë, e duan, e mësojnë përmendësh dhe e recitojnë. Ne jemi vetë dëshmitarë se i kemi parë e dëgjuar nëpër mbrëmje letrare, festa, shfaqje e konkurse, sidomos në Radio Televizion, ku më tepër recitojnë poezi se prozë. Pastaj s'ka si të mos e lexojnë poezinë e mirë kur ata vetë shkruajnë më shumë vjersha se prozë. Fëmijët nuk lexojnë poezinë e dobët, atë që nuk ka fabul (pa fabul, çfarë t'i mbetet në mendje të voglit?), që s'ka figuracion, që s'ka humor, që moralizon (në shtëpi, në shkollë e në jetë moralizim, po edhe në poezi?), që thjeshtëzon, që tingëllon si prozë, që çalon teknikisht. Dhe të tilla kemi plot. Do të përmendja këtu punën e

paktë që bëhet nga tregtia për propagandimin e saj dhe sidomos punën akoma më të paktë që bëjnë shumë mësues, të cilët, le që nuk e lexojnë vetë, por nuk ua futin në shpirt as të vegjëlve. Kur ishim fëmijë, ne pa përjashtim mësonim të paktën një vjershë në javë përmendësh, kuse tani shumë nxënës nuk mësojnë përmendësh as një vjershë në vit! Ne edhe sot dimë me dhjetra vjersha përmendësh që i kemi mësuar në shkollë. Dhe mendoni një çast sa vështirë e kemi patur për të mësuar Mjedën e Shirokën ne në Jug (ose e kundërta) kur edhe vetë mësuesi nuk e dinte kuptimin e shumë fjalëve të Veriut.

- *Si mund të hysh në botën e të vegjëlve?*

- Letërsia për fëmijë nuk është tjetër veçse shkrimi harmonike e kërkesave të letërsisë me kërkesat pedagogjike. Sa më mirë shkrihen këto, aq më bukur del vepra për të vegjëlit. Lum si ai që e arrin këtë majë, se e ka të hapur rrugën për në mendjet dhe zemrat e vogëlushëve. Po, që të hysh në botën e tyre, duhet edhe t'i njohësh mirë. Të njohësh dëshirat, ëndrrat, lodrat, interesat e shumta që kanë, gjuhën. Që t'i njohësh duhet të jetosh sa më afër tyre. Sado të pasura e të bukura të jenë mbresat e kujtimet që mbart shkrimtari nga fëmijëria e vet, ato janë shumë të varfra e të kufizuara në krahasim me botën e madhe e të pasur të fëmijëve bashkëkohorë. Ato ndryshojnë si nata me ditën. Dëshira e ëndrra kemi patur edhe ne kur kemi qenë të vegjël, po vetëm kaq. Fëmijët sot kanë më shumë ëndrra e dëshira, por kanë edhe diçka tjetër që na mungoi neve: realitetin. Ëndrrat e dëshirat ata i shohin si shndërrohen e bëhen realitet! Këtë fat nuk e kemi patur ne. Po të mbetesh thjesht te kujtimet e mbresat nga fëmijëria jote, vepra që do të krijosh do të jetë gjysmake, e çalë.

Në çdo familje kemi fëmijët tanë me të cilët lidhemi përditë. Mirëpo, kaq është shumë pak për të njohur botën dhe psikologjinë e të vegjëlve tanë dhe fëmijët, sado të mirë e të ditur të jenë, nuk i

përfaqësojnë dot të gjithë të vegjëlit e vendit. Atëhere krijuesit i del për detyrë të kërkojë rrugë të tjera për të hyrë në botën e tyre.

- *Ju s'keni punuar si mësues ose edukator, atëhere ç'rrugë keni ndjekur?*

- Disa krijues kanë patur fatin e madh të jenë mësues dhe të jetojnë midis fëmijëve. Unë, edhe pse kam mbaruar për mësues letërsie, nuk punova dot në shkollë, me gjithë dëshirën e madhe që kam patur, duke përjashtuar vitet kur kam dhënë leksione në Universitetin e Tiranës e të Elbasanit, po studentët s'janë fëmijë.... Jeta jo gjithmonë të çon aty ku dëshiron... Duke punuar për më tepër se tridhjetepesë vjet në shtyp e në botime, e kam patur të vështirë të lidhem me fëmijët. Por duarkryq nuk kam qëndruar. Ai që është dhënë me mish e me shpirt pas fëmijëve dhe letërsisë së tyre i gjen të gjitha: kohën, mundësitë, mjetet, rrugët. Dhe ka shumë mënyra për të realizuar këtë qëllim. Në radhë të parë do të renditja letërkëmbimin me fëmijët në përgjithësi dhe me letrarët e vegjël në veçanti. Këtu na jep një shembull të shkëlqyer M.Gorki. Unë kam një letërkëmbim të gjerë me shumë fëmijë, nga gjithë Shqipëria. Ku i kam njohur? Sa herë shkoj me shërbim nëpër rrethe, një nga detyrat që i vë vetes është të vizitoj shtëpitë e pionierit (rrethin letrar me deomos) dhe ndonjë shkollë ku bëj takime me fëmijët. U flas për letërsinë tonë, i pyes në mënyrë të tillë që të zbuloj diçka nga bota e tyre, bisedoj me ta për tema të ndryshme. Ata më befasojnë me pyetjet që më bëjnë dhe unë mundohem t'u përgjigjem. Në rast se ndonjë gjë nuk e di, sa kthehem në Tiranë u kthej përgjigje. Fëmijët shpesh më dërgojnë edhe krijimet e tyre në poezi, rrallë në prozë. I shikoj me kujdesin më të madh. Ndonjë krijim të mirë e çoj për ta botuar në organet e fëmijëve. Shokët e redaksive më kanë mirëpritur dhe kam ndjerë kënaqësi të veçantë kur janë botuar. Për krijimet që më dërgojnë u kthej përgjigje të hollësishme të vegjëlve, duke i inkurajuar për gjërat e mira e duke

i këshilluar për të metat e dobësitë, pasi ata do të jenë shkrimtarët e ardhshëm që do ta çojnë edhe më përpara letërsinë tonë. Kjo lidhje më mban të gjallë, më jep impulse të reja për të krijuar.

- *Po letërsinë për fëmijë, si e shfrytëzoni në punën tuaj krijuese?*

- Ne patëm një fëmijëri pa libra. I lexuam e i rilexuam dhjetra herë ata katër-pesë libra të përkthyer të Kolodit, Katsul Molnarit, De Amicisit, Gajdarit. Po të shpreheshim si fëmijët të thoshim "i kemi ngrënë me dhëmbë!" nga përdorimi i shumë Fëmijët tanë sot marrin nga 40 e 50 libra në vit. Libra të shkruar posaçërisht për ta. Kjo është një pasuri e madhe për fëmijët, por edhe për ne krijuesit. Të gjithë këta libra, që nga viti 1945 e gjer më sot (origjinalë e përkthime, në prozë e në poezi) jo vetëm i kam lexuar e rilexuar por për çdo njërin prej tyre kam shënime e mendimet e mia për të mirat dhe dobësitë që kanë. Herë pas here u kthehem librave e shënimeve dhe shoh gjërat që më interesojnë, veçanërisht ato që lidhen me botën e të vegjëlve dhe me probleme të mjeshtrisë. Kështu mësoj në të dy drejtimet, nga të gjithë shkrimtarët.

- *Po shtypin për fëmijë e ndiqni?*

- Në fëmijëri nuk kemi patur as shtypin tonë. Ato katër faqe të "Pionierit" që shtypej në kushte të vështira teknike na dukeshin thesar i vërtetë. Le kur botuam krijimet e para në faqet e kësaj gazete. Atëhere "Pionieri" për ne ishte gjithçka. Sot fëmijët tanë kanë në duar pesë botime: "Pionieri" e "Fatosi" nga dy herë në muaj meçdo numër, "Yllkat" e "Horizonti" nga një herë në muaj, me 24 e 28 faqe, "Skena e fëmijëve" një herë në dy muaj me nga 150-200 faqe. Janë rreth 350 faqe në muaj. Kjo është një pasuri e madhe edhe për ne krijuesit. Revistat e fëmijëve i lexoj e i rilexoj me shumë kujdes e shpesh mbaj edhe shënime për ato që mendoj se ia vlen t'u kthehem. Dhe koleksioneve të të pesë revistave u

kthehem shpesh, jo vetëm kur dua të diskutoj në analizat e tyre vjetore, por çdo herë që ndiej nevojën të bashkëbisedoj me të vjetërlit, se në to nuk shkruajnë vetëm të rriturit por edhe fëmijët.

Po lidhje të tjera mbani me fëmijët?

Për të kompesuar sado pak mungesën e njohjes së përdrejtë të fëmijëve, një ndihmë të madhe më japin “bashkëbisedimet” me ta nëpërmjet revistave dhe radiotelevizionit. Fëmijët dërgojnë nëpër redaksi dhjetra e qindra krijime, por edhe kërkesa, dëshira, pyetje, sugjerime etj. Një pjesë të madhe të këtyre letrave i marr dhe i lexoj dhe përfitoj shumë prej tyre. Në rubrikat “Posta e redaksisë”, “Ju pyesni ne përgjigjemi”, “E shtuna letrare-artistike për pinierët” etj. U kthej përgjigje duke bashkëbiseduar i shtyn ata që të më shkruajnë letra edhe kur nuk i njoh e nuk i kam takuar.

A ulesh ndonjëherë këmbëkryq me fëmijët?

Nuk e kam për turp të them se një pjesë të kohës e kam kaluar jo vetëm duke punuar me ta në rrethin letrar që drejtoj në Pallatin e Pionierëve, por edhe duke biseduar e duke luajtur. Më ka takuar shpesh të luaj me ta edhe futboll ku bëjnë nga njëzet-tridhjet gola (jo si skuadrat e të rriturve që mezi bëjnë nga një...), edhe “komand” e “yç”, edhe kukafshehti, edhe me kukulla e revolverë, që, në vend të plumbit nxjerrin xixa apo currila uji. Më kanë trembur por edhe i kam trembur, më kanë gëzuar por edhe i kam gëzuar, më kanë mundur por edhe i kam mundur, më kanë lagur por edhe i kam lagur!

Pasi e shkruani veprën, çfarë bëni me të?

Pasi e punoj dhe e ripunoj disa herë, ua lexoj fëmijëve të shkallës, pallatit, rrethit letrar në shtëpinë e pionierit, në ndonjë shkollë ose në bibliotekën e lagjes dhe diskutoj me ta. Kjo është

faza e parë. Faza e dytë është pak më e vështirë, pasi ua jap për ta lexuar disa shokëve. Kështu poemën e findit humoristike “Çamçakëzi”, para se ta çoja për botim ua kam dhënë për lexim A.Mamaqit, Xh.Beqarajt, B.Harxhit, T.Gjokutajt, H.Meçës, S.Jakovës dhe kolegëve të punës.

(Veprat për fëmijë lexohen lehtë se janë me pak faqe. E kemi këtë lehtësi...” Por edhe unë i lexoj veprat e tyre po kështu. Pra, vepra kalon në moshë e në sitë dhe rregullohet para se të shkojë për botim.

Veç kësaj, një pjesë të mirë të krijimeve i botoj edhe në organet e fëmijëve. Miqtë e mi të vegjël i lexojnë e më dërgojnë letra me fjalë të mira por edhe me kritika.

- *A ju ka ndihmuar ndokush në rrugën tuaj krijuese?*

- Më kanë ndihmuar shumë, me fjalë të mira por edhe me kritikë të ashpër (ndonjëherë edhe të pamerituar) shumë autorë të njohur, që në hapat e parë që nisa të hedh në letërsi. Ndhmën e tyre nuk do ta harroj kurrë. Para këtyre më kanë ndihmuar mësuesit e nderuar të letërsisë, që kam patur në shkollë. Pa ndihmën e tyre nuk do të kisha shkruar dot.

Duke genë borxhli ndaj tyre, jam munduar që të vë në jetë fjalën e urtë “Mbollën të tjerët ha unë, mbjell unë të hanë të tjerët, prandaj mundohem që të ndihmoj sa më shumë talente të rinj dhe më bëhet qefi shumë kur shoh se ata po ecin në rrugën e letërsisë për fëmijët ose për të rriturit.

INTERVISTË E BOTUAR NË GAZETËN “DRITA” - 1984

LETËRSIA JONË PËR FËMIJË PREZANTOHET NË GREQI

- *Siç është njoftuar edhe në shtyp, ju u ftuat nga Shtëpia Botuese "Labirinthi" e Athinës për librin tuaj "Zërat e fëmijërisë" me vjersha dhe poema për fëmijë. Si takoi që kjo shtëpi botuese ju ftoi personalisht?*

- Pas botimit në gjuhën shqipe, në vitin 1988, ky libër u përkthye edhe në gjuhën greke për fëmijët minoritarë të Shqipërisë nga poeti ynë Vasil Koçi. Ka të ngjarë që kjo shtëpi botuese e mori këtë libër. Ata më kërkuan leje që ta botonin, duke i bërë disa shkurtime e një riredaktim për lexuesit e vegjël grekë. Prandaj edhe më bënë ftesë personale për të marrë pjesë në paraqitjen e librit.

- *Kur u organizua prezantimi dhe kush mori pjesë?*

- Prezantimi i parë i librit u bë në Radiotelevizionin Grek, në kanalën 67, "Gjelbërimi". Merrnin pjesë botues, shkrimtarë si dhe redaktorë të sektorit letrar të këtij kanali televiziv. Më nderoi edhe drejtori i këtij kanali. Për ilustrim të bisedës televizioni grek dha edhe pjesë të ekspozitës që kisha marrë me vete me botimet për fëmijë të autorëve shqiptarë të këtyre dy-tre vjetëve të fundit. Përveç librave të mi ishin edhe ato të shkrimtarëve Bedri Dedja, Adelina

Mamaqi, Xhevat Beqaraj etj., të cilët janë përkthyer në gjuhën greke për fëmijët minoritarë të vendit tonë nga disa poetë tanët, shqiptarë, e kryesisht minoritarë. Këto botime ngjallën interes të veçantë.

- Po prezantimi i dytë i librit dhe i ekspozitës ku u bë?

- Më falni, po përpara dua të them se gjatë prezantimit të parë m'u bënë shumë pyetje për letërsinë shqipe për fëmijë, për atë të minoritetit grek në vendin tonë, për përkthimet nga letërsia greke e botërore. Pra, kërkonin të kishin një vizion të gjerë për botimet tona letrare në përgjithësi. Biseda gjatë prezantimit të parë në televizion vazhdoi një orë e gjysëm, gjë që flet për interesimin e tyre për botimet tona. Ndërsa prezantimi i dytë u bë në Kretë në gazetën "Guximi", nën kujdesin e kryeredaktorit të saj, Zotit Niko Vidhaqis. Prezantimit kjo gazetë i kushtoi rreth një faqe, duke botuar edhe fotografi. Titulli i faqes ishte: "Fëmijët shqiptarë lexojnë edhe Homerin".

- Pse, iu duk kjo si çudi?

- Sepse ata thujse nuk njihnin asgjë nga letërsia jonë. Ata u habitën që nxënësit tanë në shkollë mësojnë edhe Eskilin, Euripidin e autorë të tjerë të antikitetit si dhe krijuesit grekë bashkëkohës: Ludemis, Mallamas, Zei, Lazu, Benekos, Stajkos etj. Mendoj se për të propaganduar letërsinë tonë te fqinjët, mirë do të ishte që fillimisht, sidomos përkthimet dhe botimet që bëjmë për minoritetin, të dërgohen edhe në Greqi. Gjithashtu ka ardhur koha të gjendet mundësia për të përkthyer enkas edhe veprat madhore të letërsisë sonë për lexuesit grekë. Kjo do t'u jepte një ndihmë të madhe për t'u njohur me letërsinë dhe artet tona, me realitetin historik e bashkëkohor shqiptar.

- Me kaç u mbyll prezantimi?

- Jo, prezantimi i tretë u bë në gazetën "Të rejtat e Kretës". Për

krijimtarinë time shkroi botuesi dhe miku i vendit tonë Jorgo Moskovitis, kryeredaktor i shtëpisë botuese “Labirinthi”.

- *Ç’të veçantë pati ky takim?*

- Jo vetëm ky, po në të tre takimet më la mbresa kënaqësia që shfaqën kolegët grekë për tërë atë literaturë që krijojnë vetë shkrimtarët shqiptarë minoritarë, të cilët i përkthejnë dhe i botojnë librat e tyre edhe në gjuhën shqipe. Janë më shumë se 20 shkrimtarë. U përmenda dhe emrat e tyre, e ju tregova disa libra, sepse atyre sikur nuk u besohej. Më bëri përshtypje edhe kujdesi i tyre që këto prezantime i regjistruan dhe më dhanë dy videokaseta, një kasetë dhe gazetat ku u shkrua për letërsinë tonë dhe botimet e mia.

- *Ç’vizita bëtë në Greqi?*

- Gjatë atij muaji vizitova Akropolin, muzeumet historik dhe etnografik të Athinës. Në Kretë vizitova, në fshatin Mirtja, shtëpinë muze të shkrimtarit Niko Kazanzaqis, ndërsa në Fovele (po në Kretë) shtëpinë muze të piktorit të famshëm të Rilindjes El Greko. Në Knosos pashë edhe labirinthin e mirënjohur të Kretës. Nga këto vizita nuk mund të harroj këtë fakt: në librin e shtëpisë muze të Kazanzaqit, kolegët grekë shkruan se ky është shkrimtari i parë shqiptar që viziton Kretën dhe shtëpinë muze Kazanzaqi. Në atë muze ishin ekspozuar tërë librat e përkthyer të këtij shkrimtari, në vende të ndryshme të botës. Mungonte libri që kemi përkthyer ne. U premtova se do t’ua dërgoja, që vizitorët që shkojnë atje prej shumë vendeve të botës, të regjistrojnë në kujtesë edhe botimin tonë për këtë shkrimtar të madh të popullit mik grek.

- *Përveç letërsisë, përse interesoheshin kolegët grekë?*

- Për Shqipërinë në përgjithësi, sidomos për masat që janë marrë kohët e fundit për demokratizimin e mëtejshëm të jetës në vendin tonë.

- *Si do të ndikojë në krijimtarinë tuaj kjo vizitë?*

- Deomos është nxitje e madhe. Patjetër që do të shkruaj. Me interes do të ishte përshkrimi i udhëtimit të një fëmije shqiptar në Kretë. Këtë ua thashë edhe kolegëve grekë kur më pyetën gjatë bisedës televizive, në se do të shkruaja gjë nga kjo vizitë...

TIRANË, NËNTOR, 1990

LETËRSINË PËR FËMIJË E MBYTËN HOSANATË

Emri i Odhise Grillos (1933) është i njohur në letrat shqipe kryesisht si shkrimtar për fëmijë. Deri më tash ka botuar disa dhjetëra vepra për fëmijë, poezi dhe prozë, siç janë: “Njeriu i natës”, “Pushkë në bregdet” (novela) “Gabimet e Veshkaushit”, “Shokët e Veshkaushit”, “Miqtë e Veshkaushit” (përralla); “Çamçakëzi”, “Përtacukët”, “Budallushët”, “Çamarrokët” (poema humoristike); “Trimëresha e Tërbaçit”, “Ai që mundi perandorin”, “Lulet e linisë”, “Po mbinin jargavanë” (triptikë poemash); shumë vepra të rikrijuara në prozë etj. Gjithashtu është edhe hartues i teksteve universitare “Letërsia për fëmijë”, redaktor në Sh.B. “Naim Frashëri” (i veprave për fëmijë), ligjërues i letërsisë për fëmijë në Fakultetin Gjuhë-Letërsi, kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për fëmijë, O. Grillo është autor edhe i librit “Panoramë letrare” (studime rreth letërsisë për fëmijë). Është fitues i 50 çmimeve kombëtare për krijimtari për fëmijë. Me të u takuam këto ditë, kur e vizitoi redaksinë tonë, dhe gjatë këtij takimi zhvilluan edhe një bisedë për lexuesit e “Flakës”.

"Flaka": Zoti Odhise, me sa e kemi të njohur, ju si shkrimtar vokacion kryesor keni letërsinë për fëmijë. A mund të na thoni si u përcaktuat për këtë?

O. Grillo: Siç ndodh zakonisht, kam filluar të shkruaj qysh fëmijë, në bangat shkollore. Si kuriozitet mund të them se kur kam qenë nxënësi i klasës V, kur kam shkruar vjershën e parë, ia lexova nënës, e cila ishte gjysmanalfabete, që më tha: "Po ta kesh bërë vetë, e ke bërë bukur, të lumtë, por kam frikë se e ke lexuar në ndonjë libër". Kjo më dhembti pak. Por megjithatë, duke qenë se, si nga familja e nënës dhe e babait janë marrë me letërsi, folklor, libra, unë isha nën ndikimin e tyre. Mandej pata fatin të ndjek shkollën në Tiranë dhe rashë në mësues dhe shkrimtarë që merreshin me letërsi si Llazar Eftimiadhi, Mark Ndoja, Nexhat Haku, Mark Gurakuqi etj. Kjo më dha krahë. Veç kësaj kur shkova në revistën "Hosteni" si redaktor, gjeta shkrimtarë nga më të njohurit si N. Bulka, S. Çomora, T. Miloti, D. Bubani etj., të cilët më ndihmuan shumë në rrugën e letërsisë. Këto dhe qindra vargje që m'i kishte mësuar babai nga këngët popullore qenë shtysa për të vazhduar rrugën e letërsisë. Më pas në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë kishte njerëz të mirë e shkrimtarë të njohur si P. Marko, Sh. Musaraj, A. Çaçi, A. Varfi, Ll. Siliqi, etj., që jepnin një ndihmë të madhe për të rinjtë që shkruanin. Ndofta ishte ai geni që më kishte falur natyra dhe ndikimi i S. Çomorës të cilin e kisha bashkëfshatar (fshati Vuno-Himar), dashuria e madhe që kemi të gjithë për fëmijët. Ne vetë kaluam një fëmijëri pa libra dhe kishim dëshirë që fëmijët e Shqipërisë të mos kalonin fëmijëri të varfër e pa libra. Pra këto ishin shtysat që më futën në rrugën e letërsisë për fëmijë. Po kryesorja, talenti që më fali Zoti.

"Flaka": Ekziston një bindje se një shoqëri, e cila nuk tregon kujdes ndaj fëmijëve, nuk mund të konsiderohet shoqëri e përparuar. Në këtë kontekst cili është roli i shoqërisë shqiptare,

përkatësisht sa e ka ndihmuar ajo letërsinë për fëmijë?

O.Grillo: Mund të them se pas luftës interesimi për fëmijët ka qenë shumë i madh, veçanërisht në familje, sepse idealet për të cilët u luftua dhe u derdh gjak i shtynë njerëzit të mendonin për një jetë më të mirë e më të bukur, pavarësisht se sistemi dhe koha sollën zhgënjime të mëdha. Dhe shoqëria e shteti u përpoqën për t' u krijuar kushte më të mira fëmijëve, por sistemi dhe mbyllja e Shqipërisë ndaj botës bënë që fëmijët shqiptarë të mbeten të varfër e të zhgënjyer. Kjo ndodhi, sepse e futën nëpër kallëpe edukimin e fëmijëve dhe u harrua atdheu e populli të cilët u identifikuan me partinë dhe Enver Hoxhën. Në fushën e letërsisë për fëmijë u bë shumë, por politizimin dhe ideologjizimin e thellë mundën ta kalojnë vetëm shkrimtarët me intuitë e të talentuar. Prandaj në morinë e librave të dobët e pa vlerë gjen edhe vepra që kanë ndikuar në edukimin e fëmijëve në shumë aspekte e veçanërisht në aspektin atdhetar e artistik. Ka krijime të Q.Guranjakut, S.Çomorës, B.Dedes, A.Mamaqit, Xh.Beqarajt, I.Resos, B.Harxhit, T.Gjokutajt, H.Meçës, etj., që kanë vlera të padiskutueshme edukative e artistike të cilat mund të botohen kudo në botë.

“Flaka”: Në letërsinë shqiptare shkrimtarët u dhanë shumë pas fabulës. Kjo traditë filloi me rilindasit tanë të cilët drejtpërdrejt u frymëzuan nga klasikët e fabulës siç janë: Ezoipi, La Fonteni, Krillovi, Pelini etj., dhe kjo vazhdoi me intensitet deri në ditët tona. A mund të jepni një pasqyrë për vendin e saj në letërsinë shqiptare për fëmijë?

O. Grillo: Një krijim që vë në qendër kafshë, shpendë, sende etj., pëlqehet më shumë, veçanërisht nga fëmijët të cilët edhe fshesën mund ta bëjnë kalë. Së dyti, tradita e madhe që kemi nga rilindasit, por edhe kjo e sotmja, ndikuan në zhvillimin e këtij lloji. Së treti, dihet se në qendër të fabulave vihen të meta e dobësi, shfaqje të kafshëve e të sendeve, prapa të cilave fshihen njerëzit dhe prapa

fabulave fshihen autorët. Një poet po të shkruante një vjershë për të meta e dobësi të sitemit të pushtetmbajtësve, të puthakëmbësve etj., mund ta pësonte. Duke u fshehur pas fabulës e hidhte lumin. Këto mendoj se janë shkaqet që fabula ka pasur zhvillim të mbarë në letërsinë shqiptare për fëmijë deri në ditët tona.

“Flaka”: Gjatë sistemit monist socrealizmi e preku edhe letërsinë për fëmijë...?

O. Grillo: Sistemi dhe kërkesat e tij sollën edhe në letërsinë për fëmijë të meta dhe dobësi të pallogaritëshme, krijimtarinë letrare për fëmijë e mbytën vjershat, tregimet e tij., për Partinë e Enver Hoxhën, e mbytën hosanata, e mbytën skematizmi, agjitacioni e propaganda dhe lloj-lloj dobësish të tjera me të cilat do të merret kritika dhe studiuesit. Megjithatë, letërsisë për fëmijë dhe shkrimtarëve më të talentuar nuk ua morën dot frymën. Prandaj në këtë dimër socialist lulëzuan edhe talente e vepra me vlerë, të cilat në ditët tona janë më të shumta dhe po i flaku të metat e dobësitë e realizmit socialist.

“Flaka”: Po letërsia shqiptare për fëmijë që krijohej jashtë shtetit amë a depërtonte dot në Shqipëri?

O. Grillo: Deri në vitet '70 kjo letërsi ishte krejtësisht e panjohur ose njihej shumë pak nga ata që kishin mundësi të gjenin ndonjë libër në rrugë të fshehtë e që s'guxonin t'ia jepnin as mikut e shokut për ta parë e jo më për ta lexuar. Në vitet '70 pati një hapje dhe filluan të vijnë libra, gazeta e revista nga Prishtina të cilat lexoheshin me interes veçanërisht nga shkrimtarët, por edhe nga lexuesit e vegjël e të mëdhenj. Orientimi ishte që nga shkrimtarët në Kosovë e gjetkë të botonim në revistat tona për fëmijë, por edhe libra më vete, duke përdorur gërshërë ideologjike, kështu që pa dashur i kemi masakruar autorët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi. Për ndonjë gjë që mund të ketë kaluar dhe

që tingëllonte keq në veshët e censorëve, redaktorët dhe botuesit kanë hequr të zitë e ullirit. Kjo vazhdoi deri në vitin 1981. Paskëtaj orientimi ishte që të botoheshin më shumë, por me tematikë të caktuar: vuajtjet dhe mjerimi, emigracioni, vëllavrasja dhe ndonjë krijim për natyrën. Jashtë kësaj tematike nuk botohej asgjë. Kjo vazhdoi deri dy-tri vite përpara. Librat e fundit që janë botuar nga V.Kikaj, R.Kukaj, Q.Batalli, A.Deva, A.Islami, M.Hoxha, A.Demolli, G.Xhafolli, Z.Elshani etj., i kanë shpëtuar kësaj censure. Megjithatë mendoj se është bërë një punë e mirë në prezantimin e shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, pasi vetëm dhjetëvjetëshin 80-90 janë botuar rreth 80 vepra të tyre nga lloje të ndryshme.

“Flaka”: Megjithatë ajo pjesë e letërsisë shqiptare që krijohet në Kosovë është cilësuar si letërsi kosovare, autorët si shkrimtarë kosovarë dhe jo letërsi shqiptare, shkrimtarë shqiptarë, që do të ishte krejt normale. Si e komentoni këtë?

O. Grillo: Ju e dini se metodë kryesore dhe e vetme në Shqipëri ishte realizmi socialist. Shkrimtarët shqiptarë ishin të lirë të shkruanin çfarë donin e si të donin, kështu që nuk mund të thuhet se jashtë kufijve ekzistues të Shqipërisë letërsia e tyre i takonte realizmit socialist. Kjo ishte arsyeja që bëhej ndarja me thikë dhe ndaheshin shkrimtarët në shqiptarë dhe kosovarë në mënyrën më të vrazhdët...

“Flaka”: Diçka e ngjashme pat ndodhur edhe në fushën e studimeve të letërsisë për fëmijë, siç kanë vepruar bie fjala B. Dedja e ndonjë tjetër, të cilët letërsinë shqiptare jashtë kufijve politikë të shtetit amë e kanë përjashtuar, kursë në Kosovë, bie fjala Agim Deva, nuk e ka bërë këtë gjë, përkundrazi, ka shkruar edhe për autorët shqiptarë që krijojnë brenda kufijve të shtetit amë?

O. Grillo: Fatkeqësisht edhe kritika dhe studimet nuk mund ta merrnin në vështrim letërsinë për fëmijë që krijohej jashtë shtetit

amë, sepse veprat nuk u përshtateshin kallëpeve të realizmit socialist...

“Flaka”: Ç’mendoni për të gjitha këto barriera që kanë ekzistuar në fushën e letërsisë për fëmijë, janë shmangur apo jo?

O. Grillo: Edhe pse ka patur të tilla barriera, duke përdorur forma e mënyra të ndryshme, një pjesë e mirë e këtyre barrierave janë kapërcyer. Por mbetet ende shumë për të bërë, që t’i tregojmë lexuesit të vogël e të madh dhe opinionit letrar se letërsia për fëmijë, ashtu si ajo për të rritur, është një dhe e pandashme kudo që krijohet. Ajo mban vulën shqiptare dhe nuk mund ta përçajë asnjë sistem, asnjë ideologji, asnjë diktaturë.

“Flaka”: A keni menduar për hartimin e një historie integrale për letërsinë shqiptare për fëmijë?

O. Grillo: Në kushtet aktuale kjo është një detyrë shumë e vështirë për t’u kryer. Por në të ardhmen e afërt do të bëhet patjetër. Ne në Shoqatën Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për fëmijë e kemi bërë një plan të këtillë dhe do të përpiqemi t’ia dalim mbanë. Për këtë kemi besim.

“Flaka”: Duke i pasur parasysh të arriturat e letërsisë botërore për fëmijë a mund të jepni ndonjë prognozë dhe sugjerim për perspektivën e letërsisë shqiptare për fëmijë? Si duhet të jetë ajo? Ç’duhet të bëjë...?

O. Grillo: Në letërsinë për fëmijë të krijuar deri më sot ka mjaft vepra që u kanë shpëtuar skemave e që kanë vlera të padiskutueshme si në Shqipëri ashtu edhe jashtë kufijve të saj të sotëm. Në këtë rrugë duhet të ecë letërsia për fëmijë duke ngjitur maja më të larta, duke flakur edhe hijet që mund të kenë mbetur nga e kaluara. Rrugët për rritjen e cilësisë mendoj se janë tri: E para, kudo që krijohet letërsia shqiptare për fëmijë të botohen vetëm

librat më cilësorë e jo si në të kaluarën kur janë botuar edhe shumë byk e hime. E dyta, duke ribotuar veprat më të mira që janë krijuar gjatë këtyre 120 viteve letërsi për fëmijë (prej K.Kristoforidhit, i cili njihet si autor i vjershës së parë për fëmijë e deri në ditët e sotme, 1992). Dhe e treta, të botohen dhe të ribotohen për fëmijët shqiptarë të gjitha veprat e shquara të letërsisë botërore për fëmijë.

*INTERVISTË E BOTUAR NË GAZETËN "FLAKA E VËLLAZËRIMIT",
SHKURT, 1992*

PËR DEMOKRACINË

ÇDOKUSH LUFTON ME ARMËT E VETA

- *Zoti Odhise, mund të na thoni diçka , ju lutem, si e keni menduar rolin tuaj në këto procese demokratike?*

- Kam menduar dhe mendoj se çdokush për demokracinë lufton me armët e veta. Arma ime është krijimtaria për fëmijë. Është fakt që veçanërisht botimet për fëmijë kaluan një periudhë thatësire rreth dyvjeçare, ku pushuan së botuari dhe revistat “Pionieri”, “Fatosi”, “Yllkat”, “Horizonti”, për të mos folur për botimin e librave, që u paralizuan krejt. Por vështirësia e kësaj periudhe duhet të kalojë, prandaj duke e parë me syrin e së ardhmes, si mjaft krijues të tjerë, edhe unë ia vura punës duke shkruar me synimin që të jap një ndihmesë sado të vogël në zhvillimin e lulëzimin e demokracisë, gjithmonë lidhur me fëmijët, me lexuesin e vogël. Prandaj edhe kam zgjedhur të tilla vepra që kanë mesazhe domethënëse aktuale.

Së pari, u mora me Don Kishotin e Servantesit. (E kisha shkruar prej vitesh, por nuk e botova dot për arsye....donkishoteske nga keqdashja e ndonjë botuesi). Pra, gjatë kësaj kohe e ripunova, sepse dihet që çdo krijues i rikthehet gjithnjë punës së vet. Mesazhi

i Don Kishotit na flet qartë se ai që do të përpiqet të kthejë të kaluarën do t'i ngjasë Don Kishotit dhe do ta pësojë si ai. Kur ta lexojnë fëmijët jo vetëm do të qeshin e do të tallen me heroin e librit, por edhe diçka do të mësojnë prej tij që edhe ata, kur të rriten, të dinë t'i përdorin armët e veta, secili në drejtimin që do të marrë në jetë, për demokracinë.

Vepra e dytë është “Lahuta e Malësisë”, e homerit shqiptar at Gjergj Fishtës, e cila është quajtur nga studiuesit “Iliada shqiptare”. Këtë poet të madh, që ia mbyllën derën për pesëdhjetë vjet, duhet ta njohin sa më parë e sa më mirë edhe të vegjëlit. Nëpërmjet “Lahutës” ata do të mësojnë jo vetëm për fatin tragjik të autorit por edhe për trimërinë e heroizmin e malësorve e të gjithë shqiptarëve për mbrojtjen e trojeve tona nga synimet shoviniste. Rikrijimin në prozë të “Lahutës së Malësisë” e ndjeja edhe si një detyrim ndaj autorit, pasi pjesë nga poema dhe vjershat e tjera të tij me frymë atdhetare, i kam mësuar përmendësh që kur kam qenë gjashtë vjeç nga babi im që ishte mësues dhe nga mësuesit e nderuar, tashmë 100-vjeçarë, zotni Janko Pali e zotni Panajot Gjikenuri (të cilëve u uroj jetë shumë më të gjatë). Dhe të mësojë në Vuno të Himarës para pesëdhjetë vjetëve Fishtën, Mjedën e të tjerë ishte një gjë shumë e vështirë, pasi vunjotësve u dukej se shkodranët flisnin një gjuhë tjetër. Por, kjo që bënin mësuesit tanë duke na njohur edhe me krijimtarinë e shkrimtarëve të mëdhenj veriorë ishte një vepër atdhetarie, sepse dihet çfarë ndikimi kanë te fëmijët veprat madhore të letërsisë së një kombi.

- *Pas këtyre dy librave me çfarë tjetër do t'i gëzoni fëmijët?*

- Sapo është botuar poema humoristike “Budallushët” e cila vë në lojë ata që më përpara flasin se sa mendojnë, ata që u flet goja para mendjes. Është shkruar me qëllim që fëmijët jo vetëm të mësojnë diçka prej saj, por edhe të argëtohen e të qeshin se gazi është një pjesë e jetës së tyre. Ndërkohë kam në proces në një

shtëpi botuese private poemën tjetër humoristike “Pesëqind grosh” e cila është një fshikullim artistik kundër diktaturës. Jam duke përfunduar “Epin e Gilgameshit”, vëllimin e katërt të serisë me përralla për miqtë e Veshkaushit dhe në një shtëpi botuese tjetër private kam romanin e shkrimtarit të madh Xhani Rodari “Torta që ra nga qielli”, të cilit i kam bërë një përkthim të lirë.

- Kohët e fundit patët rastin të udhëtonit jashtë shtetit. Mund të na thoni diçka për vlerën e këtij udhëtimi?

- Për mua, që i kapërceja kufijtë shtetërorë për herë të parë ishte një kënaqësi e veçantë, për të mos thënë se ishte një mrekulli. Në të vërtetë as gjatë këtyre dy vjetëve nuk u kujtua kush nga Lidhja të më dërgonte në ndonjë veprimtari, por, megjithatë, ka një ndryshim të madh, se, të paktën, tani në demokraci, nuk të pengon kush të shkosh privatisht në qoftë se të krijohet mundësia. Kështu, kohët e fundit sektori për fëmijë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Bullgarisë më ftoi nominalisht nëpërmjet shkrimtarit Kiril Apostolov, shef i këtij sektori, në një sesion shkencor për letërsinë për fëmijë që u mbajt në Sofie. Atje ligjërova edhe unë temën “Rrugë të reja në letërsinë shqiptare për fëmijë”. Po kështu kam qenë i ftuar nga shkrimtarët e mirënjohur shqiptarë në Maqedoni, zotërinjtë Abdylaziz Islami e Murat Isaku në Tetovë dhe Fejzi Bojku në Shkup. Atje pata takime me shkrimtarë, studiues, pedagogë etj. Në Shkup pata takime edhe me botues të librave e revistave për fëmijë të shtëpisë botuese “Flaka e vëllazërimit”; dhashë intervistë në RTV në gazetën “Flaka e vëllazërimit” po për këto probleme.

- Para disa muajve është botuar një informacion i shkurtër për Shoqatën Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për Fëmijë. Meqë jeni njeri prej themeluesve të kësaj shoqate dhe të gazetës “Bota e fëmijëve”, a mund të na thoni diçka për veprimtarinë e muajve të parë?

- Shoqata jonë, meqenëse letërsia për fëmijë është parë me nënvleftësim, ishte e para që u shkëput nga ish-Lidhja e Shkrimtarëve. Gjatë kësaj kohe të shkurtër kemi zhvilluar disa aktivitete. Në veprimtarinë botuese kemi shumë vështirësi sepse deri tani nuk kemi mundur të sigurojmë ndonjë ndihmë, sidomos për letrën. Megjithatë, me dëshirën dhe vullnetin e mirë të krijuesve kemi arritur të botojmë disa numra të gazetës “Bota e fëmijëve”, e cila është mirëpritur. Jemi lidhur me disa shoqata ndërkombëtare, si me Institutin Ndërkombëtar të Librit për Fëmijë (IJB) në Mynih etj., kemi bërë prezantimin e disa librave, kemi krijuar degët në ato rrethe ku ka krijues për fëmijë dhe do të përpiqemi, së shpejti, të fillojmë botimin e librave.

Këto ditë, shkrimtarët për fëmijë mbajtën Kuvendin e tyre të parë, ku u fol për rrugët e reja që do të ndjekim për zhvillimin më të mbarë të letërsisë e të shtypit për fëmijë. Shpresojmë që punët tona krijuese të ecin në rrugë të mbarë.

BOTUAR NË GAZETËN "TIRANA", 1993

ZONJA RENÉE SIMONS PËR ODHISE GRILLON

- *Zoti Odhise, kohët e fundit morëm vesh se studjuesja holandeze e letërsisë, zonja Renée Simons, është marrë me krijimtarinë tuaj për fëmijë dhe ka publikuar një shkrim të gjatë në revistën "Literatuur Zonder Leeftijd". A mund të na thoni diçka më shumë për këtë fakt?*

Kohët e fundit, një dashamirësja ime nga Hollanda më dërgoi një letër dhe revistën "Letërsia e ditëve tona", numrin 35/1995, organ i Shoqatës së Shkrimtarëve holandezë, e cila merret me studimin e letërsisë për fëmijë e të rinj që krijohet në Hollandë e në botë. Kjo revistë që botohet në Amsterdam është periodike dhe voluminoze: vetëm ky numër ka rreth 250 faqe.

Në këtë numër studiuesja holandeze Renée Simons ka botuar një shkrim të gjatë, prej 25 faqesh. Ka një hyrje për letërsinë shqipe në përgjithësi, duke nisur nga *Buzuku*, duke vazhduar me *Naim Frashërin* e duke u ndalur aty-këtu edhe tek autorë të njohur në fushën e letërsisë sonë për fëmijë si *Ismail Kadare*, *Bedri Dedja*, *Mira Meksi*, *Tasim Gjakutaj* e *Xhahid Bushati*, të cilët Renée Simons i vlerëson si krijues të talentuar. Për ndonjërin prej tyre ajo ka përkthyer edhe ndonjë vjershë apo ndonjë pjesë poeme, si

për Kadarenë e Tasim Gjokutajn, pastaj nga faqja 368 deri te faqja 389 autorja në fjalë për krijimtarinë time të cilën e ka pasur objekt studimi. Shkrimi i këtij numri të revistës është një përmbledhje e disertacionit të saj, që e ka mbrojtur për të fituar doktoraturën në shkencat filologjike. Ky është një nder që i bëhet letërsisë sonë për fëmijë, shkrimtarëve tanë dhe mua personalisht.

- Ndonjë hollësi nga vlerësimet që bën zonja Simons në veprën tuaj, do të ishte me interes për lexuesit tanë.

- Zonja Renée më ka vlerësuar shumë dhe unë nuk e di nëse i meritoj të gjitha ato që ka shkruar. Mos ma merrni për keq, por shkrimtari ka nevojë jo vetëm për lavdërime, por edhe për kritika e vërejtje të cilat do ta ndihmonin për të shkruar më mirë veprat e reja... Mendoj se vlerësimi më i madh që më ka bërë zonja Simons është ky: ajo diku thotë këto fjalë: "Po të përkthehej në gjuhët evropiane, Odhise Grillo do të bënte për vete shumë lexues të vegjël e të mëdhenj".

- Ju jeni një autor që keni botuar shumë libra, në mos gaboj, mbi gjashtëdhjetë, dhe keni shkruar në prozë e në poezi, në të gjitha llojet letrare. Cilat libra vlerëson më shumë studiuesja?

- Zonja Simons është marrë me shumë nga veprat e mia, por më tepër është ndalur në disa prej tyre. Kështu ajo vlerëson disa poezi, disa poema dhe rikrijime në prozë që kam bërë për fëmijët, si "Serafina Topine" e Jeronim De Radës, "Këngën e sprapsme të Balës" të Gavril Darës (i riu) dhe veçanërisht "Lahuta e malësisë" të at Gjergj Fishtës. E ndihmuar edhe nga zonjat Zhakline Sheji e Juliana Kotoni (kjo e fundit me sa duket është emigrante shqiptare në Hollandë), zonja Simons ka përkthyer edhe vargje e pjesë proze me të cilat shoqëron studimin e vet. Veçanërisht ajo vlerëson shumë "Serafina Topinë" dhe "Lahutën e malësisë".

ZOTI NË QIELL, ATDHEU NË TOKË, LETËRSIA NË SHPIRT!

- *Kujt ia dedikoni veprimtarinë letrare?*

- Në radhë të parë Zotit që më fali talentin. Pastaj vijnë me radhë: *trashëgimia*. Unë kam patur fatin të kem një mjedis që do ta quaja “kopshti im letrar i trashëgimisë”. Nuk kam të dhëna për të afërmit e largët, por di se gjyshi nga nëna ka qenë kryeredaktor i një gazete në Kajro të Egjyptit, që në fillim të shekullit të kaluar. Kam patur një vëlla të babait Kostandinin, i cili vdiq në moshën 21 vjeçare, që ka qenë bejtexhi i shkëlqyer dhe ka bashkëpunuar me gazetat e Rilindjes Kombëtare dhe një kushëri të parë të babait, Nikolla Kasnecin (ish-kryetar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Korçës, më 1916, që shkruante vargje. Babai nuk ka shkruar vetë, po ka qenë mbledhës i folklorit dhe prej tij kam mësuar shumë e shumë këngë popullore, ndërsa nëna ishte bejtexheshë... që i këndonte zemra. Vëllai im i madh, Dhimitri, ka shkruar në poezi e në prozë qysh i ri dhe ka botuar një libër historik që u vlerësua shumë në kohën e vet.: “*Arvanitët dhe shqiptarët në luftën çlirimtare të popullit grek (1821-1929)*”. Po kështu vëllai tjetër, Llambroja, është marrë me publicistikë e me botime. Pastaj, disa kushërinj të parë janë marrë me gazetari e kanë bërë emër, si

Enf. O. Gu
trashëgimia

Kristofor e Kozma Grillo etj. Në një “tokë të tillë të punuar” nuk ka si të mos dalin talente.

- *Vetëm këto janë dy “këmbët” ku jeni mbështetur?*

- Jo, kam edhe disa “këmbë” të tjera... Mësuesit që pata në shtatëvjeçare e në të mesmen, po edhe në Universitet, ndikuan për mirë tek unë, pasi më përkrahën në rrugën time letrare. Të tillë kanë qenë të ndjerët *Llazar Eftimiadhi, Nexhat Hakiu, Mark Ndoja, Sulë Haxhihyseni, Nazmi Duhaxhiu, Mark Gurakuqi, Myzafer Xhaxhiu etj.*, të gjithë mësues të shkëlqyer dhe shkrimtarë. Pastaj vijnë me radhë shumë shkrimtarë të viteve ‘30 e ‘40, të cilët me fjalën e ëmbël, dashamirësinë e madhe dhe zemrën e tyre të gjerë sa deti, më dhanë dorë të ec më tej në letërsi. Mos të harrojmë se në moshë shumë të re unë kam patur nderin të punoj në një zyrë me të madhin *CHRI-CHRI (Nonda Bulka)* e me krijues të tjerë të njohur si *Tonin Miloti, Dionis Bubani, Vehbi Skënderi, Naum Prifti ...* Një tjetër *fidanishte letrare kjo*. Më dhanë dorën e më ndihmuan të mëdhenjtë e të njohurit *Spasse, Marko, Jakova, Varfi, Musaraj, Çaçi, Xoxa, Siliqi* e plot të tjerë, të cilët i përkrahnin të rinjtë dhe nuk u vinin stërkëmbësia si disa shkrimtarë gjoja “modernë” të viteve të fundit, që janë gati të hanë njëri-tjetrin, e të groposin të rinjtë!

Atyre që kanë ikur nga kjo botë u qoftë e lehtë toka që i mbulon dhe u ndritte shpirti për jetë, ndërsa ata që janë gjallë paçin shëndet e lulëzofshin edhe njëqind vite të tjerë!

Të gjithë këta më futën në shpirt dashurinë për krijuesit, veç të tjerave, prandaj edhe kam vepruar ashtu siç thotë poeti i mirënjohur e humoristi i shquar i letërsisë për fëmijë *Tasim Gjokutaj*, në parathënien e përmbledhjes së tij poetike “*Kësh e hëngri akulloren*”, ku janë përfshirë vjershat, vjershat humoristike, përrallat në vargje, poemat e poemat humoristike, të vjela nga 22 vëllimet poetike që ka botuar, me titull “*Dy fjalë nga autori*”, botim i “*Toenës*”, i cili së shpejti del nga shtypi:

“Odhise Grillon, krijues nga më prodhimtarët e më të njohurit në letërsinë shqipe për fëmijët dhe redaktor nga më dashamirësit për talentet e reja, e njoh për më shumë se dyzet vjet. Kur isha në klasën e pestë të shtatëvjeçares, lexova për herë të parë dhe mësova përmendësh përallën e tij humoristike “Kush e ka kapuçin?”. S’e dija që do të bëhej mësuesi im dhe do të më nxiste që të mos i ndahesha letërsisë për fëmijë. Në 22 libra që kam botuar ai është redaktor i tetëmbëdhjetë prej tyre...”

Atë mirësi e zemër të bardhë që më dhuruan mësuesit e shkrimtarët ndër vite unë u përpoqa gjithë jetën t’ua jap më të rinjve prandaj janë me dhjetëra shkrimtarët e letërsisë për fëmijë që, kur më dhurojnë libra, nuk harrojnë të shënojnë *“Mësuesit tim!”* Të tillë janë *Reso I., Mamaqi, Bishqemi, Jakova S., Bushati, Meça, Lamaj, Gaçe Bardhosh* e plot të tjerë, madje edhe bashkëmohatarë e më të moshuar se unë, si *Harxhi* (i ndritte shpirti aty ku ka rënë se ishte njeri dhe poet), *Çakëri* etj.

- Ju keni botuar mbi gjashtëdhjetë libra në prozë e në poezi dhe në të gjitha gjinitë e llojet dhe keni fituar dhjetra çmime kombëtare, shto këtu edhe botimet, rubrikat, emisionet ne RTV e bashkëpunimet në sa e sa gazeta dhe revista. Veç talentit e trashëgimisë a ju ka ardhur në ndihmë edhe gjë tjetër?

- Kryesoren e lashë për në fund: kam zbatuar për dhjetëra vjet fjalën e urtë popullore *“Nëntë punë e një talent”*, ose siç e ka thënë *Edisoni: “99 përqind punë e vetëm 1 frymëzim”*. Kam punuar e vazhdoj të punoj edhe dhjetë e pesëmbëdhjetë orë në ditë në tryezë, dhe tani që për disa muaj do të kem 65-vjetorin e lindjes. Natyrisht edhe me pushime ndërmjetëse e zbavitje. Nuk krijoj në gjithë këto orë, por lexoj e redaktoj libra që nga gjashtëvjeçarja Eris Bushati gjer te Edlira Rama, Lira Lasku, Ermela Bashuri që ende s’kanë mbushur dymbëdhjetë vjeçët dhe shumë të tjerë, redaktoj të paktën pesë libra në muaj të shtëpisë botuese *“Toena”*, të zotit Fatmir Toçi. Pa dëgjoj

muzikë, pi kafe e çaj, ha fruta, merrem me “kopshtin e vogël të luleve” që kam në ballkon (me mbi tridhjetë vazo), ndihmoj në shtëpi e jashtë saj, drejtoj Shoqatën Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për Fëmijë e të Rinj, jam në stafin drejtues të tre revistave etj., etj.

- Po ku i gjeni gjithë këto forca?

- Jam nga ata që punoj jo vetëm me takat, por edhe me inat. Takati e inati nuk të lenë kurrë në baltë. Uroj të më ndjekin nga pas dhe Zoti të më falë shëndet, jo vetëm që të botoj dhjetra libra të cilët presin radhën të futen në shtyp, se i kam të gatshëm, po të krijoj dhe shumë të tjerë, për gëzimin e lexuesve të vegjël, të miqve, dashamirësve etj., dhe për inat të cmirëzinjve, keqdashësve, etj., që më janë ngjitur nga prapa gjithë jetën (si balta pas këpucës, siç thotë populli) për të më penguar. Po as ia kanë dalë e as do t'ia dalin dot të më pengojnë edhe sikur të bëhem 100 vjeç, e të mos lëviz nga vendi.

- Pse u morët me letërsinë për fëmijë e jo me letërsinë për të rriturit?

- Për shumë arsye.. Së pari se kjo qe dhurata që më dha Zoti; së dyti se..., së fundi se: një natë pashë një ëndërr. Përpara më doli një luan, i cili më ktheu kurrizin dhe po më tundte bishtin. Po në këtë kohë rreth kokës sime sillej një bletë-krahëlehtë ... Kur u zgjova ia tregova nënës, dhe ajo që hiqej se dinte t'i "zbërthente" ëndrrat më tha: “Ke dëshirë të bëhesh bisht luani apo bletë?” Unë iu përgjigja: “Dua të bëhem bletë, se ajo ka kokën, krahët, këmbët e... mjaltin e vet.”

Nëna më përkëdheli e më bekoj: “U bëfsh bletë!”

Dhe unë e vura në jetë bekimin e saj: zgjodha letërsinë për fëmijë, për të qenë bletë (e jo bisht luani në letërsinë për të rriturit) dhe, me sa thonë rreth pesëdhjetë studiues, kritikë, shkrimtarë etj., në shkrimet e tyre, që kanë bërë për mua, unë qenkam një bletë,

sado e vogël...

Kokën, sytë, krahët etj. të bletës i kam. Nuk e di nëse me të vërtetë kam krijuar mjaltë. Këtë do ta tregojë koha që vjen dhe lexuesit që vijnë bashkë me të.

- Kam vënë re, se ju në disa shkrime dhe pothuajse në të gjitha intervistat, thoni po të njëjtën shprehje: "Nëntë punë e një talent". Pse?

- Kjo është e vërtetë dhe unë ndofta e kam tepruar. Mirëpo gjithçka kam arritur në këto pesëdhjetë vjet krijimtari, ia dedikoj punës së madhe që kam bërë dhe pastaj talentit, aq sa kam patur... Se po punove nuk del kurrë i humbur. Kjo mund t'ju vlejë veçanërisht talenteve të reja.

- Kemi dëgjuar disa të thonë se Odhise Grillo ka shpikur teorinë e "Tri L-ve", A mund të na thoni ç'është kjo teori?

- Kjo mbase tingëllon si një shaka, po ka diçka të vërtetë brenda. Teoria është e thjeshtë dhe u vlen vetëm krijuesve. Duke qenë se disa shkrimtarë u venë stërkëmbësia kolegëve, pasi shkojnë pas parimit "Nuk të kam inat ty, po talentin tënd", nëpërmjet kësaj teorie u kam bërë thirrje e u kam thënë: "LETËR, LEKË dhe LAVDI" ka për të gjithë, prandaj hiqni dorë nga prapësitë e nga poshtërsitë!" Ja pra tri "L-të"...

- Dhe e fundit: po kështu kam dëgjuar diçka edhe për devizën që keni ndjekur në jetë e në krijimtari... Cila është kjo?

- Në punë, në krijimtari e në jetë mua më ka udhëhequr trinomi i shenjtë:

ZOTI NË QIELL,
ATDHEU NË TOKË
dhe LETËRSIA NË SHPIRT!

INTERVISTË E BOTUAR NË REVISTËN "MREKULLIA" - 1997

Libri e botuar

libri

GJYSMËSHEKULLI PUNË, MUND E DJERSË

Librin e parë “Shtatë ngjyrat” e ka botuar në vitin 1954, ndërsa librin e gjashtëdhjetë e pestë “Miqtë e Veshkaush Llapushit” e botoi ditët e fundit. Në 50 vjet të veprimtarisë së tij krijuese. Ka fituar 50 çmime në konkurse kombëtare, nga të cilat rreth 40 të para. Nuk ka marrë parasysh kritikën e dashakeqësve, apo vlerësimet e dashamirësve, por gjithmonë është udhëhequr nga parimi: “Një talent nëntë punë”. Me pak fjalë ky është portreti i Odhise Grillos, një nga themeluesit e letërsisë sonë për fëmijë të pasçlirimit e tashmë kryetar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë e të Rinj. Megjithëse i ka kaluar të 60 vjetët, ai ndjehet në kulm të krijimtarisë, me plane për sivjet e për më gjatë.

- Në vitin 1954 keni botuar librin e parë “Shtatë ngjyrat”, që tregon për një lidhje të herëshme me botën e fëmijëve. Ishte kjo një rastësi apo dëshira juaj, që më pas u kthye në pasion?

- Me letërsinë për fëmijë u lidha që kur isha vetë fëmijë, në klasën e katërt. Atëherë kam shkruar vjershën e parë. Nuk ka qenë rastësi futja ime në këtë letërsi, por një dhuratë nga Zoti.

Kur kam botuar poezinë e parë në “Pionieri”, më 1947, në ëndërr m’u shfaq një bletë që më sillej rrotull kokës dhe një luan që më kishte kthyer kurrizin e më tundte bishtin. E mira, nëna ime, që thoshte se dinte të shpjegonte ëndrrat, kur ia tregova, më tha: “Bëju bletë, e jo bisht luani”. Dhe unë u përpoqa të bëhem bletë në letërsinë për fëmijë (ka kokën, krahët, këmbët e... mjaltin e vet...), dhe jo bisht luani në letërsinë për të rriturit.

- Fëmijët i tërheq më shumë loja, një kënaqësi e veçantë për moshën. Ç’duhet të ketë parasysh një krijues për t’i tërhequr po kaq shumë ata me një libër të tij. Ju, si dhe sa keni arritur ta realizoni këtë?

- Loja, siç e kanë përcaktuar pedagogët e psikologët e mëdhenj, veç të tjerave, i mëson, edukon e argëton fëmijët. Ajo është pjesë e pandarë e jetës së tyre, dhe unë jam përpjekur ta bëj lojën pjesë të krijimtarisë sime. Rrugët që kam ndjekur janë të ndryshme. Njëra prej tyre: meqë s’pata fat të punoja si mësues, për të qenë mes tyre edhe tani që i kam kaluar të 60- vjetët, shpesh shkoj e luaj me ta, bile edhe vrapoj mbrëmjeve për të kapur xixëllonja, apo për të luajtur kukafshehti. Kështu jam përpjekur ta arrij këtë (aq sa e kam arritur).

- Librat janë një nga mundësitë që fëmijët mësojnë e të bëhen të ditur. Në këtë drejtim si do t’i vlerësonit krijimet tuaja, mbështetur edhe në opinionet e mbledhura nga të vegjëlit, si dhe nga prindërit e tyre?

- Veç rubrikave që kam mbajtur në revistat, gazetatat dhe në emisionet e fëmijëve në RTV, takimeve që kam bërë e vazhdoj të bëj nëpër shkolla, etj., një nga lidhjet e mia me fëmijët ka qenë letërkëmbimi me ta. Në arkivin tim kam me qindra letra që më kanë dërguar fëmijët, jo vetëm me krijimet e tyre (më të mirat e të cilëve janë botuar), por edhe me mendimet e tyre. Mos kujtoni se janë të vegjël e nuk dinë. Këtë e kam provuar vetë, me kritikata e

vlerësimet që më kanë bërë. Letrat e tjera, me shënime për vlerësimet apo vërejtjet që më kanë bërë, janë të mësuesve, prindërve, shokëve e miqve të mij. Kjo më ka nxitur që asnjë libër të mos e çoj në shtyp pa ua lexuar fëmijëve nëpër veprimtari letrare, në shkolla, shtëpi pushimi, qendra kulturore, vërejtjet e të cilëve më kanë vlejtur më shumë se ç'do gjë, pa mohuar edhe mendimet e krijuesve tanë më të mirë të letërsisë për fëmijë, të cilëve ua kam dhënë për t'i lexuar ato.

- Shkruani në poezi e prozë, në shumë gjini e lloje. Cila është gjinia juaj e preferuar. Ku keni gjetur veten dhe e keni ndjerë se e kanë mirëpritur edhe fëmijët?

- “Miq të e Veshkaush Llapushit” është libri me përralla që kam botuar ditët e fundit, i gjashtëdhjetëepesti në afro 50 vjet të punës sime krijuese. Librat e tjerë janë në gjini nga më të ndryshmet me vjersha, poema, fabula, tregime, novela, romane, skeçe, pjesë për kukulla e pjesë teatrale... I kam të dashura si poezinë e prozën, megjithëse tani shkruaj më shumë në prozë. Të dashura kam edhe krijimet e kryeveprave të letërsisë sonë e të huaj si, të Naimit, Çajupit, Mjedës, Fishtës, De Radës, Darës (i riu), etj. Poema “Balada e burrave të Vunoit” dhe proza “Lahuta e malësisë” (sipas Fishtës) e botuar pesë herë në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Tetovë dhe Mistrovicë, duke patur parasysh edhe vlerësimet që janë bërë, mendoj se janë krijimet e mia më të arrira.

Por ashtu si nëna që nuk i dallon fëmijët, edhe unë e kam vështirë të dalloj njërin krijim nga tjetri.

- Vështirësitë e periudhës së tranzicionit a kanë rënduar te ju si krijues, sidomos në fushën e botimit të veprave tuaja dhe nëse po, si i keni kapërcyer ato?

- Si atëherë, kur kishim një shtëpi botuese, ku faleshim të gjithë, edhe tani që kemi me dhjetëra, unë kam botuar e botoj vazhdimisht,

por me një ndryshim të madh: dikur kam ngrënë edhe stërkëmbësia nga drejtuesit e shtëpisë botuese “N.Frashëri”, të cilët për romanin “Don Kishoti i Mançës” më kanë sorrollatur tetë vjet, për të pritur vitin 1992, kur e botoi miku im i “Diturisë”, P.Ymeri, dhe tani zor se gjen ndonjë kopje nëpër librari. Brenda 5 vjetëve, me ardhjen e demokracisë, kam botuar 14 libra, me një tirazh prej 120 mijë kopjesh, nëntë nga të cilat në Tiranë e të tjerat në Prishtinë, Shkup, e Mitrovicë. Për të gjitha nuk kam paguar asnjë lek., ndërsa kam marrë pak e në ndonjë rast aspak, se si thotë Dodeja “Ëndrrat e shkrintarëve i realizojnë tregtarët”.

Po pres të dalin “Kur njerëzit kishin bisht” - novelë e rikrijuar sipas “Epit të Gilgameshit” dhe “E bija e hënës dhe diellit” - përmbledhje nga 35 përrallëtarë shqiptarë, shoqëruar me bibliografi për secilin prej tyre. Janë në rrugën e botimit novela “Tradhëti në sarajet Topiase”, poema “Balada shqiptare”, shqipërimi i romanit të Rodarit “Torta që ra nga qielli” etj. Më kanë sponsorizuar vetëm për një poemë me 16 faqe, e për asgjë tjetër.

- Në veprimtarinë tuaj krijuese, ashtu si dhe shumë të tjerë, do të keni pasur dashakeqës. A kanë ndikuar tek ju dhe nëse jo, pse?

- Kam patur “fatin” të kem dashakeqës të tillë, që janë munduar të më fusin dhjetë pashë nën dhe. Kështu, që në Kongresin e Parë të shkrintarëve, ata më thanë se duhej të hiqja dorë nga letërsia pasi nuk isha për këtë punë. Por, më të shumtë kanë qenë dashamirësit, njëri prej të cilëve, mik e mësuesi im, më ka quajtur “klasik i gjallë”. Nuk dua të përmend vlerësimet e shumta, jo për modesti, se sa për faktin që ato dihen, nga Kadareja ynë i madh e deri tek studiuesja holandeze Simons. E rëndësishme është se unë nuk i kam marrë parasysh të dy palët, i kam besuar punës e djersës sime, duke punuar edhe tani dhjetë e pesëmbëdhjetë orë në ditë. “Një talent e nëntë punë” - ky është parimi që më udhëheq e që më ka mundësuar të botoj 60 libra për afro 50 vjet. Kam marrë 50

çmime në konkurse kombëtare, prej të cilave rreth 40 të para. Sa qëndrojnë këto, do ta tregojë e ardhmja.

- Cili është mendimi juaj për letërsinë tonë për fëmijë, për kolegët tuaj, sidomos të rinj, dhe çfarë do t'u thoshit atyre për rrugën që kanë nisur?

- Letërsia jonë për fëmijë ka autorë të shquar veçanërisht në Shqipëri e në Kosovë si dhe te shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi. V.Kikaj, R.Hoxha, M.Krasniqi, A. Mamaqi, N.Prifti, Xh. Beqaraj, A.Islami, M. Hoxha e shumë e shumë të tjerë janë ata që, me vlerat artistike, edukative, njohëse e argëtuese të krijimeve të tyre, e kanë ngritur letërsinë për fëmijë shumë shkallë lart, por për fat të keq, ngaqë Lidhja e Shkrimtarëve ka qenë e është një njerjë për krijuesit për fëmijë, sot me përjashtim të M.Meksit, F.Lahollit e ndonjë tjetri, moshë e këtyre krijuesve është 40 vjeç e lart. Drejtuesit e letërsisë për fëmijë në Lidhje, me parrullën "S'ka ç'na duhen shkrimtarë për fëmijë. Po të shkruajnë shkrimtarët tanë nga një vepër, fëmijët do të kenë plot libra", harrojnë se në botë letërsinë për fëmijë e mbajnë ata që i përkushtohen kësaj letërsie. Krijuesve më të rinj, me shpresë se do t'i pasojnë edhe plot të tjerë, i uroj të vazhdojnë rrugën që kanë nisur me parimin që më udhëheq: "Një talent e nëntë punë".

- Gëzimet që keni ndjerë, si dhe shqetësimet që keni pasur në krijimtarinë tuaj?

- Gëzimet që kam ndjerë janë aq shumë sa nuk mund të tregohen. Mjafton gëzimi që më sjell çdo botim i ri. Por, edhe shqetësimet nuk kanë qenë një e dy... Njëri prej tyre; në vitin 1975, ndërsa në kupolën e diktaturës hanin kokat e njëri-tjetrit, në "Zëri i Rinisë" m'u botuan disa vjersha me rastin e 1 Qershorit. Njëra prej tyre, "Si zjarret partizane" (nxitëse e së cilës u bë një këngë popullore për Zaho Kokën), ku unë thoja "digjet ylli" me

kuptimin ndriçon më shumë, ndonjërit atje në kupolë i dogji dhe më akuzuan se kisha “djegur simbolin e komunizmit”. Kështu, më degdisën me gjithë familjen në Elbasan, duke më hequr të drejtën e botimit për pesë vjet, etj.etj. Pas kësaj më erdhën edhe dy rrebeshe të tjera, dhe nuk e di as vetë si shpëtova. Lavdi Zotit! Ndofta, ngaqë në jetë i kam besuar. Këto kryqëzime më shtuan inatin e dëshirën për të shkruar më shumë e më mirë dhe besoj se kam arritur diçka, për t’u thyer hundën persekutuesve e keqdashësve.

- Cilët pëlqejnë më tepër lexuesit e vegjël, autorët tanë apo të huaj, dhe si do ta komentoni këtë për secilin rast?

- Fëmijët lexojnë gjithçka që botohet, lexojnë edhe letërsinë e huaj, edhe letërsinë tonë. Nuk kam vënë re ndonjë “rendje” pas autorëve të huaj, gjë që tregon se kërkesat e tyre i përmbushin edhe autorët tanë më të mirë. Aq më tepër tani, që botohen 20 organe periodike për ta, ndërsa vetëm “Toena” boton mbi 40 libra për fëmijë në vit nga 10-15 libra, që botonte “Naim Frashëri” në fund të viteve ‘80.

- Cilët janë mësuesit e nxënësit, që keni pasur në rrugën tuaj letrare?

- Shumë shkrimtarë të brezit të viteve ‘30 e të Luftës, që nga i paharruari N.Bulka, me të cilin kam punuar për disa vjet në një zyrë, e deri tek D.Bubani, me të cilin jemi shokë prej 50 vjetësh, janë mësuesit e mi. Nuk di të kem nxënës, por kam ndihmuar shumë nga ata, që sot kanë bërë emër në letërsinë për fëmijë si, Tasim Gjokutaj, F.Laholli, etj. që sot më quajnë “mësues”. Nuk e di nëse e meritoj këtë nder...

- A merreni me politike dhe jeni i kënaqur nga e sotmja?

- Do s’do, do të merrem. Kështu, në vitin 1991 shkrova poemën humoristike “500 grosh”, e cila vërsulet kundër diktaturës, apo

“Lahuta e malësisë”, rikrijim i epopesë së Fishtës, me të njëjtin titull, për të mos përmendur vepra të tjera. Nga e sotmja jam i kënaqur, pasi nisem nga parimi “Kush nuk i sheh të mirat që na solli demokracia, është qorr! Kush nuk i sheh të metat e dobësitë, bën sikur është qorr...”

- *Jeni anëtar i ndonjë partie?*

- Jo... parti për mua është Shqipëria dhe trinomi që më udhëheq në jetë është “Zoti në qiell, Atdheu në tokë, letërsia në shpirt”. Jam, po, mik dhe “armik” i partive se i lavdëroj për arritjet dhe i kritikoj për mungesat dhe dobësitë.

- *Jeni Kryetar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë e të Rinj. Si ju ecën puna?*

- Më duket se ecën mirë. Kemi organizuar shumë veprimtari me interes, se na kanë ndihmuar xhaxhi *Sorosi*, *Velija*, *Toena* etj. Të cilët i falenderoj me gjithë zemër.

- *Planet tuaja për këtë vit e për më vonë, gjithmonë duke patur parasysh moshën: jeni ende i ri, dhe përvojën e fituar në vite?*

- Për sivjet, “bateritë” dua t’i përqëndroj për përgatitjen e “Leksionit” (fjalorit) të shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë nga vitet 1872 e deri 1995, një biobibliografi ku përfshihen rreth 550 autorë; për krijimin e romanit “Bardha e Temalit” e P. Vasës, dhe për prozën e gjatë “Magjistari më i madh i botës”. I lutem Zotit të më japë shëndet që t’i shkruaj e t’i botoj, sepse, vitin tjetër, ndofta do të kem plane të tjera.

INTERVISTË E BOTUAR NË GAZETA “RILINDJA” E PAVARUR E KOSOVËS, VERSIONI I TIRANËS - 1996.

NË ÇDO VAGON NJË ARMIK

Ajo ditë e vitit 1976 ka qenë e mallkuar dhe shumë ters për mua, dhe pse nuk ishte e martë... Do të shkoja në Elbasan ku më kishin degdisur (pse nuk e thoshin troç se qarkullimi s'ishte gjë tjetër veçse internim?) pasi në një vjershë kisha djegur shallin, yllin, triskën e Partisë, komunizmin. Paskam qenë parashikues i madh dhe nuk e kam ditur! Më kujtohet kërcënimi dhe gishti që më tundte para syve një farë Jovan Bardhi, duke nxjerrë shkumë nga goja: "*Na ke djegur gjithë simbolet e shenjta të komunizmit!*" As më kishte shkuar kurrë në mendje një gjë e tillë, po puthadorësve e puthakëmbësve të pushtetmbajtësve, që u dukej prifti derr e derri gomar, ç' nuk u pillte mendja e tyre shterpë për të mira e shumë pjellore për të këqia, për krime, për të bërë të zeza. I tillë ishte edhe Jovan Bardhi, edhe pse mbiemri i tij kishte ngjyrën e bardhë. Të zezën e kishte në shpirt... (Më kujtohet një konkuurs i vogël, në një darkë shkrimtarësh në shtëpinë e shkrimtares Ivoni Reso, i cili u fitua nga i mirënjohuri Kadare. Ai tha në pesëmbëdhjetë gjuhë emrin e mbiemrin e Jovan Bardhit: *Giovani Bianco, Janis Aspros, Ivan Bjellij etj., etj.* Ishte bërë objekt anekdotash, talljesh, përgojimesh!)

U nisa për në rrugën “Labinoti” për te agjencia e mallrave ku zakonisht gjeja ndonjë kamion ose taksi. Për fat, atë ditë edhe pse ndenja tri-katër orë, nuk gjeta. Për një çast m’u duk se më buzëqeshi fati: para agjensisë ndaloi një mikrobus dhe nga dritajrja e parë nxori kokën shoku A.K. ish sekretar i Lidhjes në atë kohë. Po shkonte me një grup shkrimtarësh në përcjelljen e fundit të shkrimtarit Skënder Arrëza, në Korçë. I thashë mos më merrnin gjer në Elbasan po s’kishte vend në zemrën e Anastasit, se në miksobus mund të rrija edhe galiç, ose në ndonjë cep. U kujtova që bëra gabim: nuk duhet t’i kisha thënë të më merrnin, pasi ai e dinte që unë isha armik.... Megjithatë s’vura mend: e pyeta për bashkëfshatarin tonë, Mantho Balën, që sapo e kishin shkarkuar nga detyra: “Si e ka punët, Manthoja?” As më shumë e as më pak, më tha kështu: “Është armik kompletamente!” (O zot, thashë me vete, sa shumë armiq paska ky Pushtet e kjo Parti!)

Kjo më tronditi se e kisha mik e shok, edhe pse unë isha më i vogël në moshë, dhe desha të kthehem në shtëpi. Mirëpo në darkë më pritnin në Teatrin “Skampa”, se kishin një provë të përgjithshme. E vendosa: u nisa për te treni. Hypa në vagonin e parë dhe ç’të shoh? Në një ndenjese po rrinte si gjysmë i varur Manthoja. T’i flas, të mos i flas, mendova, po këmbët s’më bënin tutje. Ai ishte armik. Edhe unë armik. Po sikur të thoshin që u bashkuam të dy për të bërë ndonjë komplot?

U ktheva mbrapsht, zbrita nga vagoni i parë dhe u futa në të dytin. Kur ç’të shoh, aty po dremiste poeti Lirim Deda. Tjetër armik ky... Zbrita prapë nga vagoni e u futa në të tretin. Edhe këtu kishte një armik: shkrimtari Bekim Gaçja po lexonte një libër dhe me sa duket bëri sikur s’më pa. Druhej të rrinte me mua ashtu siç druhesha edhe unë, se ishin të dy armiq.

Zbrita prapë dhe u ngjita në vagonin e katërt. Aty po bisedonte me dikë poeti Agim Shehu. Edhe ky një armik që e kishte vënë në shënjestër së pari kryeredaktori i gazetës “Zëri i Popullit”. Nuk

pata kurajon t'i afrohem se ishim të dy armiq. Dhe armiqtë kur bashkohen krijojnë grup. Grupet e grupazhet i dënonte rëndë Partia!

Zbrita nga vagoni i katërt me shpresë se në të pestin nuk do të gjeja më armiq. "Besoj se mbaruan - thashë me vete. - Ishalla kam fat të ulem". Po nuk qe e thënë... Në të pestin, mbi tavolinën dalëboje të kompartmentit po shkruante vargje poeti Vehbi Skënderi. Edhe ky i dënuar. Edhe ky armik si unë...

(Thashë disa herë se isha armik dhe më duhet ta sqaroj këtë gjë. Disa ditë pasi shkova në Elbasan më takoi shkrimtari Ç.B. dhe, pasi biseduam gjatë më tha në vesh: "Të kam unë në patronazh në Degën e Brendshme, prandaj mos u shqetëso". Mua më ra Godoleshi mbi kokë! "Ç'punë kam unë me Degën?" - e pyeta. "Mbylle - më tha - se ato punë i di unë që jam i brendshëm". Mua nisën të më dridhen leqet e këmbëve. Kisha hyrë në listat e zeza. Kjo m'u përforcua më shumë kur vajta për herë të dytë në shtëpinë e kompozitorit Alfons Ballçi, ku më kanë pritur e përcjellë më mirë se djalin e tyre. Si mund ta harroj Ninin dhe dajë Shefqetin që m'u bënë nënë e babë dhe Artën që m'u bë edhe mua motër? Kisha qënë një të dielë më parë tek ata dhe fjeta në shtëpinë e tyre. Të nesërmen një gazetar, kur mori vesh se kisha qënë mik u tha: "Mos e qasni, se është armik!" Sa hyra për herë të dytë, Nini më pyeti: "Ç'i ke bërë Partisë se në tha Petriti që je armik!" "Asgjë - i thashë. - Kam bërë një vjershë të gabuar..." Me sa duket ajo s'e mori vesh, ose mendoi: "Si puna e vëllezërve të mi në Peqin, që kanë qënë tregëtarë dhe vajtën burgjeve e i shkatërroi lufta e klasave." Edhe këtë radhë më ra Gordeleshi mbi kokë! M'u lidh gjuha e mezi kapërdiva dy kafshata. Më ngeci buka në fyt. Pas kisha qënë vërtet armik! Fillova të dyshoj dhe më hyri frika. Më dukej se më ndiqnin nga pas. Aq më tepër se operativi i Teatrit më shihte shtrembër. Ishte xhahil e injorant dhe s'e kishte për gjë të më rraste brenda.. Ja pra, pse isha armik.)

U futa në vagonin e gjashtë dhe aty pashë se po luanin me

letra dy shkrimtarë: Profesor Bedri Dedja dhe Qamil Buxheli. Ata nuk ishin qindpërqind armiq, po aty afër. Po të shkoja edhe unë bëheshim dy armiq e gjysëm (një unë e nga tre të katërtat ata...)

Zbrita nga i gjashti dhe vrapova për te vagoni i mallrave. “Këtu nuk besoj të ketë ndonjë armik” - thashë me vete. Po u zhgënjeva. A ju thashë qysh në fillim se ajo ditë, edhe pse s’ ishte e martë, edhe pse s’ ishte data 13, ishte ters për mua? Në një qosh të vagonit, duke u lëkundur sa andej këndeje, m’u shfaq fytyra e shkrimtarit Halil Qendro. Tjetër armik ky!

O Zot, ku i kishe ruajtur gjithë armiqtë atë ditë për mua?

Zbrita me vrap, vrapova në PTT, mora në telefon Teatrin “Skampa” dhe u thashë se isha i sëmurë...

Dhe me të vërtetë isha i sëmurë se në mendje, në shpirt, në çdo qelizë të trurit e të trupit më kishin kallur frikën e persekutimin.

TRYEZA E LËNDËS

NË VEND TË PARATHËNIES: Një poet me shumë mbiemra 5

STUDIME

Një mik i madh i fëmijëve të vegjël	7
Nderim për revistën “Vatra e rinisë”	26
Kur shkruajmë gjëagjëza për fëmijët	38
Bashkëbisedim me lexuesit e Lexikonit... ..	49
Dukuri të reja në letërsinë tonë për fëmijë	59
Letërsia për fëmijë: çmimet dhe problemet	65
Edhe një herë për letërsinë dhe botimet për fëmijë	73
Mirë se erdhe!	79
Një këngë që u pre në mes	87
Duke kërkuar horizonte të reja poetike	91
Kështu do ta kemi më pranë	95
+ Një mjeshtër i poezisë humoristike për fëmijë	99
Kur zë vend të nderuar në bibliotekë... ..	103
Letër Erisit gjashtëvjeçare	109

ARTIKUJ

Letërsia për fëmijë nis të ecë përsëri	113
Fëmijët e lexojnë poezinë e bukur	118
Kur babai di të tregojë përralla	122
Mesazhe miqësie	126
Gurë themeli	130
Na ishte njëherë... ..	133

INTERVISTA

Rrugë për të hyrë në botën e fëmijëve	137
Letërsia jonë për fëmijë prezantohet në Greqi	147
Letërsinë për fëmijë e mbytën hosanatë... ..	151
Për demokracinë çdokush lufton me armët e veta	158
Zonja Renée Simons për Odhise Grillon	162
Zoti në qiell, atdheu në tokë dhe letërsia në shpirt!	166
Gjysëm shekulli punë, mund e djersë	171

NË VEND TË PASTHËNIES: Në çdo vagon një armik... .. 178